

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE
NUMËR 379-380 • VITI 36 • QERSHOR-KORRIK 2022 • DH.KA'DE-DH.HIXHXHE 1443 • ÇMIMI 1 €

VONESA E PËRGJIGJES
SË MUHAMEDIT A.S. NDAJ IDHUJTARËVE
ÇFARË NA MËSON KURANI?!



Ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier
uroi Myftiun Tërnavë me rastin e Hixhretit

Ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier uroi Myftiun Tërnavë me rastin e Hixhretit



Më 29 korrik, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, në prag të Vitit të ri të myslimanëve – Hixhretit, ka vizituar Xhaminë e Madhe në Prishtinë, ku u prit nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë.

Ambasadori amerikan pasi vizitoi hapësirat e xhamisë, i uroi Myftiut Naim ef. Tërnavë, e përmes tij edhe besimtarëve vitin e

ri mysliman -Hixhretin, për të cilin ai u shpreh: “Falënderoj Myftiun Tërnavë për mirëpritjen dhe njëherësh ia uroi vitin e ri Hixhri 1444. Respekti për trashëgiminë e larmishme fetare dhe kulturore është një ideal i dashur në çdo demokraci moderne, shumetnike. Sot, isha i nderuar të shënoj Vitin e Ri Islam me Myftiun Tërnavë në Xhaminë e Madhe dhe të diskutoj mënyrat

për të siguruar që çdo kosovar të mund të adhurojë të lirë nga diskriminimi” – tha ambasadori.

Ndërsa, Myftiu Tërnavë e falënderoi ambasadorin amerikan për vizitën dhe urimin e vitit të ri hixhrij. Në bisedë me ambasadorin amerikan, Myftiu Tërnavë edhe njëherë potencoi rolin dhe kontributin e ShBA-ve për lirinë e Kosovës.



Në këtë numër:

Editoriali	4
Festat e dy Bajrameve janë festat më popullore për besimtarët myslimanë	5
Haxhi paraqet një ndër fazat më të larta të besimit në një Zot	6
Kurbani, vëllazëria dhe qëndrimi në rrugën e Zotit!	8
Sabri Bajgora	
Komentimi i sures Muhamed – (4)	12
Dr. Ajni Sinani	
Vonesa e përgjigjes së Muhamedit a.s. ndaj idhujtarëve	16
Mr. Muhidin Ahmeti	
Çfarë na mëson Kurani?!	18
Resul ef. Rexhepi	
Disa pyetje dhe përgjigje praktike	21
Ilmije Kuqi	
Dispozita e ngrënies dhe pirjes në Islam	24
Prof. ass. dr. Rexhep Suma	
Kultura e polemikës, debatit dhe dialogut në artin e thirrjes islame	27
Bajram Zeqiri	
Mirësjellja ndaj prindërve, portë e Xhenetit	31
Msc. Abdullah Klinaku	
Përplasja e qytetërimeve ndërmjet Lidhjes (1878) dhe Kongresit të Berlinit	35
Dr. Nuridin Ahmeti	
Hafëz Ibrahim Dalliu për çështjen çame	39
Mihana Goga – Bekteshi	
Vlera e lutjes	42
Dr. Muhamed Kamal Isma'eel (1908-2008)	43
Dr. Mustafa Mahmud	
Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve	45
PhD (C) Melihate Zeqiri	
Filozofia e edukimit parashkollor	46
Reportazh nga vizita e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë në Kuvajt	50
Aktivitetet	52



DITURIA ISLAME
REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë



Veprat vlerësohen sipas qëllimit

“Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër.”

(Esh-Shura, 20)

Prijësi i besimtarëve, Ebu Hafz Omer ibni Hatabi r.a., transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: “Veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe çdo person do të shpërblehet sipas qëllimit. Kush bën hixhret për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, emigrimi i tij do të konsiderohet i tillë. Por, kush bën hixhret për të përfituar ndonjë mirësi të kësaj bote, apo për t’u martuar me ndonjë grua, emigrimi i tij do të vlerësohet sipas qëllimit që ka pasur.”

Disa dijetarë preferuan që veprat e tyre t’i fillonin me këtë hadith. Një nga ata që e ka filluar librin me këtë hadith ka qenë edhe Imam el-Buhariu. Këta dijetarë i kanë këshilluar dijetarët e tjerë që librat e tyre t’i fillonin me këtë hadith, për t’i paralajmëruar studiuesit që ta kishin parasysh nijetin.

Dijetarë të mëdhenj, si Ahmed ibën Hanbeli, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Darekutni, kanë thënë se nga ky hadith mund të mësojmë një të tretën e fesë. Ndërsa Imam Shafiu ka theksuar se ky hadith ka lidhje me shtatëdhjetë tema të ndryshme të fesë dhe, për këtë arsye, ai vlerëson se duhet të konsiderohet si gjysma e diturisë fetare.

Në hadith na tregohet se nëse një person emigron vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe të Pejgamberit a.s., pa pasur asnjë qëllim tjetër përfitimi, hixhreti i atij personi është i pranuar. Mirëpo, kush bën hixhret jo për hir të Allahut, por me qëllimin që të arrijë përfitime materiale, ose të martohet me ndonjë grua, migrimi i tij nuk pranohet dhe ai nuk fiton asnjë shpërblim.

Veprat bëhen ose me zemër, ose me gjuhë, ose me gjymtyrë të tjera. Vepra të zemrës janë qëllimet dhe mendimet tona. Të gjuhës janë fjalët, kurse veprat që i bëjmë me pjesët e tjera të trupit janë punët dhe sjelljet tona.

Hadithi i lartpërmendur ngërthen veprat e zemrës, ngaqë qëllimi i përket zemrës. Fjalët dhe sjelljet shpesh janë të lidhura me qëllimin. Qëllimi i mirë edhe veprën e rëndomtë e shndërron në vepër adhurimi.

Hadithi sqaron se, për t’u pranuar dhe për të fituar shpërblimin nga Allahu një ibadet apo vepër e mirë dhe e dobishme, është kusht që ai adhurim dhe shërbim i mirë të bëhet sinqerisht dhe me qëllim për të fituar kënaqësinë e Tij.

Ajo që i jep vlerë veprave tona tek Allahu është qëllimi ynë, pra bërja e tyre me emrin e Tij dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. Edhe ibadetet, sikurse janë falja e namazit, agjërimi etj., nëse kryhen sa për sy e faqe, pra për të marrë lavdërim nga njerëzit, jo vetëm që nuk pranohen te Zoti, por një gjë e tillë është mëkat i madh.

Punët dhe adhurimet që bëhen për të fituar vlerësimin dhe admirimin e njerëzve nuk kanë asnjë vlerë tek Allahu. Pejgamberi a.s. ka treguar se në ditën e gjykimit, në fillim do të merret në gjykim shehidi. Kur Allahu e pyet atë se çfarë ka bërë, ai do të përgjigjet: “Kam luftuar dhe kam rënë dëshmor për Ty, o Zot!” Allahu i Madhëruar do t’i thotë: “Gënjën! Ti luftove që njerëzit të thonë sa trim që je!” Pastaj personi hidhet me fytyrë përmbys në Xhehenem. Më pas, do të sillet një person që ka marrë dije, ua ka mësuar ato të tjerëve dhe ka lexuar shumë Kuran. Edhe ky do të pyetet se çfarë ka bërë, e ai do të përgjigjet: “Mora dituri, ia mësova atë të tjerëve dhe lexova Kuran për të fituar kënaqësinë Tënde, o Zot!” Mirëpo, Allahu i Madhëruar do t’i thotë: “Gënjën! Ti mësove dituri që njerëzit të thonë dijetar dhe lexove Kuran që njerëzit të thonë sa bukur lexon! E në fakt, ashtu thanë.” Pastaj, edhe ky hidhet me fytyrë përmbys në Xhehenem. Në vazhdim të hadithit tregohet se para Allahut do të sillet edhe një i pasur, i cili do të thotë se e ka shpenzuar pasurinë për hir të Allahut. Por, edhe atij do t’i thuhet: “Ti e ke shpenzuar pasurinë që njerëzit të thonë se je bujar!” Prandaj, edhe ai do të hidhet me fytyrë përmbys në Xhehenem. (Muslimi)

Nga ky hadith dhe nga hadithi i mësipërm kuptojmë se veprat që janë ibadet nëse nuk bëhen për hir të Allahut nuk kanë kurrfarë vlere. Ndërkaq vepra të tjera, ndonëse nuk janë vepra adhurimi, mund të shndërrohen në ibadete dhe të shpërblehen në saje të qëllimit të mirë.

Allahu thotë: “Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër.” (Esh-Shura, 20).

Pra, për të fituar sevape nga veprat duhet që ato të bëhen për hir të Allahut. Uroj që puna ime si kryeredaktor i revistës “Diturisë Islame” përgjatë gjashtë vjetëve të jetë sebeb i fitimit të razisë së Allahut xh.sh..

Dr. Ajni Sinani

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban – Bajramit 2022

Festat e dy Bajrameve janë festat më popullore për besimtarët myslimanë

Të nderuar besimtarë!

Vëllezër e motra!

Të nderuar qytetarë të Kosovës!

Më lejoni që në këtë ditë të madhe, në ditën e Arafatit, në prag të festës së Kurban-Bajramit, t'u drejtohem me urren e përgëzimet më të mira për shëndet, harmoni e mbarësi, me shpresën dhe bindjen e fortë se në këtë festë të Kurban-Bajramit, do të përfitojmë nga begatitë dhe rahmeti i Krijuesit të Gjithësisë.

Me këtë rast, në këtë ditë të madhe, kam kënaqësinë që në emër të Bashkësisë Islame, institucioneve të saj dhe në emrin tim, t'u bashkëngjitem lutjeve e ibadeteve të besimtarëve myslimanë që sot janë në rrafshnaltën e Arafatit, ku të gjithë të veshur me petkun e bardhë – me ihrama, të barabartë e pa asnjë dallim, me çiltërsinë shpirtërore e me bindje dhe sinqeritet, kanë nisur kryerjen e obligimeve të haxhit.

Haxhilerët nga trojet tona, sikurse haxhilerët e tjerët nga e gjitha bota, në këtë ditë të madhe luten me përkushtim e devocion dhe i drejtohen Krijuesit të Gjithësisë, duke dëshmuar kështu besimin dhe përkushtimin e tyre ndaj Tij.

Mesazhet e festës së Kurban-Bajramit janë devotshmëria, barazia, sakrifica, flijimi e solidariteti, vlera këto që shprehen si nga haxhilerët që gjenden në Qabe për të kryer haxhin, po ashtu edhe nga besimtarët myslimanë që gjenden gjithandej nëpër shtëpitë dhe familjet e tyre.

Lutjet, ibadetet, devotshmëria, përkushtimi e sakrifica që e karakterizojnë Kurban-Bajramin, me të gjitha ritualet e tjera, përfshirë edhe haxhin dhe kurbanin si dimensionet kryesore të kësaj feste, krijojnë një refleksion shpirtëror, që besimtarin e fisnikërojnë edhe më shumë, e bëjnë më human dhe më të dobishëm për rrethin dhe shoqërinë, sepse që të gjitha këto bëhen me emër



dhe për hir të Zotit, tek i Cili arrin vetëm qëllimi dhe nijeti ynë i mirë pas obligimit që kemi.

S'ka dyshim se haxhi është një nga shtyllat e fesë sonë islame, dhe një nga obligimet më të dashura të Zotit për njeriun, është njëri nga adhurimet që njeriun e afron më shumë me Xhenetin dhe me mundësinë e faljes së mëkateve, ia pastrojnë shpirtin, rritë nderin, respektin dhe dashurinë ndërmjet njerëzve, duke e vlerësuar njeriun si krijesën më të kompletuar që ka krijuar Zoti xh.sh., andaj për hir të të gjitha këtyre dhuntive, Zoti xh.sh. i drejtohet Ibrahimit a.s. me fjalët: “Dhe thirr ndër njerëzit për haxhin, ata do të vijnë këmbësorë dhe kalorës me deve nga të gjitha viset e largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin emrin e Zotit në ditët e caktuara, për atë që i ka furnizuar me kafshë (për kurban). Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër.” (El-Haxh, 27-28).

Në Kuranin fisnik, besimtarët myslimanë në këto ditë të caktuara feste, urdhërohen që të prenë kurban në emër të Zotit, porse dobitë e tij t'i përfitojnë kategoritë e shoqërisë dhe institucionet në nevojë.

Për këtë arsye, Zoti xh.sh. thotë: “Falu për Zotin tënd dhe prej kurban.” (El-Kevther, 2), dhe ajeti tjetër: “Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...” (El-Haxh, 37)

Vëllezër e motra!

Deshi i Madhi Zot, që pas dy vjetëve, për shkak të pandemisë Covid-19, megjithëse jo në kapacitet të plotë, këtë vit besimtarëve myslimanë iu mundësua udhëtimi drejt vendeve të bekuara për të kryer haxhin, që është një gëzim shtesë ynë në këtë festë të Kurban-Bajramit.

Festat e dy Bajrameve, si për nga karakteri, po ashtu edhe për nga ndikimi, janë festat më popullore për besimtarët myslimanë, ngase në këto festa besimtarët si në asnjë rast tjetër, përjetojnë shpirtërisht e emocionalisht afërsinë me Krijuesin, ngrohtësinë e familjes e farefisit, respektin e mirëkuptimin për tjetrin, ndihmën dhe përkrahjen për vëllain e për ata që kanë nevojë.

Të dashur besimtarë!

Festat fetare te ne, në vazhdimësi kanë kultivuar begatitë shpirtërore para atyre materiale, urtësinë para euforisë, drejtësinë para zullumit, paqen para konfliktit e dhunës dhe solidaritetin e bamirësinë para koprracisë, ndaj, ne lutemi dhe urojmë që edhe ky Bajram të jetë në frymën e tillë.

Duke ju urren për festën e madhe të Kurban-Bajramit, lus Zotin për shëndet, mbarësi, begati, dashuri e harmoni në familjet tuaja.

Me hair e mbarësi festa e Kurban-Bajramit!

Prishtinë, më 8 korrik 2022

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban-Bajramit

Haxhi paraqet një ndër fazat më të larta të besimit në një Zot

Të nderuar vëllezër e motra!

Sot është ditë feste, feston bota mbarë. Këtë festë e karakterizojnë edhe dy ibadete – rituale që edhe më, ia ngritin vlerën kësaj feste: haxhi dhe prerja e kurbanit. Edhe sot, në rrafshnaltën e Arafatit kemi përfaqësuesit tanë, të cilët iu bashkuan një numri të madh të haxhive nga bota mbarë, me një qëllim të vetëm duke thirrur: “Të përgjigjemi o Zoti im, të përgjigjemi! Të përgjigjemi Ty që nuk ke rival, të përgjigjemi! Falënderimi vetëm Ty të takon, derisa mirësia është vetëm prej Teje. Ty të takon sundimi! Ti nuk ke rival, të përgjigjemi!”

S’ka dyshim se haxhi është një nga shtyllat e fesë sonë islame, dhe një nga obligimet më të dashura të Zotit për njeriun, është njëri nga adhurimet që njeriun e afron më shumë me xhenetin dhe me mundësinë e faljes së mëkateve, ia pastron shpirtin, rritë nderin, respektin dhe dashurinë ndërmjet njerëzve, duke e vlerësuar njeriun si krijesën më të përsosur që ka krijuar Zoti xh.sh..

Haxhi pa pikë dyshimi ka dobi dhe vlera të mëdha për besimtarin. Haxhi ka një histori të hershme duke filluar nga Ibrahim i a.s. Zoti xh.sh. thotë: “Dhe thirr ndër njerëzit për haxhin ata do të vijnë këmbësorë dhe kalorës me deve nga të gjitha viset e largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin emrin e Zotit në ditët e caktuara, për atë që i ka furnizuar me kafshë (për kurban). Hani nga ato



(mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër.” (El-Haxh, 27-28).

Kur njeriu kthehet nga ky udhëtim me zemrën që ka shijuar ëmbëlsinë e afërsisë me Zotin xh.sh., në jetën e tij ndryshojnë shumë gjëra, në raport me gabimet dhe mosbindjen e tij të deriatëhershme, ndaj haxhi rregullon rrugën e jetës dhe rregullon busullën orientuese në rrugën e drejtë e cila kënaq Zotin xh.sh.. Duhet theksuar se afrimi të Zotit xh.sh., arrihet edhe me haxh, arrihet me namaz, agjërim dhe adhurime të tjera. Çdo njeri i cili i përkushtohet Zotit, do të shijojë lloje të ndryshme të fshehtësive të adhurimit, kështu që zemra e tij do të qetësohet e rehatohet, do t’i lehtësohet vetmia dhe do të bëjë një jetë

të qetë. Me problemet dhe shqetësimet e njeriut, preokupimet dhe presionet, dhimbjet që i shtrengojnë gjoksën kur ai humb përqendrimin, e të gjitha këto, e bëjnë njeriun të fortifikuar në një përkushtim shpirtëror, ku ai dëshiron të jetë vetëm me Zotin, me lutjet dhe adhurimet e tij, ngase zemra, shpirti, shqisat, janë të drejtuara dhe të lidhura me Madhërinë e Zotit xh.sh..

Haxhi paraqet një ndër fazat më të larta të besimit në një Zot dhe mohimit të politeizmit, paraqet sinqeritet në adhurimin e Zotit, andaj i tilli është përplot me mesazhe, mësim, urtësi e begati, të cilat frymëzojnë besimtarin për ta ndërtuar aspektin moral të jetës së tij, ku

besimtari gjen domethënien dhe qëllimin e lartë në udhëheqjen e shpirtit të tij.

Haxhi sikur është një udhëtim drejt Zotit xh.sh., dhe një "arratisje" tek Ai, një ikje nga kjo botë në Mbretërinë Supreme, tek Shtëpia e Shenjtë, ku Zoti e bëri vend strehim, vend sigurie e lutjesh, bekimesh dhe përlujsh, vend i dritës me rituale që i përmbushin një sërë qëllimesh doktrinare, edukative dhe shpirtërore dhe Zoti e ka specifikuar këtë me kohë dhe vend të caktuar, dhe nisur nga kjo, e bëjnë këtë fe më madhështore dhe më humane për njerëzit.

Këtë festë të Kurban-Bajramit e karakterizon edhe vetë prerja e kurbanit në shenjë rikujtimi të sakrificës së Pejgamberit, Ibrahimit a.s., me birin e tij, Ismailin, i cili ishte i gatshëm që për Zotin të flijonte edhe birin e tij. Ndaj, Kurban-Bajrami na vjen si një rikthim dhe rikujtim i vlerave burimore që posedon feja jonë, na rikujton sakrificën, solidaritetin, ndihmën, humanitetin ndaj njerëzve që kanë nevojë, atëherë pse të mos ndihmojmë njëri-tjetrin edhe përmes prerjes së kurbanit, të gëzojmë fëmijët në nevojë, jetimët që tryeza e tyre së paku për këtë festë të jetë e begatë.

Zoti xh.sh. thotë: "Tek Zoti nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj.." (El-Haxh, 37)

Të nderuar vëllezër e motra!

S'ka dyshim se njeriu është krijesa më e përsosur që e krijoi Zoti xh.sh., mbi sipërfaqen e tokës, atë e krijoi dhe nuk e la të pa udhëzuar, ngase edhe vetë njeriu i parë Ademi a.s., ishte edhe i dërguari i Zotit xh.sh., për familjen dhe pasardhësit e tij. Zoti e udhëzoi për besim në Zotin Një, e mësoi me çdo gjë që shkon në të mirë të vetë natyrës së të qenit njeri. Zoti përmes dërgimit të pejgamberëve dhe librave të shenjtë na mësoi edhe për sjellje të mira dhe bashkëpunim ndërmjet njerëzve pa dallim vendi, gjuhe e race.

Islami, fe hyjnore nuk thërret për luftë, por për paqe, është kundër gjakderdhjes, vrasjeve, torturave, dhunimeve, shkatërrimit të infrastrukturës që njerëzit me mund e kanë ngritur për ta bërë një jetë sa më të qetë e më të lumtur. Është e padrejtë që popujve të ndryshëm, shteteve të ndryshme t'iu imponohet lufta e cila shkakton vrasje e shkatërrime. Njeriu ka mundësi që të gjykojë drejt dhe të shtrojë para vetes rrugën e miqësisë e vëllazërisë mes popujve e shteteve të ndryshme, pavarësisht pozitës, racës, gjuhës dhe potencialit që posedon ai popull, apo të mirat e pasurit që posedon toka dhe nëntoka ku ai jeton, duke e çmuar dhe konsideruar atdhe të vetin. Jemi dëshmitarë të luftërave dhe shkatërrimeve të shumta nëpër vende të ndryshme. Kemi përgjegjësi të mëdha para vendit, popujve nga vijmë dhe mos të harrojmë se kemi përgjegjësi edhe para Zotit-Krijues Suprem kur të dalim për të dhënë llogarinë përfundimtare për punën tonë gjatë jetës në këtë botë.

Kur lexojmë ajetet e Kuranit, shohim një numër të madh të ajeteve të cilat flasin për një detyrë themelore për njeriun në këtë jetë, e, që është detyra e rindërtimit të tokës dhe investimi i gjërave të mira që Zoti i ka depozituar në këtë gjithësi, në stolisjen e saj e jo shkatërrimin e saj.

Zoti xh.sh. thotë "...Ai ju krijoi nga toka dhe ju bëri banues të saj..." (Hud, 61).

Shohim sipas këtij ajeti se qëllimi është rindërtimi mbi tokë, Zoti kërkoi ta ndërtojë infrastrukturën e nevojshme mbi tokë në mënyrë që ta popullojmë atë. Ai krijoi këtë univers dhe fali pasuri e begati të shumta, pastaj autorizoi njeriun që t'i shfrytëzojë këto, në mënyrë që të krijojë kushte sa më të mira për një jetë solide e të ndershme mbi sipërfaqen e tokës. Ndaj, edhe shumë ajete flasin për nënshtrimin e gjithësisë ndaj njeriut, dhe nga kjo mësojmë se ekzistojnë të gjitha

mundësitë e stolisjes së tokës dhe të gjitha janë në dispozicion të tij.

Islami gjithëherë ka urdhëruar dhe thirrur për mbrojtjen e planetit Tokë, ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e përbërësve të jetës dhe shfrytëzimin e Universit në të gjitha fushat në të mirë të njerëzimit mbarë.

Zoti xh.sh. thotë: "Mos bëni çrregullime në tokë, pas rregullimit të saj ..." (El-Araf, 56).

Ndërtimi dhe rregullimi i Tokës është detyrë njerëzore e cila buron nga urdhri i Zotit xh.sh.. S'ka dyshim se Zoti i ka krijuar njerëzit dhe xhinët që t'i nënshtrohen dhe adhurojnë Zotin-Krijues të vetëm, duke e urdhëruar njeriun të bëjë vepra të mira duke angazhuar mendjen në dobi të njerëzimit.

Njeriu duhet të hulumtojë në hapësirë, për të zbuluar sekrete të shumta të saj, dhe të zbulojë se çfarë është e dobishme dhe çfarë e dëmshme për njeriun, dhe të gjitha këto në kuadër të përlësisë ndaj Zotit xh.sh., duke mos u habitur dhe bërë arrogant me këtë mendje e cila mund ta tërheq njeriun shpeshherë edhe në shkatërrim.

Zoti xh.sh. thotë: "A nuk e dini ju se Zoti nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka në qiej e ç'ka në Tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta...". (Lukman, 20)

Vëllezër të nderuar!

Në këtë mëngjes të bukur, nga ky vend i shenjtë dhe para kësaj mase të madhe besimtarësh, më lejoni që nga thellësia e shpirtit dhe e zemrës, t'ju uroj festën e Kurban-Bajramit të gjithë besimtarëve të besimit islam në Kosovë, brenda trojeve tona dhe krejt mërgatës nëpër botë.

Me fat ju qoftë festa e Kurban – Bajramit!

Prishtinë, më 9 korrik 2022

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Terriava

Ligjëratat e dr. Orhan ef. Bislimaj, me rastin e festës së Kurban-Bajramit, mbajtur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë

Kurbani, vëllazëria dhe qëndrimi në rrugën e Zotit!

Fjala 'kurban' është fjalë kuranore që do të thotë të therësh një kafshë me qëllim të afrimit tek Allahu. Prej hazreti Ademit a.s., e deri te Muhamedi a.s., kurbanit ka qenë një testim i devotshmërisë ndër njerëz.

Falënderimi e madhërimi i takojnë Allahut Fuqiptotë, salavate e selame në këtë ditë mubarek ia dërgojmë Muhamedit a.s., familjes së tij të pastër, shokëve të tij të ndershëm e besnikë, si dhe të gjithë atyre që e pasojnë rrugën e tij deri në ditën e fundit.

Vëllezër të dashur, motra të respektuara, që në fillim ju përshëndesim, në këtë ditë të bekuar, me es-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu!

Sot është festa e Kurban-Bajramit. E gjithë bota islame feston, e myslimanët gjithandej e urojnë njëri-tjetrit për shëndet e mirësi në jetë.

Sot, mbarojnë dhjetë netët e para të muajit Dhul Hixheh, për të cilat Krijuesi është betuar në Kuran: "Pasha agimin, pasha dhjetë netët." (El-Fexhr, 1-2).

Sot, melaqet qëndrojnë pranë rrugëve dhe i përshëndesin me selam të gjithë ata që e kanë mësyre xhaminë, për ta falë namazin e Bajramit.

Sot, haxhitë tanë në Qabe, teksa e kanë mbaruar qëndrimin në Arafat, kthehen për ta bërë tavaf Qabenë e bekuar të Allahut.

Kjo është ditë shumë e madhe, ditë e shënuar, dita e prerjes së kurbanit në emër të Zotit dhe njëra prej dy festave qendrore në fenë islame.

Kurban-Bajrami, përveç dimensioneve të tjera, ndërlidhet me dy çështje të rëndësishme islame:

E para: Kjo festë, shënon kryerjen e ibadetit të haxhit, e që është një nga pesë shtyllat e fesë islame. Allahu ka



thënë: "Për hir të Allahut, kryerja e haxhit është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi deri në Qabe." (Ali Imran, 97); dhe

E dyta: Shënon prerjen e kurbanit, e që nënkupton fetarinë e sinqertë të besimtarit dhe sakrificën emblematike për interesin e përgjithshëm shoqëror. Allahu në Kuran ka thënë: "Andaj, ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd!" (El-Kevther, 2).

Fjala 'kurban' është fjalë kuranore që do të thotë të therësh një kafshë me qëllim të afrimit tek Allahu. Prej hazreti Ademit a.s., e deri te Muhamedi a.s., kurbanit ka qenë një testim i devotshmërisë ndër njerëz. Në momentin kur Allahu e urdhëroi Ibrahimin a.s. për ta bërë kurban djalin e tij, Ismailin, nuk ishte qëllimi që djali të mbytej, por një sprovë

reale se cilën anë do ta mbajë Ibrahimin a.s., anën e djalit si interes i dynjasë apo anën e Allahut, i cili ia ka falë djalin dhe çdo gjë tjetër. Njësoj është edhe në kohën tonë. Ai që pret kurban, duke e përjetuar si akt ibadeti, tregon se më shumë e do Allahun se sa interesin e dynjasë. Prandaj, Allahu ka thënë: "Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre (kurbaneve), por tek Ai arrin devotshmëria e juaj..." (El-Haxh, 37).

Por, festa e Kurban-Bajramit e përmban edhe një element tjetër, e që është përfundimi i shpalljes së Kuranit famëlartë. Gjersa, Ramazani e Fitër-Bajrami shënojnë fillimin e zbritjes së Kuranit, në anën tjetër, festa e Kurban-Bajramit, përmban përfundimin e zbritjes së Kuranit, që kishte zgjatë rreth 23 vjet dhe kjo

është gjëja më kryesore jo vetëm për myslimanët, por për mbarë njerëzimin.

Në ditën e Arafatit, pikërisht nga ai vend ku haxhitë nga e gjithë bota qëndrojnë, (pra edhe haxhitë tanë të Kosovës dje kanë qëndruar në Arefat) Pejgamberi a.s., në vitin 632 e kishte mbajtur një hytbe shumë domethënëse e me plotë emocion. Personalisht, sa herë e lexoj, më duket sikur i shoh fytyrat e ngazëlluara të atyre njëqindmijë sahabëve sa kanë qenë aty, duke shikuar me dashuri Pejgamberin e Zotit, që u jepte këshilla të arta nga kodrina “xhebelu rahmeh”. Subhanallah, është shumë mallëngjyjes ai momenti i parë, kur Pejgamberi a.s. e filloi ligjëratën me fjalët që sinjalizojnë largimin e tij nga kjo botë: “O ju njerëz! Dëgjoni çka do t’ju them, sepse nuk e di se a do t’ju takoj juve në këtë vend pas këtij viti.” Për kader të Zotit, Pejgamberi a.s. brenda atij viti ndërroi jetë dhe nuk pati ymër më për ta bërë edhe një haxh tjetër.

E përmenda këtë ngjarje, jo vetëm pse ka ndodhur në natën e Kurban-Bajramit, e në vendin e shenjtë të

Arafatit, por mbi të gjitha për mesazhet që përmban ajo. Secili prej nesh kemi nevojë ta lexojmë sa më shpesh. Kah fundi i hytbes, Pejgamberi a.s. i saktësoi dy elemente, kur ka thënë:

E para: “Kurrë nuk do të devijoni përderisa t’i përmbaheni Kuranit dhe Sunetit tim; dhe

E dyta: “O ju njerëz! E dëgjuat porosinë time, futeni në zemrat tuaja e në jetën tuaj. Të gjithë ata të cilët i kanë dëgjuar fjalët e mia, le t’ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar, sepse prej atyre mund të ketë më të kuptueshëm se vetë dëgjuesit.”

Me këto dy porosi, Pejgamberi a.s. na ka këshilluar që jetën tonë ta ndërtojmë sipas porosive të Kuranit dhe Sunetit, në mënyrë që të ndërtojmë një shoqëri përparimtare e të shëndoshë.

Vëllezër të dashur, motra të respektuara!

Pejgamberi a.s., e gjeti shoqërinë e asaj kohe në primitivizëm të thellë, e në armiqësi ndër shoqërore. Por, për brenda 23 vjetëve, arriti ta transformojë në shoqëri ideale, që i dha botës kulturë e civilizim, e ndërtoi

shtetin dhe e fuqizoi atë si asnjë perandori tjetër e kohës.

A na ka shkuar ndërmend të pyesim se çka ndikoi në këtë zhvillim, ku ishte çelësi?

Pa asnjë pikë dyshimi, burim i këtij transformimi ishte feja dhe vetëm feja. Po flasim për fenë si një koncept fetar, arsimor e edukativ, që e mbush individin me vlera të mirëfillta, që e vetëdijëson atë, që e edukon shpirtin, që e udhëzon në të mirë dhe e ndalon nga e keqja, si dhe që i drejton sjelljet e tij në mënyrë normativiste. E jo për atë ‘fenë’ sipas definimit të ateistëve e antiteistëve, qysh dinë ta paraqesin si gogol.

Duke kultivuar vlera të përbashkëta fetare e kulturore, njerëzit u bënë vëllezër të vërtetë; nuk kishte dallim arabi prej jo arabit, as i bardhi prej të ziut; u përbashkuan rreth idealeve të qiellit; filluan t’ia donë të mirën njëri-tjetrit po aq sa vetvetes; u bënë luftëtarë për të mirën e përgjithshme.

U bënë të tillë, sepse të gjithë e synonin dashurinë e Zotit, kënaqësinë e Tij dhe ndihmën e Tij.

E, Krijuesi i gjithësisë në hadithin kudsij ka thënë: “E kam bërë obligim



që dashuria Ime t'i përfshijë të gjithë ata që e duan njëri-tjetrin për hatrin Tim; ata që shoqërohen për hatrin Tim; ata që e vizitojnë njëri-tjetrin për hatrin Tim; ata që shpenzojnë prej pasurisë për hatrin Tim."

Të dashur vëllezër!

Gjithmonë kemi nevojë për metodologjinë e Pejgamberit a.s., të cilën e përdori për ndërtimin e individit, familjes, shoqërisë dhe shtetit. Kemi nevojë për shembullin e shokëve të tij, për të cilët Allahu në Kuran tha: "Janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kah bëjnë ruku, bien në sexhde dhe kërkojnë prej Allahut mirësinë dhe kënaqësinë e Tij. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes." (El-Fer'h, 29).

Këto gjurmë të sexhdes duhet të shihen edhe në veprat tona dhe në sjelljet tona të përditshme. Më ka prekur në shpirti rasti i tre shokëve të Pejgamberit a.s., në luftën e Jermukut. Edhe pse ishin të plagosur rëndë, ata i dhanë përparësi shokut. I ofruan ujë Harith bin Hisham, por nuk pranoi të pijë para shokut, Ikrames. Kur i afruan këtij, edhe ky nuk pranoi para shokut tjetër, Ajjashit. Kur shkuan tek Ajjashi, e panë se veç ka ndërruar jetë, e kur u kthyen te dy të parët, panë se edhe këta kanë ndërruar jetë. Allahu i mëshiroftë!

Kjo është dashuria dhe vëllazëria në emër të Islamit. Në këtë funksion është edhe prerja dhe shpërndarja e mishit të kurbanit.

Pejgamberi a.s., me një rast u tha sahabëve: "Prej robërve të Allahut janë disa që as nuk janë pejgamberë as nuk janë shehid (dëshmorë), por në ditën e gjykimit, pejgamberët dhe shehidët do ta lakmojnë gradën e tyre (të Xhenetit)." Sahabët e pyetën: "O i Dërguar i Allahut, na trego, kush janë ata njerëz?" Ai u përgjigj: "Ata janë të cilët e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut. Ata as nuk janë farefis me njëri-tjetrin as nuk kanë prona për të shkëmbyer. Beto hem në Allahun se ata do të kenë fytyra të ndritura, ata do të jenë në ulëse prej dritës. Ata nuk do të kenë frikë kur të tjerët do të jenë të frikësuar, ata nuk

do të kenë brenga kur të tjerët do të jenë të hidhëruar. Pastaj e lexoi ajetin: "Padyshim, për të dashurit e Allahut, nuk ka frikë e as brengosje."

Të gjithë ne që jetojmë në Kosovë, shqiptarë, boshnjakë, turq, rom, egjiptian, ashkali, duhet të ndjekim konceptin e ymetit. Si vëllezër që jemi, nuk duhet të lejojmë urrejtje brenda nesh për çfarëdo arsye. Dashuria jonë në emër të Zotit, duhet ta luftojë çdo përçarje që mund të lind për shkak të interesave të dynjasë apo pikëpamjeve të tjera shoqërore, partiake e politike.

Të dashur vëllezër!

Ne, imamët, po mundohemi që t'ua transmetojmë besnikërisht mësimet e Kuranit e këshillat e Pejgamberit a.s., ashtu siç Pejgamberi a.s. e pati brengë këtë mision dhe siç i porositi sahabët në ligjëratën e lamtumirës. Si shoqëri, kemi ardhur në një momentum historik, ku beteja jonë është kundër dukurive negative e veseve çoroditëse, në këtë botë të internetit, kur kulturat e huaja na vijnë rrëke e na imponohen pa asnjë censurë. E kemi kulturën tonë që është më e mira dhe nuk kemi nevojë për kultura të huaja. E kam thënë edhe njëherë tjetër, ne imamët, pothuajse kemi mbetur të vetëm në këtë front, në mbrojtje të identitetit tonë fetar e kombëtar. Ndoshta akoma nuk mund të krenohemi para botës me ndonjë zbulim teknik e teknologjik, por para shoqërive të tjera ne mund të krenohemi për familje të shëndoshë, për rini të shëndoshë e për vlera morale.

Porosia e Allahut dhe e Pejgamberit a.s. është që të qëndroni në rrugën e Zotit, mos i lëshoni parimet e fesë, sepse ky do të jetë dëmi më i madh në historinë tonë. Erdhi një sahabi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, më thuaj diçka për fenë islame (që do të më mjaftojë), dhe që pas kësaj të mos kem nevojë ta pyes askënd tjetër për këtë." Pejgamberi a.s. i tha: "Thuaj, kam besuar në Allahun dhe qëndro vendosmërisht në atë!"

Pejgamberi a.s., nuk i tha diçka tjetër, por i tha me qëndro në rrugë të Zotit. Dikush mund të thotë, hoxhë efendi, qysh duhet me qëndru në rrugë të Zotit. Këtu nuk ka nevojë për shumë sqarime, ne që ia dimë rendin xhamisë, këtë e dimë. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Hallalli dhe harami janë të qartë."

Pasha Zotin, krejt e dinë çka është e keqja e çka është e mira, vetë shpirti jonë e ndjen: "Dhe ia tregoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij." (Esh-Shems, 8)

Prej njeriut kërkohet ta bëjë hapin në rrugën e Zotit. Për shembull, dje ka qenë e xhuma, a ke shkuar në xhami me fal xhumanë? Nëse ke shkuar, në rregull, mirëpo nëse nuk ke shkuar, e ke lëshuar hapin themelor për të qenë në rrugën e Allahut. Sepse, xhumaja e ka një pozitë të veçantë tek i Madhi Zot. Nuk është në pyetje vetëm namazi si madhërim i Krijuesit, por aty është hytebja e dersi i xhumasë me këshilla nga Kurani. Jo rastësisht, Allahu e ka bërë haram çdo punë tjetër në kohën e namazit të xhumasë, e që nuk e ka bërë për vaktet e tjera, duke na thënë: "Kur thirr ezani për xhuma, vraponi për në xhami dhe leni çdo punë të dynjasë!" (El-Xhuma, 9).

Një gjë ju garantoj, që në xhumanë e parë do ta ndjeni ëmbëlsinë e jetës dhe do ta rikuptimësoni veten tuaj. Allahu e tregon shembullin e xhinëve, të cilët kanë përfunduar në rrugë të Zotit, nga një moment i vetëm. Ata shkuan fshehurazi ta dëgjojnë Pejgamberin a.s. teksa ai lexonte Kuran, por në fund thanë: "Ne kemi dëgjuar një Kuran që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t'ia shoqërojmë më askënd." (El-Xhinn, 1-2). A e di pse përfunduan? Sepse Allahu e ka skalitur në qenien e krijesave dashurinë për Zotin, mjafton vetëm ta dëgjojnë Fjalën e Tij.

Vëllezër e motra!

Jemi duke folur për qëndrimin tonë si shoqëri në rrugën e fesë, me vendosmëri e këmbëngulësi. Ky ka qenë dert i peygamberëve, e ky duhet të jetë derti ynë. Peygamberit a.s., kur iu paraqitën thinjat, shokët i thanë: “O i Dërguari i Zotit, të janë shpeshuar thinjat.” Peygamberi a.s. u tha: “Më ka thinjur ajeti: “Qëndro vendosmërisht (në rrugën e Zotit), ashtu si je i urdhëruar.” (Hud, 112).

Duke qëndruar në rrugën e Zotit, ne si brez ndikojmë në ruajtjen e shoqërisë dhe zhvillimin e saj të shëndoshë. Natyrisht, aty ku e keqja ka shtrirje agresive, qëndrimi në rrugën e Zotit është më i vështirë, është siç ka thënë Peygamberi a.s., “sikur me mbajt gaca në dorë”, por ne shpresojmë në atë që të tjerët nuk shpresojnë, shpresojmë në shpërblimin e Allahut dhe Xhenetin e Tij, prandaj nuk duhet të dorëzohemi para asnjë sfide apo pengese.

“Jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun.” (Ali Imran, 110).

Kurrë të mos e konsiderojmë veten të suksesshëm, gjersa fëmijët nuk i kemi lënë në rrugë të Zotit. Ata, janë arbitër i jetës tonë. Ndhimën më të madhe që mund t’ia japim vendit është duke i dhuruar fëmijë të edukuar.

Në Kuran, Allahu na këshillon përmes shembullit të Zekerijas a.s., i cili kur iu lut Zotit në pleqërinë e tij të thellë për fëmijë, e kishte vetëm një dëshirë: “Zoti im, bëje që Ti të jesh i kënaqur me të!” (Merjem, 5-6).

Prandaj, prindërit duhet ta kryejnë obligimin e tyre në edukimin fetar të fëmijëve, veçanërisht në këtë kohë kur dukuritë negative po gjejnë përdorim gjithandej. Me orë të tëra, babai e nëna qëndrojnë në internet, për gjëra fare të parëndësishme, ndërsa nuk gjejnë kohë, qoftë një gjysmë ore, që fëmijëve të tyre, me ia mësuar një ajet të Kuranit, një hadith të Peygamberit a.s., një ngjarje të sahabëve. Kush është fajtori këtu?



Gjatë kalifatit të hazreti Omerit r.a., një prind u ankuar se djali i tij po sillej keq e vrazhdë. Pas kontaktimit, djali i tha hazreti Omerit: “O kalif i myslimanëve, me çfarë të drejte është ankuar babai im, kur ai fare nuk është kujdesur për të drejtat e mia. Babai, nuk ma ka zgjedhur emrin e mirë, nuk më ka mësuar asgjë prej Kuranit, si dhe përmendi plotë pika të tjera. Atëherë, Omeri r.a., iu drejtua babait dhe i tha: “Je sjell padrejtësisht me djalin, para se ai të sillej padrejtësisht me ty.”

Vëllezër e motra të respektuar!

Fëmijët duhet t’i frymëzojmë me edukatën e xhamisë, me edukatën e traditave tona fetare e kombëtare, e jo t’i lëmë në mëshirë të kulturave të rrugës. Populli ynë e ka një fjalë: “Edukatën ta jep familja, kurse arsimin ta jep shkolla.” Në këtë kohë dinamike e me shumë angazhime, ju ftojme që fëmijët t’i dërgoni në mектеbin e xhamisë më të afërt që e keni. Shko tek imami dhe kërkoje edukimin e fëmijëve. Bashkësia Islame, nëpërmjet imamëve e mualimeve të arsimuara është duke bërë të pamundurën në edukimin e

brezave për ta ruajtur identitetin tonë ashtu siç jemi, për ta ruajtur fenë dhe kombin, secili në fenë dhe etninë e tij. Fundja, gjersa veset negative nuk mund t’i ndalojmë në shoqërinë tonë, atëherë metoda më e mirë është që fëmijët t’i edukojmë, t’i imunizojmë me kulturë fetare për të rezistuar kundër çdo degjenerimi.

Krejt në fund, e lusim Allahun e Madhëruar që të na udhëzojë në atë që është e dobishme për veten tonë, familjen tonë, vendin tonë, për dynjanë dhe Ahiretin. E lusim Allahun që të gjithë ata që janë të sëmurë, i Madhi Zot t’i shërojë, ata që janë të varfër, i Madhi Zot t’i begatojë, ata që kanë telashe e probleme, i Madhi Zot t’ua largojë, e mbi të gjitha e lusim Allahun që të na mundësojë të jetojmë si myslimanë, të vdesim si myslimanë dhe në Ditën e Gjykimit të ringjallemi faqebardhë para madhërisë së Tij.

Urime festa e Kurban-Bajramit, inshaAllah me gëzime e shëndet gjithmonë në familjet tona!

Sabri Bajgora

Komentimi i sures Muhamed – (4)

Ligji i Allahut që nuk ndryshon as për besimtarët as për mohuesit –meditim rreth gjendjes së tyre në dynja e në Ahiret

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَنصُرُوا اللَّهَ يَنصُرْكُمْ وَيُذْهِبْ أَعْدَاءَكُمْ
 ﴿٧﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا فَتَعَسَا لَهُمْ وَأَصْلُ أَعْمَالِهِمْ ﴿٨﴾ ذَلِكَ
 بِأَنَّهُمْ كَرِهُوا مَا أُنزِلَ اللَّهُ فَأَخْبَطَ أَعْمَالَهُمْ ﴿٩﴾ أَفَلَمْ
 يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ
 ؕ دَمَّرَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ ۚ وَلِلْكَافِرِينَ أَمثَالُهَا ﴿١٠﴾ ذَلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ
 مَوْلَى الَّذِينَ آمَنُوا وَأَنَّ الْكَافِرِينَ لَا مَوْلَى لَهُمْ ﴿١١﴾ نَ الْوَالِدِ
 يُدْخِلُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِن
 تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ۖ وَالَّذِينَ كَفَرُوا يَتَمَتَّعُونَ وَيَأْكُلُونَ كَمَا تَأْكُلُ
 الْأَنْعَامُ وَالنَّارُ مَثْوَىٰ لَهُمْ ﴿١٢﴾ وَكَأَيِّن مِّن قَرْيَةٍ هِيَ أَشَدُّ
 قُوَّةً مِّن قَرْيَتِكَ الَّتِي أَخْرَجْنَاكَ أَهْلَكْنَاهُمْ فَلَا نَاصِرَ لَهُمْ
 ﴿١٣﴾ أَفَمَن كَانَ عَلَىٰ بَيْتَةٍ مِّن رَّبِّهِ كَمَن زَيْنَ لَهُ سُوءُ عَمَلِهِ
 وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ ﴿١٤﴾ مَثَلُ الْجَنَّةِ الَّتِي وَعَدَ الْمُتَّقُونَ فِيهَا
 أَنْهَارٌ مِّن مَّاءٍ غَيْرِ آسِنٍ وَأَنْهَارٌ مِّن لَّبَنٍ لَّم يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُ وَأَنْهَارٌ
 مِّن خَمْرٍ لَّذَّةٍ لِلشَّارِبِينَ وَأَنْهَارٌ مِّن عَسَلٍ مُصَفًّى ۖ وَلَهُمْ فِيهَا
 مِن كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَمَغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ ۗ كَمَن هُوَ حَالِدٌ فِي النَّارِ
 وَسُقُوا مَاءً حَمِيمًا فَقَطَّعَ أَمْعَاءَهُمْ ﴿١٥﴾

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja. Ndërsa ata që nuk besojnë, qofshin të shkatërruar! Ai do t’ua asgjësojë veprat atyre. Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka shpallur Allahu, andaj Ai i ka zhvulerësuar veprat e tyre. Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër Tokë, për të parë përfundimin e atyre që qenë përpara tyre!? Allahu i shfarosi ata plotësisht, e kështu do të përfundojnë edhe mohuesit e tjerë. Kjo për shkak se Allahu është Mbrotjtës i atyre që besojnë, kurse për mohuesit nuk ka mbrotjtës. Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu do t’i shpjerë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim! Eh, sa shumë qytete, të cilat kanë qenë më të fuqishme se qyteti yt, që të ka përzënë, Ne i kemi shkatërruar dhe nuk kanë pasur asnjë ndihmës! Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara dhe lëshohet pas pasioneve të veta? Ja përshtkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pa ndotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehenemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t’u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!” – (Muhamed, 7-15)

Shkaku i zbritjes së ajetit 11

Transmetohet nga Ibn Ebi Hatimi e ky nga Katadeja të ketë thënë: “Na është përmendur neve se ky ajet ka zbritur në ditën e betejës së Uhudit, kur i Dërguari a.s. ishte në një kodrinë, e përreth tij kishte të plagosur e të vrarë. Atë ditë idhujtarët kishin thirrur me zë të lartë: “Madhëroni “Hubelin”, kurse myslimanët ua kthyen: “Allahu është më i Madhi dhe më madhështori”. Idhujtarët bërtitën me zë të lartë: “Ne kemi

Uzzanë e ju nuk keni Uzza”, ndërsa i Dërguari a.s. u tha: “Thoni atyre: “Allahu është Zoti-Kujdestari ynë, e ju nuk keni Zot- kujdestar.”¹

Shkaku i zbritjes së ajetit 13

- Transmetohet nga Ibn Abasi dhe Katade, se ky ajet ka zbritur pas përfundimit të Haxhit lamtumirës, kur i Dërguari a.s. duke dalë prej Mekës, e shikoi me mall Qabenë e bekuar dhe duke qarë nga pikëllimi tha: “Për Allahun, ti je vendi më i

mirë i Allahut në Tokë, dhe vendi më i dashur i Allahut në Tokë! Po të mos më nxirrnin (dëbonin) prej teje, kurrë nuk do të isha larguar”² Pas kësaj, Allahu xh.sh. zbriti ajetin e 13 të kësaj sureje: “Eh, sa shumë qytete, të cilat kanë qenë më të fuqishme se qyteti yt, që të ka përzënë, Ne i kemi shkatërruar dhe nuk kanë pasur asnjë ndihmës!”

- Transmeton Ebu Ja’la nga Ibn Abasi të ketë thënë: Kur i Dërguari i Allahut ia mësyu shpellës, (rrugës për hixhret), e shikoi me mall Mekën dhe tha: “Ti je vendi më i dashur i Allahut për mua, dhe po të mos më

dëbonin nga ti banorët e tu, kurrë nuk do të isha larguar prej teje”.³ Pas kësaj, Allahu xh.sh. zbriti ajetin e 13-të të kësaj sureje: “Eh, sa shumë qytete, të cilat kanë qenë më të fuqishme se qyteti yt, që të ka përzënë, Ne i kemi shkatërruar dhe nuk kanë pasur asnjë ndihmë!”⁴

Lidhja e këtyre ajeteve me ata paraprakë

Këto ajete kanë një ndërlidhje të pashkëputur me ajetet paraprake, për faktin se më parë u trajtua çështja e robërve të luftës dhe dispozitat rreth tyre, dhe sprovimi i besimtarëve me luftën, duke i përgëzuar ata të qëndrueshmë me begatitë e Xhenetit, ndërkohë që tash në këto ajete, Allahu xh.sh. ua bën të qartë besimtarëve që nëse mbështeten tek Allahu duke synuar ngadhënjimin në luftë, atëherë Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’i bëjë fitimtarë si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Kurse jobesimtarët, do të jenë të humbur përgjithmonë, së bashku me veprat e tyre, sikur të mos kishin ekzistuar fare. Shembuj të tillë të shkatërrimit të popujve të mëhershëm ka mjaft, për ata që duan të marrin mësim.

Koment:

7. O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.

Nëpërmjet këtij ajeti, Allahu xh.sh. i nxit dhe i motivon besimtarët që në fushëbetejë të jenë të qëndrueshëm, dhe të kërkojnë vetëm ndihmën e Allahut. Ai që mbështetet tek Allahu, nuk do të humbë kurrë, sepse ashtu siç është përmendur më parë, ai gjithsesi do të arrijë njërin prej dy objektivave madhore: rënien shehid-dëshmor në rrugën e Allahut me çka e futë veten në radhët e të dashurve të Allahut dhe të xhenetlinjve, ose ngadhënjimin mbi armikun, dhe



lartësimin e Fjalës së Allahut. E nëse besimtarët myslimanë, i kanë këto objektiva si synim final, atëherë ndihma e Allahut është e sigurt, sepse Ai i përforcon zemrat e tyre me qetësi dhe fortësi, që të mos ndiejnë frikë e as mos të zmbropsen nga fushëbeteja me armikun.

8. Ndërsa ata që nuk besojnë, qofshin të shkatërruar! Ai do t’ua asgjësojë veprat atyre.

Kurse ata që nuk besojnë, e këtu është fjala për ata që nuk e besojnë Allahun xh.sh., që e mohojnë Shpalljen që iu dërgua Muhamedit a.s., atëherë Allahu i Madhërishtëm ka përgatitur për ta poshtërim, nënçmim dhe përbuzje në këtë botë dhe në botën e ardhshme. Atyre Allahu Fuqiplotë do t’ua asgjësojë vepra e tyre të mira që mund t’i kenë pasur, dhe do t’i ndëshkojë në zjarrin e Xhehenemit.

9. Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka shpallur Allahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre.

Arsyeja pse Allahu do t’ua asgjësojë veprat e jobesimtarëve vjen në formë të përgjigjes pikërisht në këtë ajet, ku i Madhi Zot sqaron se jobesimtarët kanë urrejtje patologjike ndaj besimit të pastër islam. Atyre ju pengon drita e Imanit dhe nuk mund të pajtohen se tash, flamurin e Njëshmërisë e mban dikush tjetër e jo ata. Të

mashtuar nga egoja dhe mendjemadhësia, duke imagjinuar e supozuar se ata janë në të drejtë, dhe të privilegjuar nga Zoti, e humbën veten dhe e devijuan shpalljen e pastër që ju erdhi atyre më parë. Ata shtrembëruan të vërtetën prandaj edhe e merituan hidhërimin e Krijuesit të gjithësisë dhe përbuzjen e nënçmimit në të dy botët.⁵

10. Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër Tokë, për të parë përfundimin e atyre që qenë përpara tyre!? Allahu i shkatërroi-shfarosi ata plotësisht, e kështu do të përfundojnë edhe mohuesit e tjerë.

Ky ajet është një tërheqje e drejt-përdrejtë e vërejtjes ndaj idhujtarëve që po mohonin me gulm shpalljen që i zbriti Muhamedit a.s. Prandaj Allahu ju drejtohet me të tilla fjalë, që të marrin mësim nga fati i popujve të kaluar, gjurmë e vendbanimeve të të cilëve i keni afër dhe shpeshherë kaloni andej pari gjatë udhëtimeve tuaja, siç ishin populli Ad, Themud dhe populli i Lutit a.s.. Të gjithë këta popuj Allahu xh.sh. i shkatërroi me ndëshkim të tmerrshëm, për shkak të ligësive dhe mbrapshtisë së tyre. Këta sikur i kishin shpallur luftë Allahut dhe të dërguarve të Tij, e dihet se ai që i shpall luftë Allahut, do ta ketë përfundimin e keq në këtë botë dhe përjetësinë në skëtërrat e Xhehenemit.

Përgjigja e Resulullahut s.a.v.s. ishte e prerë se mbrojtësi i myslimanëve është vetëm Allahu, kurse idhujtarët nuk kanë asnjë mbrojtës.

I Madhërishtmi, qëllimisht i ka përmendur në këtë ajet fjalët: *(Demmere alejhim-i shfarosi-shkatërroi plotësisht)*, për t'ua bëtë me dije kurejshëve dhe jobesimtarëve të çdo kohe, se një fat i tillë i keq mund t'i presë edhe ata, prandaj, le të marrin mësim nga pësimi i atyre që ishin para tyre, dhe ta pasonin këtë pejgamber, që iu erdhi me dritën e udhëzimit dhe të vërtetën. Mekasit, më parë veç kishin pësuar një humbje të turpshme nga myslimanët në Bedër.

11. Kjo për shkak se Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë, kurse për mohuesit nuk ka mbrojtës.

Në këtë ajet sqarohet shkaku pse Allahu i shkatërroi popujt e pabindur të mëhershëm. Ata popuj kishin mohuar Allahun, e madje në disa raste edhe i kishin kërcënuar me jetë të Dërguarit të Zotit. Prandaj, për t'i shpëtuar ata nga rreziku për jetë, kishte pasuar ndërhyrja hyjnore, me shkatërrimin e popujve zullumqarë dhe shpëtimin e të dërguarve dhe besimtarëve që i pasuan ata.

Ashtu siç u përmend te shkaqet e zbritjes, ky ajet me gjasë mund të ketë zbritur gjatë luftës së Uhudit, kur myslimanët pas fitores fillestare, u detyruan të zmbrapseshin pas sulmit të furishëm prapa shpine nga ana e armikut, dhe krejt kjo, për shkak se shigjetarët nuk e respektuan urdhrin e Pejgamberit a.s. që të mos lëviznin nga pozicioni i tyre në kodër,

pavarësisht rrethanave dhe situatave të luftës.

I Dërguari i Allahut me shokët e tij u shtrënguan të ngjiteshin drejt një kodrine për të gjetur strehim, dhe prej aty filluan të ndërtonin fjalët me idhujtarët të cilët të trimëruar me rikthimin e luftës në favor të tyre, filluan të mburreshin me idhujt e tyre. Prandaj përgjigja e Resulullahut s.a.v.s. ishte e prerë se mbrojtësi i myslimanëve është vetëm Allahu, kurse idhujtarët nuk kanë asnjë mbrojtës. Ata thjesht ishin mbështetur në iluzione të rreme, se ata gurë e drunj që i gdhendnin e skalisnin vetë, ishin zota!

12. Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu do t'i shpjerë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!

Shpërblimi i atyre që besuan dhe krahas kësaj bënë vepra të mira duke respektuar urdhrat e Zotit, duke qenë altruistë dhe ndihmëtar të atyre që kanë nevojë, të tillët për shpërblim do ta kenë Xhenetin, me të gjitha hijeshitë dhe begatitë e tij, të përgatitura enkas për besimtarët. Aty do të jetojnë nëpër shtëpia, poshtë të cilave do të rrjedhin lumenj, ku do të shijojnë dhe përjetojnë kënaqësitë e përjetshme të Allahut të Madhërishtëm.

Në anën tjetër, ata që nuk besuan dhe preokupim të vetëm e kanë kënaqësinë e kësaj bote, duke mos çarë fare kokën për Ahiretin dhe jetën pas vdekjes, dhe duke ngrënë në këtë botë, ashtu siç hanë bagëtia, pa ndonjë kontroll, ata do të jenë banorë të Xhehenemit, duke shijuar ndëshkim pas ndëshkimi, përjetësisht. Ky do të jetë "shpërblimi" i arrogancës dhe vrazhdësisë së tyre shpirtërore, sepse mohuan Allahun, dhe iu mbështetën dikujt tjetër pos Tij.

13. Eh, sa shumë qytete, të cilat kanë qenë më të fuqishme se qyteti yt, që të ka përzënë, Ne i kemi shkatërruar dhe nuk kanë pasur asnjë ndihmës!

Allahu i Madhërishtëm ua dërgon një mesazh shumë të qartë idhujtarëve mekas nëpërmjet rrëfimit për debimin e Resulullahit s.a.v.s. nga Meka, i cili u detyrua të shpërngulej në Medinë, për ta vazhduar misionin e tij të shenjtë, pasi që një gjë e tillë iu pamundësua aty ku lindi dhe ku u gradua në Pejgamber. Ai ua bën me dije, se shumë qytete apo vendbanime të popujve të mëhershëm, të cilët ishin shumë më të fuqishëm e më të zhvilluar se ju në çdo aspekt u shkatërruan për shkak të mohimit dhe vrazhdësisë në sjelljet e tyre ndaj të dërguarve të Zotit dhe besimtarëve. Nëse ata që ishin shumë herë më të fuqishëm se ju, i shkatërruan, atëherë a nuk logjikoni se çfarë mund t'ju godasë juve, që rebeloheni ndaj Shpalljes hyjnore dhe dëboni të Dërguarin e Allahut nga vendlindja e vet?!

Vallë a nuk i shihni gjurmët e atyre që i shkatërruan prej të parit deri tek i mbrami, duke mos pasur ata ndonjë ndihmës, sepse ata në vend se të mbështeteshin te Allahu dhe ta besonin e ta merrnin Atë si mbrojtës, u mbështetën në idhujt të rremë e të shpifur, prandaj edhe pësuan shkatërrim në këtë botë e do të pësojnë ndëshkim të dhembshëm edhe në botën tjetër.

14. Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara dhe lëshohet pas pasioneve të veta?

Në këto dy ajetet e fundit, hasim në fraza dhe shprehje krahasimtare, të cilat sikur synojnë të ndezin logjikën dhe vetëdijen e fjetur të jobesimtarëve. Krahasimi i parë është i natyrës nëse mund të jetë njësoj ai që i përmbahet udhëzimit të Allahut dhe ndjek rrugën e dritës që e trasojnë të Dërguarit e Tij, me atë njeri të prishur, i cili lëshohet pas pasioneve të tij të ulëta dhe ndjek rrugën e shëmtuar të shejtanit. Sigurisht se nuk janë njësoj, sepse në mes këtyre të dyve, ekziston një dallim i madh esencial dhe përmbajtjesor, që është

Imani në njërën anë dhe *Kufri* në anën tjetër.

15. *Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtobet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pa ndotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehenemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!*

Në këtë ajet kuranor, Allahu xh.sh. përshkruan Xhenetin i cili iu është premtuar xhenetlinjve, të cilët me besimin e tyre të pastër dhe me veprat e tyre të mira, e merituan këtë vend si shpërblim të amshueshëm. Xheneti më i lartë e më i vlefshëm është Xheneti Firdevs, nga i cili rrjedhin lumenj me ujë të pastër e të pa ndotur, lumenj qumështi, lumenj me verë me shije të këndshme, por që nuk deh siç deh vera e kësaj bote dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Përveç që xhentelinjtë do ta shuajnë etjen nga ujët e këtyre lumenjve, ata në ta do të gjejnë freski e pranë tyre ka pemë që japin lloj-lloj frutash me asi shije, që njerëzit as i ka shijuar e as parë me sy gjatë jetës së kësaj bote.⁶

Në Xhenet, Allahu xh.sh. ka përgatitur për besimtarët asi mirësi, që syri i njeriut kurrë nuk i ka parë, zëra të mrekullueshëm që veshi kurrë nuk i ka dëgjuar dhe ka krijuar asi gjëra që njeriu as nuk ka mundur t'i imagjinojë e as t'i kenë shkuar ndërmend. Allahu i Lartësuar thotë: "Askush nuk e di se çfarë është ruajtur për ta nga kënaqësitë e syrit, si shpërblim për çfarë ata punuan." - (Es-Sexhde, 17).

Banorët e Xhenetit duken si mbretër në fronet e tyre nga ari. Mbi kokat e tyre kanë kurora me margaritarë, kurse rrobat e tyre janë prej mëndafshi të gjelbër. Imagjinoje veten të jesh i ulur në një fron të tillë e poshtë tej të rrjedhin lumenjtë e Xhenetit, gurgullima e të cilëve të shkakton

ndjesi të papërshkrueshme të kënaqësisë që kurrë nuk përfundon.

I Lartmadhërishti thotë: "Përshkrimi i Xhenetit që është përgatitur për të devotshmit (ndër të tjera është) se poshtë tij rrjedhin lumenjtë. Ushqimi dhe hijet e tij janë të përherëshme. Ky është përfundimi i atyre që ishin të devotshëm, ndërsa përfundimi i atyre që kanë mohuar është zjarri." - (Er-Rrad, 35).

Kurse grupi tjetër, të cilët nuk iu bindën Allahut, por e mohuan Atë dhe nuk e pasuan udhëzimin e Tij, do të jenë në zjarr të Xhehenemit, duke përjetuar ndëshkim pas ndëshkimi. Përshkrimi që i bëhet Xhehenemit në pjesën e fundit të këtij ajeti, kur Allahu xh.sh. tregon se atyre u jepet ujë i valuar që ua copëton e këput zorrët. Ushqimi i tyre do të jenë ferrat e pemës *zekum*, që u ngjajnë kokave të gjarpërinjve, kurse çdo gjë rreth tyre kundërmon erë të pistë e të padurueshme.

Prandaj, me plotë të drejtë, Allahu xh.sh. shtron një pyetje që thotë: Vallë a mund të krahasohen grupi i xhenetlinjve, teksa shijojnë begatitë e panumërta të Xhenetit, me këta njerëz të pabindur, që digjen e përcëllohen në flakërimat e zjarrta të Xhehenemit, duke përjetuar ndëshkim pas ndëshkimi. Sigurisht që jo!

Porosia e ajeteve (7-15)

- Ndihma dhe fitorja për besimtarët është e kushtëzuar me ngadhënjimin dhe përkrahjen e fesë së Allahut, duke zbatuar urdhrat e Fuqiptotit për mirësi dhe duke u larguar nga ato që Ai i ka bërë haram-të ndaluara.

- Ndëshkimi i jobesimtarëve do të jetë i dhimbshëm dhe i rëndë. Ata do t'i përfshijë hidhërimi i Allahut dhe do të përballen më poshtërim e përbuzje, duke qenë humbës në këtë botë, por humbja e tyre më e madhe do të jetë humbja e Ahiretit, kur do të dalin para Madhërisë së Allahut me vepra të asgjësuar.

- Pjesa e ajetit ku Allahu xh.sh. na bën me dije se do t'ua asgjësojë veprat jobesimtarëve, tregon për fundin e dhimbshëm që do ta përjetojnë mohuesit e Njëshmërisë, ndërsa në ajetin e katërt të kësaj sureje kur i Madhërishti flet për besimtarët që bien dëshmor në fushëbetje, thotë se atyre nuk do t'ua humbë apo asgjësojë veprat e tyre, përkundrazi do t'i udhëzojë e do t'i qetësojë mendjet, zemrat dhe shpirtrat e tyre me kënaqësitë e Xhenetit.

- Allahu xh.sh. i fton idhujtarët që të udhëtojnë nëpër tokë e të marrin mësim nga pësimet e popujve të pabindur përreth tyre, sikur populli i Hudit, i Salihut dhe i Lutit a.s., përndryshe do të shkatërrohen edhe këta, sepse e dëbuan të Dërguarin e Allahut prej vendit të tij të dashur ku u lind dhe u rrit.

- Besimtarët janë njerëzit më fatlumë, sepse besimi i tyre dhe mbështetja në Allahun, i fut ata nën mbrojtjen e Mbrojtësit më të mirë, Allahut xh.sh., ndërkohë që jobesimtarët nuk e kanë Allahun si Mbrojtës të tyre sepse gjatë jetës në këtë botë e mohuan dhe i përshkruajnë Atij shok.

- Besimdrejtët do të jenë vazhdimisht duke përjetuar kënaqësitë e papërshkrueshme të Xhenetit, kurse mohuesit e Njëshmërisë, do të digjen e do të ndëshkohen në zjarrin e Xhehenemit.

- vijon -

1. *Imam Sujutiu, Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli, f. 234; Në lidhje me shkakun e zbritjes së këtij ajeti, shih edhe Et-Tefsiru-l Munir, vëll. 26, f. 417. 2. E transmeton Tirmidhiu në El-Menakib, kreu: "Vlera e Mekës" 5/722 nr. (3935) me konstatimin: hadith "hasen garib sahih"; El-Hakimi në: El-Muštadrek 3/8, nr. (4271) me konstatimin: hadithi është në përputhje me kushtet e Buhariut dhe të Muslimit, por nuk e kanë transmetuar; Shih edhe: Et-Tefsir el mevdui li suveri-l Kuran, vëll. VII, f. 227. 3. Imam Sujutiu, Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli, f. 234. 4. Ndonëse Imam Sujutiu si shkak të zbritjes së këtij ajeti i ka përmendur fjalët e të Dërguarit a.s., i cili kur po e lëshonte Mekën, për të marrë rrugën e hixhretit, me lot në sy po shprehte pikëllimin e madh që ndjente në zemër, megjithatë, nuk mund të merret si argument i fortë për të qenë shkak i zbritjes së këtij ajeti. (Të vërtetën e di vetëm Allahu i Madhërishtë!). 5. Për më gjerësisht shih: Te'emmulat imanije fi sureti Muhamed, ff. 107-112. 6. Për më gjerësisht rreth kësaj tematike shih: Ibn Adil ed-Dimeshkij, El-Lubabu fi Ulum-l Kitab, Bejrut, 1998, ff. 443-444.*

Dr. Ajni Sinani

Vonesa e përgjigjes së Muhamedit a.s. ndaj idhujtarëve

Idhujtarët kurejshë donin që ta zinin ngushtë Muhamedin a.s., me pyetje që kishin të bënin me ndodhi të padëguara në Hixhaz (Mekë e Medinë), për të parë dhe për të provuar nëse Pejgamberi a.s. zotëronte ndonjë burim diturie mbi gjërat e fshehta e të papara.

Kurejshët mekas dërguan El-Nadr bin el-Harith dhe Ukbah bin Ebi Muajt, te rabinët hebrej në Medinë dhe u thanë atyre: “Pyeteni mbi Muhamedin, duke u përshkruar atyre cilësitë e tij dhe tregojuni për atë çfarë thotë ai, sepse ata janë ithtarë të librit. Ata kanë njohuri që ne nuk i kemi nga dija e profetëve.” Kështu Nadiri dhe Ukbeh shkuan deri në Medinë dhe pyetën rabinët hebrej për Muhamedin a.s., duke ia përshkruar atyre çështjen e tij dhe disa nga thëniet e tij dhe u thanë atyre: “Ju jeni populli i Tevratit dhe ne erdhëm te ju për të na treguar për këtë mikun tonë.” Rabinët çifutë thanë: “Pyeteni atë për tri gjëra që ne ju urdhërojmë dhe nëse ai ju tregon për to, atëherë ai është një pejgamber i dërguar. Dhe nëse ai nuk e bën, atëherë ai është një njeri trillues, prandaj ikni prej tij. Pyeteni për disa të rinj që lanë popullin e tyre se ç’u bë me ta, sepse ngjarja e tyre është e habitshme; pyeteni për një udhëtar të largët që mbërriti në skajet e Tokës në Lindje e Perëndim; dhe pyeteni për shpirtin, ç’është ai. Nëse ju dëfton këto të tria ndiqeni se është vërtet Pejgamber, nëse nuk e bën këtë, atëherë ai është pretendues i rrejshëm.”¹

Kështu Nadiri dhe Ukbeh u kthyen në Mekë te kurejshët dhe thanë: O popull kurejsh, ne kemi ardhur të ndajmë atë që është mes

jush dhe Muhamedit. Rabinët hebrej na kanë urdhëruar që ta pyesim atë për disa gjëra. Nëse ju tregon për ato, atëherë ai është profet, e nëse nuk e bën, atëherë ai është njeri i thashethemeve.

Më pas idhujtarët kurejshë shkuan tek i Dërguari i Zotit dhe i thanë: “O Muhamed, na trego për djelmoshat e rinj që ishin më herët, ngjarja e tyre ishte e çuditshme, na trego për një njeri që kishte arritur në Lindje dhe Perëndim të Tokës dhe na trego për shpirtin, çfarë është ai?”

Muhamedi a.s. u tha atyre: “Unë do t’ju njoftoj për këto nesër”. Ata u larguan prej tij. Por Pejgamberi a.s. nuk tha ‘në dashtë Zoti’, dhe kur erdhën idhujtarët për të marrë përgjigjet, atij iu deshtë t’i kthente

pas, dhe kështu vazhdoi ditë pas dite, gjersa kishin kaluar 15 net dhe ai nuk kishte marrë asnjë shpallje, e as Xhibrili nuk i kishte ardhur që kur i ishin bërë këto pyetje. Njerëzit e Mekës u tronditën dhe filluan të thonë: ‘Muhamedi na premtoi dhe tha nesër, kurse sot është e pesëmbëdhjeta natë dhe ai nuk po na tregon asgjë nga ajo që e pyetëm. Ky vonim i shpalljes ishte i vështirë për të Dërguarin a.s.. Idhujtarët nisën të tallen me Muhamedin a.s. dhe fjalët e tyre e mërzitën dhe e trishtuan shumë, pasi ndihma nuk erdhi ashtu siç kishte shpresuar.’²

Pastaj atij i erdhi Xhibrili me suren El-Kehf (*Kaptina e shpellës*) dhe i tregoi për atë që e kishin pyetur idhujtarët.



Përse Muhamedi a.s. duhej të shkruante një libër i cili e detyronte t'i thoshte popullit se ai ishte i pafuqishëm dhe nuk dinte asgjë mbi forcat e mistershme?!:

Në këtë sure përshkruhen dy çështjet për të cilat e kishin pyetur idhujtarët:

1. Çështja e atyre të strehuarve në shpellë ishte një nga mrekullitë e Zotit. Banorët e shpellës, ishin disa djelmosha të rinj besimtarë, të cilët u larguan prej vendlindjes së tyre, me qëllim që ta ruanin besimin dhe u strehuan në një shpellë, ku ndenjën treqind e nëntë vjet, e pastaj Allahu i zgjoi prej atij gjumi aq të gjatë:

“A mos mendove ti, se ata të vendosurit e shpellës dhe Rekimit ishin nga mrekullitë Tona më të çuditshme? Kur djelmoshat u strehuan në shpellë e thanë: “O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!” (El-Kehf, 9-10).

2. Sundimi i Dhulkarnejnit, një sundimtari të drejtë e të devotshëm, të cilit Zoti i kishte dhënë pushtet të gjerë në Lindje e Perëndim, dhe i cili ndërtoi një pendë të madhe: “Të pyesin ty për Dhulkarnejnin, thuaj: “Do t’ju rrëfej për punën e tij me Kuran (me shpallje)”. Ne i mundësua atij forcë në tokë dhe i dhamë mundësi për çdo send që të mund ta arrijë.” (El-Kehf, 83-84).

3. Kurse për shpirtin ka zbritur në suren El-Isra: “Të pyesin ty për shpirtin; Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.” (El-Isra, 85).

Me këtë ajet kuranor tregohet se rreth shpirtit nuk di askush pos Zotit, çështja e shpirtit është çështje sekrete, prandaj çdo përpjekje për shpjegimin e tij është vetëm hame-

ndje. Komentuesit e Kuranit thonë: Kur njerëzit e pyetën Pejgamberin a. s. për tri çështjet, Muhamedi a. s. u tha: “Unë do t’ju përgjigjem për to nesër.” Ai nuk tha: ‘Në dashtë Allahu’, kështu që shpallja u mbajt pesëmbëdhjetë ditë. Me këtë vonës të Shpalljes, Pejgamberi a.s. ishte ngushtuar shumë. Më pas zbriti ajeti i madhërishtëm:

“Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: ‘Unë do ta bëj këtë nesër’, vetëm (nëse i shton): ‘Në dashtë Allahu!’ E kur të harrosh, përmende Zotin tënd dhe thuaj: “Shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij (të as-habi kehf)”. (El-Kehf, 23-24).

Përmes vonesës së Shpalljes, Muhamedit a.s. i bëhet me dije se çdo punë që ka ndër mend ta kryejë në të ardhmen duhet ta lidhë me vullnetin e Allahut dhe të mos thotë: ‘Do ta bëj’, pa thënë: ‘Insha Allah’, e nëse harron në atë moment, ta thotë më vonë. Ky ajet tregon se si duhet të thoshte Pejgamberi a.s. dhe si duhet të thonë edhe besimtarët në rastet e kështilla.

Pastaj Muhamedit a.s. i tërhiqet vërejtja se përse e hidhëronte veten aq shumë për kurejshitet që nuk e besonin Kuranin:³ “A thua ti do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kuranit)?” (El-Kehf, 6).

Atyre që thonë se Muhamedi s.a.v.s. e shkroi vetë Kuranin, u themi: Përse Muhamedi a.s. duhej të shkruante një libër i cili e detyronte t'i thoshte popullit se ai ishte i pafuqishëm dhe nuk dinte asgjë mbi forcat e mistershme?!: “Thuaj: “Unë nuk ju them juve se i kam në kompetencë depot e Allahut (e t’ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t’ju tregoj, se kur do t’ju vijë dënimi), as nuk ju them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua. Thuaj: “A janë baras i verbri dhe ai që sheh?” A nuk mendoni?” (El-Enam, 50).

Pejgamberi a.s. pyetej për disa çështje dhe ai nuk u përgjigje pyetjeve aty për aty. Ndodhte që të kalonte kohë e gjatë në heshtje, derisa zbriste ndonjë ajet nga Kurani fisnik

në lidhje me ato pyetje. Ai e kërkonte pyetësin dhe ia lexonte atij atë që kishte zbritur nga Kurani në lidhje me pyetjen e tij.⁴

Washington Irving e pranon faktin se “Profeti, gjatë përhapjes së Islamit, pësoi shumë tortura dhe sakrifiko shumë. Madje, shumë dyshuan në vërtetësinë e thirrjes së tij. Kaluan disa vjet, duke mos pasur sukses të madh.”⁵

Prof. Bevan bën të qartë se: “Të flasësh për Muhamedin a.s. si mashtrues dhe përdorues të forcës, më shumë shkakton probleme sesa i zgjidh ato.”⁶

Karlajl pohon se: “Muhamedi a.s. nuk është dëfrayer sikurse mashtruesit e tjerë me forma të rreme dhe nuk ka shkuar pas ideve të dëmshme; ai nuk ia ka lejuar vetes të stoliset me gënjeshtria dhe ligësi.”⁷

Prandaj, sikurse shkruan edhe Martin Lings: “Vonesa e përgjigjes hyjnore, ndonëse e dhimbshme për të Dërguarin e Zotit dhe pasuesit e tij, ishte me të vërtetë një forcë e madhe për të. Armiqtë e tij e mohuan domethënien e kësaj vonese, por për ata kurejshë që ishin akoma të pavendosur, ky fakt ishte një pohim i qartë i asaj se Fjala e Shenjtë i vinte Muhamedit a.s. nga Qielli dhe se ai nuk kishte gisht, e as nuk mund ta kontrollonte atë. Është e kuptueshme se po të ishte se Muhamedi a.s. do t’i kishte trilluar të gjitha ato çfarë kishte thënë më parë, ai nuk do të ishte vonuar kaq gjatë për këtë ‘trillim të ri’, veçanërisht në një çast të tillë kur reziku qe mjaft i madh.”⁸

1. Kujershun temahin Resul Allah, Muhamed Rida, Kitab Muhamed salaAllahu alejhi ve selem, shih: <https://shamela.ws/book/12935/120>.

2. Ibid. 3. Kurani përkthim me komentim në gjuhën shqipe, përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, shih komentim 224 në f. 323. 4. Dr. Muhamed Seid Ramadan El Buti, Fikhu Sire, studime metodologjike-shkencore për biografinë e Muhamedit alejhi selam, Shkup, 2018, f. 86. 5. Washington Irving, Biografia e Muhamedit, f. 72, shih: Ajni Sinani, “Të tjerët për Islamit”, Prishtinë, 2015, fq. 126. 6. Pamfleti: Ishte shpata që përhapit fenë islame apo e vërteta e saj, Drita Islame, Tiranë, 1996, nr. 11 (94), f. 4, shih: Mr. Ajni Sinani, “Të tjerët për Islamit”, op. cit., f. 142. 7. Tomas Karlajl, shih: Dituria Islame, revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, nr. 358, viti 34, Prishtinë, shtator 2020/ safer 1442, f. 43-44. 8. Martin Lings, Muhamedi: jeta e tij sipas burimeve më të hershme, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2011, f. 93; Hamza Mustafa Njazi, op. cit., f. 16, shih: Mr. Ajni Sinani, “Të tjerët për Islamit”, op. cit., f. 114.

Mr. Muhidin Ahmeti

Çfarë na mëson Kurani?!

“Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është rruga e vetme e vërtetë (më e qëndrueshmja dhe më e fuqishmja), e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzojnë se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.” (El Isra, 9)

Falënderuar qoftë Allahu xh.sh., i cili na e dërgoi Kuranin si udhëzim: “(Ky është) Libri, që të është zbritur ty, që me të t’ua tërheqësh vërejtjen dhe t’i këshillosh besimtarët, pra të mos ketë shtrëngim në gjoksin tënd (për kumtimin e tij).” (El-Araf, 2), dhe si paralajmërim: “...Thuaj: “Allahu është Dëshmues mes meje e jush, e mua më është shpallur ky Kuran që metë t’ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në Ditën e Kijametit)....” (El-En’am, 19), dhe si dritë për të shpëtuar nga terri: “Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t’i nxjerrish njerëzit prej errësirave në dritë...” (Ibrahim, 1), dhe si shërim e mëshirë për besimtarët: “Ne të shpallim Kuranin, që është shërim dhe mëshirë për besimtarët ...” (El-Isra, 82).

Salavate qofshin për të dërguarin tonë Muhamedin a.s., të cilit iu dorëzua Kurani në zemër.

“E Kurani është me siguri shpallje e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). E solli në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen.” (Esh-Shu’ara, 192-194)

Kurani u erdhi në dorë njerëzimit i përkryer, pa të meta dhe deformime, si Fjala e madhërisme e Zotit, si udhëzimi më i mirë në çdo kohë për njeriun, dhe si porosia e fundit e Zotit për qenien tokësore, por edhe për ato jashtëtokësore. Kurani është udhërrëfyes për të gjithë njerëzit dhe në veçanti për besimtarët. Ky libër është krenari për myslimanët dhe

Kurani është Shpallja, Fjala dhe e vërteta e paprekshme dhe e parevokueshme e Allahut xh.sh..

dëshmi e dinjitetit të tyre. Njeriu s’mund të shkruajë as edhe një sure të vetme si suret në Kuran. Kurani është dhuratë mbinatyrore në mesin e religjioneve të Zotit dhe dhuratë speciale për Profetin e Zotit, Muhamed Mustafanë.

Për të gjithë myslimanët e botës, Kurani është Shpallja, Fjala dhe e vërteta e paprekshme dhe e parevokueshme e Allahut xh.sh.. Ai është udhëzim që na mëson si të besojmë, si të jetojmë, si të punojmë, si të veprojmë (sillemi) dhe si të organizohemi në familje, xhemat e popull. Ai është porosia dhe mesazhi i fundit për mbarë njerëzimin. Ai është paralajmërimi i fundit, vërejtja e fundit për mbarë botën.

“Ha, Mim. Kjo është shpallja nga i Gjithëfuqishmi, Mëshirëploti. Ky është libri, ajetet e të cilit janë të shkoqitur mirë. Ky është Kurani në gjuhën arabe për njerëzit që kanë dije. Sjell lajme të gëzuara dhe paralajmëron (për pasojat e rrugës së gabuar).” (Fussilet, 1-4).

Myslman, pa Kuran, nuk ka. Ymet apo bashkësi të organizuar të myslimanëve, pa Kuran, nuk ka. Besim në botën e padukshme, sikurse janë: melaqet, shejtanët, xhinët, shpirti, berzahu, ahireti, xheneti dhe xhehenemi, pa Kuran, nuk ka. Shpjegim se kush e krijoi botën dhe

jetën, pa Kuran, nuk ka. Përgjigje për pyetjen se kush jemi, përse jemi këtu dhe se ku do të shkojmë, pa Kuran, nuk ka.

Pikërisht për këtë arsye, kur Pejgamberi i nderuar, Muhamed Mustafaja u nda nga bashkësia myslimane, i la amanet dy gjëra të mëdha e të çmuara për ymetin, të njohura si “thekalejn”: “Po ua lë pas meje dy gjëra amanet, në qoftë se do t’u përmbaheni atyre, kurrë nuk do të humbni nga rruga e drejtë, e ato janë: Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit të Zotit. Këto dy gjëra nuk do të ndahen (nuk do t’i bien ndesh njëra-tjetrës) deri në Ditën e Gjykimit.” (Ebu Hurejre r.a.)

Këto janë dy testamente që duhet t’i ketë në shfrytëzim çdo njeri, çdo familje, çdo bashkësi, çdo popull, çdo komb, çdo shtet dhe çdo shoqëri në përgjithësi. Për këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ajo shtëpi (familje) ku lexohet, mësohet dhe shpjegohet Kurani, shkëlqen për banorët e qiellit, sikurse yjet që shkëlqejnë dhe shndrisin banorët e Tokës.” (Aisheja r.a.)

Kurani është burimi i imanit tonë, d. m. th. burim nga i cili frymëzohemi, i cili na jep edhe më tepër fuqi dhe vendosmëri që të qëndrojmë të pathyeshëm në nënshtrueshmërinë ndaj Allahut të Lartësuar. Besimi dhe Kurani janë drita të cilat Allahu xh. sh. i vendos në zemrën e atij që Ai dëshiron, dhe ato janë bazë e çdo veprë të mirë edhe në dynja, edhe në Ahiret. Njohja e imanit – besimit dhe Kuranit është dituria më madhështore, e në esencë, nuk ka dituri, nga e cila mund të përfitojë

njeriu aq sa mund të përfitojë duke njohur imanin- besimin dhe Kurantin.


Secila sure (kapitull) e Kuranit e furnizon lexuesin e Kuranit me një fond të jashtëzakonshëm emocional që kanë ndikim direkt në të dhe e formojnë atë. Secila sure ka atmosferën e vet të veçantë, fjalët e veçanta, mënyrën e të shprehurit, idenë, që të gjitha këto lindin emocione të veçanta, ashtu që surja i ngjanë qenies së gjallë që merr frymë, lëviz, na bën shoqëri, inicion mendime, zgjon një spektër ndjenjash të larmishme, të cilat luajnë rol tejet të madh në përqaftimin e porosisë.

Personi që shoqërohet me Kurantin, duke i kaluar faqet e tij, fiton përshtypjen që secila sure është sikur një dhomë, laborator, që me përmbajtjen e tij, projektton emocione të caktuara, duke ia zgjuar dhe freskuar pjesë – pjesë zemrën, duke i kushtuar vëmendje perfekte të gjitha aspekteve emocionale të tij. Pas një mësimiliximi të kujdesshëm, të drejtë dhe me kuptim të 114 sureve të Kuranit, e tërë zemra bëhet e zgjuar dhe e përfshirë nga drita e të kuptuarit të drejtë, ndërsa mendja bëhet e aktivizuar dhe e orientuar nga absorbimi dhe përpunimi i drejtë i informacioneve.

Këtu qëndron sekreti i këshillës së Pejgamberit a.s. që të lexojmë Kuran çdo ditë, të paktën një xhuz, meqë kjo është mënyra për t'i ruajtur zemrat tona nga vdekja parciale, në fund edhe nga vdekja e plotë e organit, i cili nëse është në rregull (funksionon mirë), e tërë qenia do të jetë në rregull dhe anasjelltas.

Disa dijetarë thonë, kujt i kalon një muaj, e gjatë asaj kohe, të paktën një herë, nuk e ka lexuar tërë Kurantin, këndojani atij personi 4 tekbiere (duke aluduar në xhenazen e zemrës së vrazhdë, të ngurosur, të vdekur). Allahu na ruajt nga ai mallkim.

Është fakt i njohur që ndikimi kuranor nuk është i kufizuar vetëm në domethëniet e fjalëve dhe ndikimin e tyre, sepse, përndryshe si do të shpjegonim ndikimin e Kuranit të njerëzimit, të cilët nuk e kuptojnë



gjuhën arabe, të të paditurit, fëmijët, jobesimtarët?!

Ata, të cilët e lexojnë Kurantin ndahen në disa kategori. Ka prej atyre të cilët e lexojnë Kurantin, por nuk e kuptojnë. Ka prej atyre të cilët e lexojnë dhe e zbkurojnë zërin e tyre që ta dëgjojnë të tjerët se e ka melodinë-mekamin e mirë, por nuk mendojnë për domethëniet e tij. Të paktë janë ata, të cilët derisa janë duke lexuar Kurantin mendojnë dhe meditojnë për kuptimet dhe domethëniet e tij, edhe më të paktë janë ata të cilët derisa janë duke lexuar Kurantin zemrat u dridhen e sytë u mbushem me lot.

“Librin që po ta shpallim është plotë begati e bekime, në mënyrë që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Kurani është udhëzimi i Allahut, drita e qartë, shëruesi i vlefshëm, roje nga gjynahet për atë që i përmbahet atij, shpëtim për atë që e ndjek.

“Lexojeni atë sa më shumë, sepse Allahu do t'ju shpërblejë për të, për çdo shkronjë dhjetë sevape. Nuk them që “elif-lam-mim- është një shkronjë, por “elif” është një, “lami” është i dyti dhe “mimi” është harfi i tretë.”

Ndërsa në hadithet e tjera, Resullullahu a.s. ka thënë: “Kush e këndon ajetu-l-Kursinë pas çdo namazi, vetëm vdekja e ndan prej Xhenetit.”

“Këto zemra me të vërtetë mund të ndryshken, sikurse ndryshket hekuri kur laget në ujë.”

-E si do t'i pastrojmë, o Pejgamberi i Zotit – pyeti dikush ?

-“Nëse mendojmë shumë për vdekjen dhe nëse këndojmë Kuran” – u përgjigj Muhamedi a.s. (Bejhikiu)

“Kur njerëzit mblidhen në xhami për të kënduar Kuran dhe për ta studiuar atë, Allahu xh.sh. do t'u ofrojë paqe e siguri, do t'i mbulojë me rahmetin e Tij, do t'i rrethojë me melaqe dhe do t'i përmendë në shoqërinë e melaqeve, pejgamberëve dhe njerëzve të mirë.” (Ebu Davudi).

“Kush dëgjon një ajet nga Libri i Allahut, Allahu do t'ia dyfishojë shpërblimin. Mirëpo, kush e lexon një ajet nga Libri i Allahut, ai do t'i bëhet dritë në ditën e Gjykimit.” (Ahmedi nga Ebu Hurejre).

I dashuri vëlla,

Po e shkruaj këtë hytbe për ty që je në sprovën e madhe të kohës moderne, në presionin e përditshëm të punës, të mësimin dhe të obligimeve të tjera të ndryshme.

Vërtet kjo është koha e shpejtësisë, nxitimit dhe dinamikës së tmerrshme. Të gjithë duan të punojnë, të mësojnë, të fitojnë më shumë, edhe më shumë, gjithnjë e më shumë.

Si t'ia bëjmë që të mos e harrojmë Allahun, Zotin e Dashur dhe Fisnik në këtë labirint të dynjasë? Çfarë të bëjmë që zemrat tona të mos robërohen nga synimet për përfitime materiale, për grumbullimin e pasurisë, për epshet e shfrenuara, por që në to të mbetet besimi i sinqertë tek Allahu, dashuria e sinqertë, nënshtrimi dhe bindja ndaj Tij dhe Pejgamberit të Tij, Resulullahut të dashur?

Këto pyetje duhet t'u interesojnë të gjithëve, edhe mua, edhe ty. Më beso, mos i nënvlerëso ato! Kuptoje se në asnjë mënyrë nuk duhet të harrosh Allahun për shkak të punës, sepse të harruarit e Allahut fshin pamëshirshëm imanin nga zemra e njeriut!

A nuk ke dëgjuar për ajetin kuranor që thotë: “E mos u bëni si ata që e harruan Allahun, e Ai (Allahu) bëri që ata ta harrojnë vetveten! Të tillët janë ata të prishurit.” (El-Hashr, 19)

Përpiqu çdo ditë të shoqërohesh me Kuranin dhe me përkthimin e tij. Vërtet, Islami është fe madhështore, fe që përfshin çdo segment të jetës, përkatësisht është fe që paraqet një sistem të rrumbullakuar, mënyrën e jetës së gjithmbarshme, si të një individit, ashtu edhe të tërë shoqërisë. Meqë asnjë punë serioze nuk mund të bëhet pa literaturë të përshtatshme, edhe neve na duhet një “libër i jetës islame”, një rikujtues konkret dhe një udhëzues konkret, e ai është Kurani, Libri i Allahut. Meqenëse, për shkak të obligimeve të ndryshme në punë, në familje, në shkollë etj., ke pak kohë në dispozicion, të porosis që çdo ditë të mundohesh t'i lexosh fillimisht vetëm dy faqe të Kuranit (jo më shumë se kaq) në gjuhën arabe (nëse di, e nëse këtë akoma nuk e ke mësuar, të propozoj që të gjesh kohë e të regjistrohesh në kursin e Kuranit dhe ta mësosh atë) dhe më pastaj të lexosh me kujdes përkthimin e tij.

Po ta propozoj këtë radhitje, sepse vetëm teksti origjinal i Kuranit në gjuhën arabe është në të vërtetë Fjala

e Allahut (çdo përkthim është vetëm një përkthim njerëzor i tekstit dhe asnjëri prej tyre nuk kanë prejardhje drejtpërsëdrejti nga Allahu) dhe i vetmi ai e ka atë cilësi që leximi i tij i shlyen gjynahet nga zemra jote dhe i shkruan veprat e mira në librin tënd, qoftë edhe nëse asgjë nuk ke kuptuar nga ajo që e lexon. Po ashtu, vetëm teksti origjinal arabisht i Kuranit është ilaç dhe mbrojtje prej sëmundjeve të ndryshme, edhe fizike edhe psikike. Po, meqë cilësia më e rëndësishme është ajo që të udhëzon në rrugën e drejtë, ti nuk guxon të mbetesh aty, por patjetër duhet të lexosh edhe përkthimin e asaj që e ke lexuar në gjuhën arabe.

Këtu nuk ka rëndësi aspak sasia, por me rëndësi është vazhdimësia dhe cilësia e mësimin dhe studimit të Kuranit. Domethënë, nuk do të arrish shumë nëse një ditë këndon dhe lexon njëqind faqe, e pastaj një muaj me radhë nuk e merr fare Kuranin në dorë. Jo, mos e bëj këtë në asnjë mënyrë, sepse Kurani, marrë guximin të them, është shpallur më shumë për ty që të ta kujtojë vazhdimisht dhe çdo ditë Krijuesin dhe Zotin tënd dhe Ditën e Gjykimit si dhe për të të udhëzuar në rrugë të drejtë në këtë jetë.

Prandaj më e rëndësishme është vazhdimësia në leximin dhe studimin e Kuranit, sepse pikërisht ai, karshi baticave të presioneve dhe problemeve të kësaj bote, ta bën të pamundur ta harrosh Allahun dhe obligimet e tua ndaj Tij.

Prandaj, mos e ngarko veten tënde. Lexoji vetëm nga dy faqe në ditë, por për çdo ditë, pa përjashtim. Nëse do të veprosh kështu do të duhen, nëse do Allahu, dhjetë muaj që të lexosh krejt Kuranin, e kur ta mbarosh, fillo përsëri nga fillimi, sepse qëllimi është që të shoqërohesh me Kuranin çdo ditë, tërë jetën.

Caktoji vetvetes një kohë që e ke më të përshtatshme për këtë. Mund t'i lexosh në mëngjes para se të shkosh në punë, apo në shkollë. Mundesh në mbrëmje para fjetjes. Me siguri nuk do të duhen më shumë se gjysmë ore, sepse fjala është vetëm për dy faqe.

Përveç vazhdimësisë është e rëndësishme edhe cilësia e studimit të Kuranit. Duhet ta dish që Kurani nuk mund të lexohet siç lexohet çfarëdo libër tjetër. Mos lejo që ta kesh zemrën indiferente ndaj ajeteve të Kuranit. Lexoi ngadalë me kujdes dhe përpiqu t'i “ndjesh me zemër” dhe “t'i ringjallësh nga brenda” sa më shumë që mundesh, sepse Allahu i Lartësuar, pikërisht për këtë na paralajmëron në ajetin vijues:

“Këta janë ata pejgamberët që Allahu i gradoi nga pasardhësit e Ademit, prej pasardhësve të atyre që i patëm bartur (në anije) bashkë me Nuhun, prej pasardhësve të Ibrahimit dhe të Jakubit (Israilët), dhe prej atyre që i udhëzuam dhe i bëmë të zgjedhur; kur u lexoheshin atyre ajetet e Zotit, binin në sexhde dhe qanin.” (Merjem, 58)

Kur të kuptosh porosinë e ajeteve të Kuranit, merr vendim të fuqishëm që ato t'i zbatosh në jetën tënde me këmbëngulje dhe sa më shumë që mundesh. Vepro kështu me të vërtetë.

Kurani, të nderuar vëllezër, është libër i hapur dhe i përshtatshëm për të gjithë. Çdokush mund të gjejë tek ai atë çka i duhet, natyrisht sipas aftësive të tij. Në atë libër janë të gjitha të vërtetat dhe të gjitha të mirat, të cilat i zbulojnë njerëzit, i formulojnë me fjalët e tyre dhe i shfrytëzojnë në mënyrën e tyre. Shkurt, aty janë të gjitha të vërtetat dhe të mirat e dynjasë dhe të Ahiretit.

Njeriu ka pranuar nga Allahu një amanet të madh, tepër të madh, e ai është Kurani Kerimi, prandaj të shikojmë mirë, vëllezër të dashur, që atë amanet të mos e neglizhojmë dhe të mos e tradhtojmë dhe që të mos jemi prej atyre, të cilët Kurani do t'i mallkojë, por të jemi prej atyre, për të cilët Kurani do të ndërmjetësojë në Ditën e Gjykimit.

O Allah! Bëj që Kurani të na bëhet shok dhe prijës në këtë botë, ndërmjetësues në Ditën e Kiametit, dritë në rrugë dhe udhërrëfyes e imam në veprat e mira. Amin!

Resul ef. Rexhepi

Disa pyetje dhe përgjigje praktike

Përgjigjet e dhëna më poshtë, në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si fetva, por janë thjesht përgjigje në pyetjet e parashtruara nga disa vëllezër besimtarë, sepse unë konsideroj se fetva mund të ofrojë vetëm institucioni e jo edhe individi jomuxhtehid.

Shumë besimtarë dhe dashamirë të mi, gjatë bisedave me ta, shpeshherë më pyesin për disa çështje të cilat iu interesojnë. Ka ndodhur që dikush të më marrë madje edhe në telefon dhe të më pyesë, f.v. rreth marrjes së borxhit për të shkuar në haxh, ndërkohë që një miku im i moçëm, pasi kishte marrë injeksionin për ta nxjerrë dhëmbin, më pyeti nëse e ka prishur agjërimin e asaj dite...? Me kalimin e kohës, fitova përshtypjen se pyetjet janë mjaft praktike dhe aktuale, prandaj fillova edhe t'i shënoja në një fletore personale. Jo rrallëherë kam shfletuar edhe literaturë përkatëse nga librat bazë të fikhut të shkollës juridike hanefite lidhur me disa nga këto pyetje të parashtruara.

Më vonë, vendosa që disa prej tyre t'i qesë në letër, me të vetmin qëllim që ndoshta ndonjë lexues kureshtar mbase edhe mund të përfitojë sadopak nga këto shënime!

Përgjigjet e dhëna më poshtë, në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si fetva, por janë thjesht përgjigje në pyetjet e parashtruara nga disa vëllezër besimtarë, sepse unë konsideroj se fetva mund të ofrojë vetëm institucioni e jo edhe individi jomuxhtehid.

Në vazhdim, po jap disa nga këto pyetje si dhe përgjigjet për to, gjithnjë duke e lutur Allahun e Gjithëmshirshëm të më falë për ndonjë lëshim eventual me pa dashje.

Kam dëshirë të shkojë në Qabe për ta kryer haxhin, mirëpo, mjetet financiare që i kam tubuar, nuk më mjaftojnë. A më lejohet të hyj në kredi bankare ose t'i huazojë nga një mik, me qëllim që t'ia kthej sapo të më jepet mundësia?

Haxhi është shtylla e pestë e fesë islame, është ibadet i cili i ka kushte dhe dispozita të përcaktuara në mënyrë strikte, e të cilat duhet t'i plotësojë personi që dëshiron ta kryejë atë. Një prej kushteve ecenciale për ta kryer haxhin, është edhe posedimi i mjeteve të nevojshme financiare. Në rast se një besimtar nuk e posedon sasinë e nevojshme të mjeteve materiale, atëherë nuk e ka obligim kryerjen e haxhit. Personit i lejohet mbase ta plotësojë sasinë që i

mungon, me pak mjete hua, gjithnjë me kusht që të ketë p.sh. palujtshmëri ose makinë, që arrin ta mbulojë vlerën apo sasinë e mjeteve të huazuara e madje edhe më shumë. Përveç kësaj, ai në rast se e merr rrugën e haxhillëkut, gjithsesi duhet t'i porosisë trashëgimtarët e tij që, në rast se nuk kthehet i gjallë nga haxhi, ta kthejnë huan nga pasuria e tij.

Ndërkohë, marrja e kredisë nga banka për kryerjen e haxhit, nuk është e lejuar, pavarësisht sasisë së kamatës, qoftë e vogël (e butë) apo më e madhe.

A mund t'i shkurttojme dhe t'i bashkojmë namazet kur udhëtojmë jashtë vendbanimit tonë, qoftë për piknik ose për një vikend?



Sipas shkollës hanefite, kur një udhëtar i plotëson kushtet e udhëtarit (mysafirrit), ai duhet t'i shkurtojë namazet katër rekateshe, por jo edhe t'i bashkojë dy namaze përnjëherësh. Për ta plotësuar kushtin e shkurtimit, duhet të keni udhëtuar mbi 90 km. dhe të qëndroni në një vend më pak se 15 ditë. Nëse shkoni p.sh. nga Prishtina në Tiranë ose anasjelltas dhe keni vendosur që të qëndroni 3 ditë, namazet katër rekateshe duhet t'i shkurtoni duke i falur dy rekate, dhe atë kur faleni vetëm. Ndërsa, nëse faleni pas imamit vendor, i cili i falë namazet e plota, ju duhet t'i mbështeteni atij imamit, dhe t'i falni pas tij katër rekate të plota.

Me një rast, dikush kishte thënë se gjatë një udhëtimi nuk i kishte shkurtuar namazet, dhe kur për këtë kishte dëgjuar haz. Omeri, ai qe hidhëruar dukshëm dhe kishte thënë: "Po kush na qenka ai burrë që nuk e pranua lehtësimin e Zotit?!!!"

Mbani mend, se duhet kushtuar një vëmendje të posaçme që për t'u shkurtuar namazet, duhet të plotësohen këto kushte:

1. Distanca e udhëtimit duhet të jetë mbi 90 km., dhe

2. Qëndrimi në atë vend ku udhëton të jetë më pak se 15 ditë.

Kurse sa i përket bashkimit të dy namazeve, kjo sipas shkollës sonë juridike hanefite, nuk lejohet.

Aktualisht gjendjen materiale e kam të mirë sepse kryej një punë për të cilën marrë një rrogë solide. Mirëpo, e kam një borxh të mëhershëm të cilin akoma nuk e kam kthyer. Më intereson: a duhet kthyer borxhin apo duhet dhënë zekatin?

Nga mjete solide financiare që aktualisht i posedoni, ju fillimisht duhet ta ndani një sasi për shlyerjen e borxhit që e keni, kurse pjesën e mbetur duhet ta llogaritni për dhënie të zekatit.

Kthimi i borxhit ka përparësi në këtë rast, dhe është prioritet, e pastaj për pjesën e mbetur duhet dhënë zekatin.

Nuk duhet harruar se zekati në të holla i ka dy kushte:



1. Që sasia e mjeteve financiare të ketë arritur nisabin, (këtë vit është llogaritur 5105 euro), dhe

2. Që atë pasuri (ato mjete) ta ketë pasur në posedim më shumë se një vit të plotë lunar (hixhrij).

Zekatin e mjeteve të borxhit duhet ta jep huadhënësi.

A mund të na shpjegoni diç rreth sexhdes së leximit (sexhde tilave). Çka ndodh nëse këtë sexhde nuk e bëjmë gjatë namazit? Si duhet të veprojmë kur e lexojmë suren "El-Alek" e cila në fund të saj e ka ajetin e sexhdes ose suren "El-Inshikak" në një rekate? E mora si shembull këtë sure sepse ajo i ka gjithsej 25 ajete, e pas leximit të ajetit 21 duhet bërë sexhde tilave.

Sexhde tilavetin ose sexhden e leximit duhet bërë menjëherë pas leximit të ajetit të sexhdes në namaz. Në Kuran janë gjithsej 14 ajete të tilla, kështu që pas leximit të njërit prej tyre, si lexuesi ashtu edhe dëgjuesi e kanë obligim bërjen e një sexhdeje, e cila me këtë rast është vaxhib. Sipas dispozitave të fikhut në medhhebin tonë, sexhde tilaveti në namaz është obligim i menjëhershëm (vaxhib mudajjek), sepse është bërë në bazë të asaj që është pjesë e namazit (rezultat i kiraetit në namaz), prandaj edhe veprohet sipas rregullave të namazit, sepse bëhet pjesë e namazit.

Nëse një person teksa po falej, e dëgjon ajetin e sexhdes nga një person tjetër jashtë namazit, ai atë

sexhde do ta bëjë pas përfundimit të faljes së namazit e jo në namaz.

Në qoftë se besimtari në namaz e lexon suren "El-Alek" të tërën, e dihet se në fund të saj është ajeti i sexhdes, pas leximit të atij ajeti, shkon në ruku dhe në sexhde, duke i bashkuar njëkohësisht të dyja: sexhden e rekatit dhe atë të leximit-tilavetit.

Ndërkaq, nëse në namaz e lexon suren "El-Inshikak", pas ajetit të saj të 21-të, fillimisht duhet ta bëjë një sexhde tilave dhe të ngrihet në kijam për të vazhduar me leximin edhe të ajeteve vijuese, e pastaj vazhdon normalisht namazin deri në fund.

Ebu Hurejreja transmeton hadithin sipas të cilit Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kur i biri i Ademit e lexon ajetin e sexhdes dhe bënë sexhde, shejtani largohet nga aty duke qarë e duke thënë: - I gjori unë, i biri i Ademit u urdhërua me sexhde dhe ai e bëri atë, ndaj për të është Xheneti, e unë u urdhërova me sexhde e nuk e bëra sexhden, e për mua është zjarri i Xhehenemit!" (Muslimi)

Është mekruh tahrimen të lexohet surja, e cila ka ajet të sexhdes duke e braktisur ajetin e sexhdes dhe të vazhdohet me ajetet vijuese ose me sure tjetër.

Nëse personi nuk e ka bërë sexhde tilavetin, por ka vazhduar të lexojë tre ose më shumë ajete, (si te rasti i sures "El-Inshikak") atëherë ai e ka lënë një

vaxhib dhe për këtë shkak duhet të bëjë sehvi sexhde për shkak të atij lëshimi.

Në përgjithësi, imami me xhemat mundësisht duhet të shmangë leximin e ajeteve të sexhdes me se obligohet me bërjen e sexhde tilavetit, pasi kjo mund ta ngatërrojë xhematin nëse ata (mukteditë) nuk janë të njohur me këtë rregull. Ose, nëse vendos që të lexojë të tilla ajete, atëherë para se të hyjë në namaz duhet njoftuar ata që falën me të.

Sa është minimumi i personave të cilët duhet të prezantojnë për t'u plotësuar kushti për ta falur namazin e xhumasë. I kam pyetur disa hoxhallarë, por jo të gjithë më kanë dhënë mendim identik!

Namazi i xhumasë është namaz shumë i veçantë javor, i cili, përveç tjerash kërkon që numri i besimtarëve që dëshirojnë ta falin atë të jetë sa më i madh. Prandaj, për kryerjen e këtij namazi krahasuar me namazet e rregullta ditore, kërkohen kushte shtesë. Në veprat e fikhut, ndër të tjera, theksohet edhe numri i xhematit të pranishëm, minimumi i të cilit mundëson faljen e këtij namazi. Sipas Ebu Hanifes dhe imam Muhamedit, përveç imamit duhet të prezantojnë edhe tre xhematlinj. Ebu Jusufi ka thënë se përveç imamit duhen edhe dy xhematlinj. Mendimi i parë është më i pranueshëm dhe konsiderohet mendimi sipas të cilit duhet vepruar (mufta bihi-l-kavl).

Dikush po hyn në xhami ditën e xhuma me vonesë, dhe duke qenë hatibi në minber (hytbe), fillon të fal rekate sunet. Si të veprohet me këtë rast?

Në qoftë se dikush hyn në xhami me vonesë, akoma pa hipur hatibi në hytbe dhe fillon të falet, ai duhet ta vazhdojë faljen e synetit të xhumasë. Ndërkaq, pasi që hatibi të ketë hipur në minber, nuk bën të fillohet me faljen e synetit por duhet dëgjuar hytben (këshillën e së premtes), e cila me këtë rast është farz, e dihet se farzi ka përparësi nga syneti.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-99), familja jonë ka qenë e detyruar të gjejë strehim në Shqipëri, ndërkohë



nëna jonë ka ndërruar jetë dhe është varrosur në Shqipëri.

Viteve të fundit, shumë njerëz po na thonë që nënën ta rivarrosim në varrezat e fshatit tonë. A lejohet sipas Sheriatit që xhenazen e nënës ta nxjerrim nga varri dhe ta sjellim e ta rivarrosim në vendin tonë? A lejohet eks'humimi i të vdekurit pa ndonjë arsye madhore apo pa ndonjë shkak të arsyeshëm?

Sipas të drejtës së Sheriatit, nuk lejohet zhvarrimi i të vdekurit (të varrosurit) dhe rivarrimi në ndonjë lokacion tjetër, pa ndonjë nevojë madhore. Nevojë madhore mund të konsiderohet nëse i vdekuri mysliman është i varrosur në varreza jomyslimane, ose nëse qeveria ka vendosur për dislokimin e të gjitha varrezave, ose kur kemi të bëjmë me një vendim gjykate për eks'humim për ndonjë arsye bindëse të lejuar me ligj. Në rastin tuaj nuk bëhet fjalë për ndonjë arsye si këto që i përmendëm, prandaj më mirë është të mos e bëni eks'humimin e nënës tuaj, pra të mos e zhvarrosni për ta rivarrosur për të dytën herë, për faktin se është e panevojshme. Madje, është princip themelor që njerëzit të varrosen në vendin ku edhe kanë ndërruar jetë, përveç nëse ka një arsye që i vdekuri të varrosset në një lokacion tjetër, në varreza tjera, dhe kjo është e lejuar. Raste të kësaj natyre janë rastet kur njerëzit tanë ndërrojnë jetë në kurbet e dëshira e tyre është që të varrosen në vendlindje.

Sa është çmimi i fidjes për këtë vit (për këtë Ramazan 2022)?

Fillimisht të konstatojmë se ç'është në të vërtetë fidja. Fidja është

detyrimi i personit që nuk ka agjëruar ndonjë ditë ose tërë Ramazanin me arsye, për ta ushqyer një të varfër me shujtë ditore.

Një gjë duhet ditur se ditët e pa agjëruara me arsye (sëmundja ose udhëtimi) duhet të agjërohen kurdo që personi ka mundësi, e nëse nuk ka mundësi të agjërojë, atëherë ai duhet të paguajë fidjen (bazuar në dispozitat e ajetit 184 të sures El-Bekare dhe në praktikën pejgamberike - synet).

Rëndom kjo caktohet duke marrë si bazë mesataren e sadekatul-fitrit. Këtë vit, si zakonisht, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës e ka caktuar që sadekatul-fitri të jetë 2, 3, 5 dhe 10 euro. Kështu që fidja, bazuar në mesataren e mësipërme, duhet të jetë 5 euro. Fidja mund t'i jepet një të varfri ose më shumë të varfërve për një ditë ose për më shumë ditë të pa agjëruara.

Më mirë është që fidja të paguhet në fondin e posaçëm për fidje të Kryesisë së BIK-ut, e pastaj ky autoritet sipas prioritetit ta destinojë aty ku është më e nevojshme.

Në qoftë se personi i cili nuk ka pasur mundësi të agjërojë disa ditë të Ramazanit, e ka paguar fidjen për ato ditë, e më pas i është dhënë mundësia shëndetësore që t'i agjërojë ato ditë, ai duhet t'i agjërojë ditët e mbetura borxh, kurse fidja e paguar do t'i llogaritet si sadaka.

Marrja e injeksionit me rastin e nxjerrjes së dhëmbit, a e prish agjërimin?

Marrja e injeksionit me rastin e nxjerrjes së dhëmbit nuk e prish agjërimin. Kjo sepse ai injeksion është anestezion lokal dhe, për më tepër, nuk ka veti ushqyese.

Ilmije Kuqi

Dispozita e ngrënies dhe pirjes në Islam

Nuk ka asnjë çështje që lidhet me veprimet e njeriut, qofshin ato çështje fetare apo të kësaj bote, e që Zoti i Madhëruar mos të ketë sjell në lidhje më to, dispozita, etika dhe udhëzime në formë të përveçme apo të përgjithshme, madje edhe për çështjet që ne i shohim si të vogla.

Foja islame është sistem hyjnor, gjithëpërfshirës. Ajo erdhi që njeriun ta bëjë të lumtur në të dyja botët. Kështu që, nuk ka asnjë çështje që lidhet me veprimet e njeriut, qofshin ato çështje fetare apo të kësaj bote, e që Zoti i Madhëruar mos të ketë sjell në lidhje më to, dispozita, etika dhe udhëzime në formë të përveçme apo të përgjithshme, madje edhe për çështjet që ne i shohim si të vogla.

Kjo tregon se Islami është një fe që ndërhyr në të gjitha detajet e jetës dhe aspektet e rëndësishme të njeriut dhe kjo është një nga madhështitë dhe sekretet e kësaj feje, dhe ndër këto aspekte është edhe ushqimi dhe pija.

Ushqimi dhe pija konsiderohen ndër kërkesat themelore dhe të domosdoshme të organizmit, sepse janë burimi kryesor i energjisë, vitalitetit dhe rritjes. Prandaj, themi se nevoja e njeriut për ushqim dhe pije nuk është më pak e rëndësishme se nevoja e tij për ajër, i cili është një rregull i përbashkët midis organizmave të gjallë. Vetëm se myslimani, ushqimin dhe pijen, nuk e sheh si qëllim në vetvete, por si një mjet për diçka tjetër. Ai ha dhe pi për të ruajtur shëndetin e trupit të tij, ku mandej ai mund të adhurojë Zotin e Plotfuqishëm.

Në kohët e fundit, dëgjojmë shpesh të flitet për ngrënien dhe pirjen, në mesin e tyre dhe mjekë të

“Ngrënia në sasi sa e mënjanon shkatërrimin nga vetvetja dhe ia mundëson namazin në këmbë me të është farz, sepse kjo është shkak që trupi t’i kryejë obligimet e detyrueshme, prandaj është obligim-farz...”

ndryshëm dhe të shquar, të cilët në mes të tjerash sugjerojnë ngrënien e pakët, sepse ngrënia e tepërt sjell sëmundje të shumta dhe të ndryshme. Për këtë arsye, ne në këtë artikull do të flasim për dispozitën e ngrënies dhe pirjes në Islam, ku përmes tij mund pasqyrohet madhështia e kësaj feje edhe në këtë aspekt të jetës së njeriut.

Dispozita e ngrënies dhe pirjes

Nëse duam ta ndajmë ushqimin dhe pijen sipas dispozitave fetare, atë mund ta ndajmë në të obligueshme, të preferuar, të lejuar dhe të ndaluar.

Ngrënia dhe pirja e obliguar

Ngrënia dhe pirja, në sasi sa mënjanohet shkatërrimi (vdekja) nga vetvetja, është obligim-farz¹ dhe për këtë shpërblehet,² sepse pa të nuk mund të mbijetojë dhe me të mund të kryhen obligimet-farzet. Tekstet urdhërojnë robin të ruajë shëndetin e tij dhe të largohet nga ajo që çon në shkatërrimin e tij. Ndër to është ajeti që urdhëron për ngrënie pa e tepruar: “hani e pini dhe mos u teproni”.³

Në lidhje me ngrënien dhe pirjen, në sasi sa mënjanohet shkatërrimi nga vetvetja, Bedrudin el-Ajni, thotë: “Ngrënia në sasi sa e mënjanon shkatërrimin nga vetvetja dhe ia mundëson namazin në këmbë me të është farz, sepse kjo është shkak që trupi t’i kryejë obligimet e detyrueshme, prandaj është obligim-farz, dhe nuk llogaritet (në ditën e Gjykitimit) për këtë sasi, sepse ajo që është shkak për shpërblim nuk është arsye për llogaritje, por për të shpërblehet.”⁴ Këtë e dëshmon hadithi, të cilin e transmeton Sadi r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Myslimani shpërblehet për çdo gjë, madje edhe kafshatën që e sjell në gojë⁵ (për ta ngrënë).”⁶

Nëse personi e lë ngrënien dhe pirjen derisa të vdes, në këtë rast ai është mëkatar. Madje, kur detyrohet nga uria, nëse abstenon nga ngrënia e asaj që është e ndaluar, qoftë edhe pasuri e tjetrit me kusht të kompensimit,⁷ duke mos anuar dhe duke

mos pasur qëllim mëkatit dhe nuk hanë apo nuk pinë derisa vdes, i tilli është mëkatar. Kjo, për shkak se në këtë ka hedhje të vetvetes në shkatërrim e kjo është e ndaluar, duke argumentuar me ajetin: “Dhe mos e hidhni veten në shkatërrim.”⁸

Në lidhje me marrjen e ushqimit apo ujit të personit tjetër, në sasi sa e shuan urinë apo etjen, në El-Bezazijeh, thuhet: “I frikësohet vdekjes nga uria, kurse me shoqëruesin e tij ka ushqim, ai merr prej tij me vlerë,⁹ aq sa e shuan urinë, po ashtu merr në sasi sa e shuan etjen. Nëse ai (shoqëruesi) refuzon, ai e lufton atë pa armë, e nëse shoqëruesi ka frikë vdekjes nga uria apo etja ai ia lë atij pak (dhe pak e merr për vete).”¹⁰

Nuk është mëkat nëse personi përmbahet nga mjekimi derisa vdes, sepse lënia e trajtimit nuk çon në vetëshkatërrim, sepse personi nuk është i sigurt se ai ilaç do i sjell dobi dhe do e shërojë, dhe ndoshta ai shërohet edhe pa trajtim.¹¹

Ngrënia dhe pirja e preferuar

Ngrënia dhe pirja, që e tejkalon atë që çon në vdekje për të qenë në gjendje të falet në këmbë dhe që ia lehtëson agjërimin është e preferuar-mendub,¹² sepse zënia me atë që e forcon për adhurim është adhurim. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur te Zoti se besimtari i dobët.”¹³

Radijudin es-Serahsi, ngrënien dhe pirjen, në sasi sa e tejkalon rrezikun e vdekjes dhe është në gjendje të falet në këmbë dhe të agjëroj, e konsideron farz-obligim dhe nuk e konsideron mendub. Ai thotë: “Ngrënia e asaj që e tejkalon atë (që çon në shkatërrim) sa e bën trupin të mund të falet në këmbë dhe të agjëroj, është obligim-farz dhe shpërblehet për të dhe llogaria për të ngrihet,¹⁴ sepse ai është shkak që trupi t'i kryejë farzet, andaj dhe është shkak për shpërblim dhe nuk është shkak për llogaritje, sepse në llogaritje ka një lloj mundimi.”¹⁵

Sipas Imam en-Nahlaviut, ngrënie e preferuar-mendub konsiderohet,

ngrënia që ndihmon në kryerjen e gjërave vullnetare (nafileve), të mësojë shkencën dhe t'ua mësojë atë të tjerëve.¹⁶

Ngrënia dhe pirja e lejuar

Ngrënia që përfundon në ngopje, për të shtuar fuqinë¹⁷ është e lejuar-mubah,¹⁸ por për këtë nuk ka shpërblim, as mëkat, dhe për të personi llogaritet lehtë edhe pse kjo është prej të lejuarave. Duke u mbështetur në ajetin kuranor: “Pastaj në atë ditë do të pyeteni për të mirat (e dynjasë).”¹⁹

Se personi do të pyetet edhe për të mirat dhe dhuntitë e kësaj bote, e dëshmon edhe hadithi, të cilin e transmeton Ebu Asibi r.a., i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. një natë doli, kaloi pranë meje dhe më thirri dhe unë dola. Mandej, kaloi pranë Ebu Bekrit dhe e thirri atë dhe ai doli, pastaj pranë Umerit dhe e thirri dhe ai doli. Ai eci derisa hyri një kopsht të disa ensarëve dhe pronarit të kopshtit i tha: “Na ushqe me hurme të papjekura”. Ai erdhi me një degë të palmës dhe e vendosi atë (para tij). I Dërguari i Allahut a.s. dhe shokët e tij hëngrën, pastaj ai kërkoi ujë të ftohët dhe piu dhe tha:

“Do të pyeteni për këtë në Ditën e Kiametit.”

Umeri e mori degën e palmës dhe me të e goditi tokën derisa hurmat e papjekura u shpërndanë para të Dërguari të Allahut a.s., mandej tha: “O i Dërguar i Zotit, a do të pyetemi për këtë në Ditën e Kiametit? Pejgamberi a.s. tha: “Po, përveç tri (gjërave): një copë pëlhure që ndalon lakuriqësinë, ose një copë bukë me të cilën e shuan urinë, ose një dhomë më të cilin hynë nga nxehtësia dhe të ftohtit.”²⁰

Se ngrënia në këtë sasi nuk është mëkat, e dëshmon hadithi, ku Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Të mjaftojnë o bir i Ademit ka kafshatë për ta mbajtur shpinën drejtë”^{21, 22}; “dhe nuk qortohesh në mjaftueshmëri”^{23, 24}.

Ngrënia dhe pirja e ndaluar

Ngrënia përtej ngopjes është e ndaluar-haram,²⁵ sepse ngrënia e tepërt mund të bëhet shkak i sëmundjes dhe me të nuk shuhet uria dhe as nuk i shtohet fuqia. Prandaj, kjo është e ndaluar dhe kush bën diçka të ndaluar do të llogaritet dhe do të dënohet për atë, duke u mbështetur në ajetin: “hani e pini dhe mos u





teproni”²⁶. Zoti i Madhëruar na ka urdhëruar të hamë e të pimë, por na ka ndaluar edhe nga teprimi, sepse teprimi është karakteristikë e dënueshme në të gjitha çështjet, qoftë në të ngrënit dhe të pirit apo në çështje të tjera.

Edhe udhëzimi profetik erdhi me etiketë me të cilën myslimani menaxhon ushqimin dhe pijen e tij dhe tregoi se ai kur ha ai nuk ngopet. Transmetohet nga Mikdadi r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Asnjë njeri nuk ka mbushur një enë më të keqe se stomaku. Birit të Ademit i mjaftojnë ca kafshatë për t’ia mbajtur shpinën drejt. Nëse kjo është e pamundur, atëherë një të tretën për ushqimin e tij, një të tretën për pijen e tij dhe një të tretën për frymëmarrjen e tij.”²⁷ I Dërguari ynë a.s., na ka nxitur të jemi të matur në ushqim dhe pije dhe na ka ndaluar të hamë dhe të pimë mbi nevojat njerëzore.

Në lidhje me ngrëniën e tepruar, Es-Serahsi, pasi që sjell argumente, shton dhe thotë: “Shpenzimi i tepërt në ushqim është disa lloje, e njëra ndër to është ngrënia e tepërt... për shkak se ai ha për t’i sjell dobi vetes, ndërsa në të ngrënit e tepërt nuk ka

dobi, përkundrazi në të ka dëm. Kështu, kjo është po sikur të hedhësh ushqim në mbeturina apo me keq se kjo.”²⁸

Nga ngrënia përtej ngopjes bën përjashtim ngrënia tepër me qëllim të fuqizimit për të agjëruar të nesërmen, ose që mysafiri i tij të mos turpërohet e të ndalet nga ushqimi, e të ngjashme.²⁹

1. Durrer el-Hukam, 1/310; Fet’h babi el-Inajeh, 5/248. 2. El-Ihtijar, 4/172; esh-Shurunbulali ala ed-Durrer, 1/310; Mexhma el-Enhur, 2/524. 3. El-A’raf, 31. 4. Minhatu es-Suluk, fq.470. 5. Kjo, nëse me të synohet të forcohet për kryerjen e adhurimeve. Shih: et-Tejsir bisherhi el-Xhami es-Sagir, 2/127; Fejdu el-Kadir, 4/305. 6. Ahmed, nr: 1531, 3/113, Shejh Shuajbi thotë: “Senedi i tij është i mirë”. 7. Sepse lejueshmëria e domosdoshmërisë nuk bie ndesh me garancinë. Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/338. 8. El-Bekareh, 195. 9. Mandej ia kthen atij vlerën e asaj që ia ka marrë. 10. Mexhma el-Enhur, 2/525; Redu el-Muhtar ala ed-Durr, 6/338. 11. Shih: Minhatu es-Suluk, fq.471; Mexhma el-Enhur, 2/525, etj.. 12. Kjo sipas mendimit të Ibën Mevdud el-Musliut, Mula Hasrut, Shurunbulalit, Shemsudin et-Tumurtashit, Shejh Zades. El-Ihtijar, 4/172-173; Durrer el-Hukam ve hashijetuhu, 1/310; Ed-Durr el-Muhtar, 6/339; Mexhma el-Enhur, 2/524. El-Haskefi, në Ed-Durr el-Muhtar sherh Tenviru el-Ebsar, 6/339, pasi që përmend shprehjen Shemsudin Tumurtashit, ku thotë: “dhe shpërblehet për të nëse mund të falët në këmbë dhe të agjëroj”, ai shton dhe thotë: “Nga kjo nënkuptohet lejueshmëria e ngrëniës pak, në sasi sa dobësohet dhe nuk mund të kryej farzin, por kjo nuk lejohet siç thuhet në “El-Multeka” dhe të tjera. Dhe them se në “El-Mubtega” thuhet: “Farz është në sasi sa e mënjanon vdekjen dhe

me të mund të falet në këmbë”. ed-Durr el-Muhtar, 6/339. 13. Muslimi, nr: 2664, 4/2052. 14. Nuk jep llogari për të në Ditën e Gjykimit. 15. El-Muhit er-Radavi, 2/304. 16. Ed-Durrer el-Mubahah, fq.23. 17. Ali el-Karij, në Fet’h babi el-Inajeh, 5/248, thotë: “Nëse bëhet për të shtuar fuqinë e tij për punë të kësaj dynjaje, kjo është e lejuar-mubah. Ndërsa për të pasur forcë për bindje dhe adhurim është e preferuar-mustehab”. 18. Minhatu es-Suluk, fq.470; Durrer el-Hukam, 1/310; Mexhma el-Enhur, 2/524; Ed-Durr el-Muhtar, 6/339, etj. 19. Et-Tekathur, 8. 20. Ahmed, nr: 20768, 34/367; Sherh meani el-Athar, nr: 468, 1/408; Shuab el-Iman, nr: 4281, 6/329. El-Hejthemi, në Mexhma ez-Zevaid, 10/267, thotë: “E transmeton Ahmedi dhe transmetuesit e tij janë të besueshëm”. 21. Shprehja “për ta mbajtur shpinën drejtë” është metaforë e forcimit të njeriut për adhurim dhe punë. Shih: Mirkatu el-Mefatih, 8/3251; Fejdu el-Kadir, 5/502. 22. Sunen el-Kubra i Nesaiut, nr: 6738, 6/268; Ibën Hiban, nr: 5236, 12/41 (shprehja është e tij); Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është sahih”. 23. Domethënë në sasi të nevojshmërisë nuk ka qortim. Në të ka shenjë se nëse personi është nevojtarë dhe i varfër, atij i lejohet të kërkojë në sasi të mjaftueshmërisë së tij dhe nuk qortohet për këtë, për shkak se ai është i dëmtuar me këtë. Por, ai qortohet nëse kërkon me shumë për të shtuar: Nahbu el-Ejfar, 8/57. 24. Muslimi, nr: 1036, 2/718. 25. El-Muhit er-Radavi, 2/304; El-Ihtijar, 4/173; Et-Tebjin, 6/47; Minhatu es-Suluk, fq.470, etj. 26. El-A’raf, 31. 27. Et-Tirmidhi, nr: 2380, 4/168 (shprehja është e tij) dhe thotë: “Ky hadith është i mirë sahih”; Ibën Hibani, nr: 674, 2/449, Shejh Shuajbi thotë: “Senedi i tij është sipas kriterit të Muslimi”. El-Mustedrek, nr: 7139, 4/135. Edh-Dhehebi thotë: “Është sahih”. 28. El-Mebsut, 30/266-267. 29. El-Mebsut, 30/267; El-Muhit er-Radavi, 2/305; El-Muhit, 5/351; Minhatu es-Suluk, fq.470, etj.

Prof. ass. dr. Rexhep Suma

Kultura e polemikës, debatit dhe dialogut në artin e thirrjes islame

Kultura e polemikës, debatit dhe dialogut në fushën e daves duhet të karakterizohet me nivel të lartë të karakteristikave kulturore dhe dëshirës për të ardhur deri te përfitimi me debatuesin dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë tryezë debati, në mënyrë që të arrihet deri tek e vërteta dhe çdo gjë që sillet rreth saj, duke flakur tutje çdo gjë që shëmton debatin dhe që paraqet mendjemadhësi.

Prej elementeve qenësore për një besimtar që duhet të zotëroj në kulturën e debatit mbetet fakti se ajo duhet të jetë e ndërnuar mbi fjalën e bukur dhe udhërrëfyese në shërbim të së vërtetës dhe sqarimit të saj dhe heqjen e gjitha të kotave.

“A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë. Allahu, pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkullur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar.” (Ibrahim, 24-26).

Fjala e mirë të besimtari dhe thirrësi në komunikimin e Islamit është atribut që e shoqëron dhe nuk shmanget nga ajo asses. Ja se si e paraqet Allahu këtë aspekt në Kuranin famëlartë: “(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.” (El-Furkan, 72).

Po ashtu në kuadër të dialogut, është edhe të folurit me saktësi dhe precizitet, duke u mbështetur dhe ofruar argumente të qarta dhe të qëndrueshme, siç na rikujton edhe Allahu xh.sh.: “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit,

Gjatë zhvillimit të debatit, polemikës etj., opinionet duhet të kenë mbështetje në tekstet fetare (Kuran dhe hadith), sepse kjo do të krijonte një ekuilibër të çështjeve.

të parët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (El-Isra, 36).

Po ashtu, si pjesë përbërëse e debatit, polemikës është edhe qartësia dhe respekti ndaj pjesëmarrësve në debat si edhe dëgjuesve (masës), siç na e kujton edhe Muhamedi a.s.: “Të folurit e Muhamedit a.s. ishte i qartë, kushdo që e dëgjonte e kuptonte.”¹

Po ashtu, gjatë zhvillimit të debatit, polemikës etj., opinionet duhet të kenë mbështetje në tekstet fetare (Kuran dhe hadith), sepse kjo do të krijonte një ekuilibër të çështjeve, siç thotë i Lartësuari: “O besimtarë, mos bëni asgjë para (se të orientoheni në udhëzimet e) Zotit dhe të dërguarit të Tij, keni kujdes

Allahun, se me të vërtetë Allahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.” (El-Huxhurat, 1); “O ju që besuat, nënshtrojeni Allahut, dhe nënshtrojeni të dërguarit dhe përgjegjësve nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, drejtojeni Allahut dhe të Dërguarit po qe se i besoni Allahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” (En-Nisa, 59).

Po ashtu, mësimet islame na mësojnë që gjatë zhvillimit të debateve e polemikave të ndryshme të reflektojmë dhe të rrezatojmë pjekuri e mos të shfaqim ndjenja zemërimi e hidhërimi. Në Kuran thuhet: “Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemër fortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falu atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që mbështeten.” (Ali Imran 158–159); “..dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.” (En-Nahl, 125).

Po ashtu në këtë kuadër duhet të krijohet edhe atmosfera për diskutim, ku duhet të zotërojë siguria dhe qetësia, që të zhvillohet në atmosferë të përshtatshme e asses nën formën e kërcënimit e dhunimit.²

Të pranosh gabimin dhe t'i kthehesh së vërtetës, është më e mirë tek Allahu dhe te njerëzit, sesa të vazhdosh në të shtrembëtën. Shumë prej njerëzve mendojnë se po të zmbropsesh nga një qëndrim i gabuar është mangësi dhe ulje e pozitës, të ulet autoriteti dhe të humbet besimin te njerëzit! Në të vërtetë, e kundërta është e saktë. Çdo njeri që kthehet tek e vërteta, Allahu e ngre dhe ia lartëson vlerën. Në polemika e debate mos të jetë për qëllim thjesht triumfi ndaj kundërshtarit si njeri, por qëllimi duhet të jetë udhëzimi i tij. Nëse është e pamundur, atëherë është e lejueshme që qëllimi të jetë thyerja e kundërshtarit, që njerëzit të mos bien pre e tij dhe të pavërtetës që mbart. Duhet të mbizotërojë butësia dhe dashamirësia në stil edhe nëse kemi të bëjmë me një debat, edhe nëse kemi të bëjmë me kundërshtarim më armiqësor. Debatuesi duhet të jetë i ditur në përgjithësi dhe në veçanti për temën e debatit. Të ketë dhuntinë e debatit dhe të arrijë të perceptojë psikologjinë e kundërshtarit dhe të njerëzve që e dëgjojnë. Debatimi është një nga artet më madhështore në thirrjen për tek Allahu dhe kërkon një specifikë më të lartë sesa dija. Jo çdo dijetar është i aftë për debat, sepse debati ka mënyra hyrjeje dhe daljeje, përshkallëzime, tërheqje dhe situata nga më të vështirat.

Brezat e parë u ruajtën nga polemikat devijuese

Dy janë arsyet kryesore se pse tre brezat e parë u ruajtën nga devijimi në besim, ndërsa jo pak nga aktorët e brezave të mëvonshëm ranë pre e polemikave dhe debateve devijante:

1- Ata e kuptuan se besimi është rruga e tyre drejt Allahut dhe se kjo rrugë duhet të ndriçohet domosdoshmërisht me anë të njohjes së drejtë të Tij. Për sakaq nuk e panë besimin si temë polemikash dhe debatesh

akademike, siç theksuam edhe më sipër.

2- Përqendrimi te mesazhi i argumenteve kuranore dhe profetike, që flasin për cilësitë dhe emrat e Allahut të Madhëruar, dhe jo te domethëniet e tyre sipërfaqësore.

Ata, veç njohjes së drejtë të Allahut të Madhëruar si Qenie pa fund dhe i Përsosur, kishin kuptuar mirë se Allahut nuk i ngjason askush e asgjë. Ajeti kuranor: “Si Allahu nuk është asgjë dhe Ai është Dëgjues dhe Shikues”(23), ishte orientuesi kryesor i qasjes së tyre ndaj ajeteve dhe haditheve që flasin rreth emrave dhe cilësive të Allahut të Madhërishëm. E kështu ata nuk e patën fare të nevojshme të ndalen te hijet kuptimore që mund të lëshonte domethënia sipërfaqësore e termave të këtyre ajeteve dhe haditheve por shkuan menjëherë te mesazhi që këto ajete dhe hadithe mbartnin për këta breza dhe për të gjithë brezat deri në Ditën e Kiametit.³

Debatimi ngjan një betejë, ka sulme, manovra, tërheqje taktike dhe në fund ngadhënjim dhe fitore ose humbje e dështim. Për asnjë çast debatuesi nuk duhet ta largojë vëmendjen nga ata që e dëgjojnë, sepse ata janë pikësynimi. Ai duhet ta dijë se çdo fjalë, shenjë apo lëvizje është në llogari të tij. Prandaj, debatin nuk janë në gjendje ta zhvillojnë, veçse njerëzit që Allahu u ka dhuruar këtë art, ua ka bërë të lehtë. Kushdo që vihet para tij dhe nuk është i kualifikuar, të mos hyjë në të. Debatuesi duhet të këshillohet me vëllezërit e tij besimtarë dhe ata duhet t'i thonë të vërtetën. Nëse e këshillojnë që të mos hyjë në debat, ai duhet ta pranojë dhe të mos bëjë çfarë i thotë koka e vet. Të tërhiqesh, është më mirë sesa të dështosh, sepse kjo ka një ndikim të madh në thirrjen islame. Po ashtu pikë interesante në debate është edhe fakti që mos dalë nga pika e diskutimit dhe as nga referimi i tij, sado që kundërshtari të mundohet ta tërheqë apo ta nxjerrë prej andej. Fitimi i zemrave është më

Në qoftë se Allahu xh.sh., do të kishte dëshiruar që njerëzit të bashkoheshin në një mendim të vetëm, atëherë do t'i kishte zbritur të gjitha ajetet e Kuranit të qarta dhe që të pranonin një komentim të vetëm.

parësor sesa fitimi ndaj kundërshtarit, veçse nëse ka të bëjë me të vërtetën dhe të shtrembëtën.⁴

Prej gjërave që mund të konsiderohen nga ky lloj debati, është edhe marrja me çështjet e diskutueshme mes dijetarëve për të cilat nuk ka pasur një mendim të prerë asnjëherë, ngushtimi i zemrave për shkak të tyre, duke mbajtur anën e ndonjë mendimi dhe duke u përpjekur që të hedhë poshtë mendimet e tjera, duke u shpallur luftë, duke ndërmarrë sulme dhe duke zhvilluar “beteja” rreth tyre edhe pse dihet se një gjë e tillë ka ekzistuar që në kohën e brezave të parë, që kanë qenë edhe brezat më të mirë të këtij ymeti.

Mendjet dhe zemrat e tyre u treguan të gjera për t'i pranuar këto ndryshime dhe nuk kanë ndërjerë ngushtim për njëri-tjetrin dhe as që janë përpjekur ndonjëherë që ta shuajnë këtë debat, ashtu siç mundohen të bëjnë sot disa besimtarë të kohës tonë. Ata jo vetëm që e pranuan njëri-tjetrin, por edhe fale-shin pas njëri-tjetrit dhe jetuan me mirësinë e Allahut xh.sh., si vëllezër, siç i kishte urdhëruar Allahu xh.sh..

Në qoftë se Allahu xh.sh., do të kishte dëshiruar që njerëzit të bashkoheshin në një mendim të vetëm, atëherë do t'i kishte zbritur të



gjitha ajetet e Kuranit të qarta dhe që të pranonin një komentim të vetëm. Po kështu do të kishte bërë që të gjitha argumentet e fesë të ishin të prera si në sigurinë e transmetimit dhe në domethënie dhe nuk do të kishte vend për ixhtihad dhe ndryshim mendimesh. Pikërisht për këtë, njerëzit do të vazhdojnë që të kenë mendime të ndryshme për çdo gjë që nuk është e prerë në çështjet e fesë, që nuk është pak, por shumica e saj. Po ashtu edhe dijetarët e thelluar në dituri do të vazhdojnë të marrin mendime që i konsiderojnë si më të arsyeshme, pa mohuar mendimet e të tjerëve që kanë përzgjedhur, mendime që bien në kundërshtim me atë që kanë zgjedhur ata, pasi kanë të njëjtën të drejtë.

Kështu, nuk i lejohet një myslimani që të braktisë mendimin e tij për të cilin është i bindur se është i saktë, për mendimin e dikujt tjetër kushdo qoftë, sepse ai është përgjegjës para Allahut xh.sh., për mendimin dhe përpjekjen e tij me të cilin e adhuron Allahun xh.sh.. Askush prej nesh nuk duhet që të përpiqet, edhe sikur të jetë i sinqertë për atë që kërkon të bëjë, të heqë mendimet e ndryshme në shkencë dhe në jurisprudencën islame, sepse përpjekja e tij vetëm se do ta shtojë debatin dhe do ta zgjerojë rrethin e tij. Atyre që përpiqen të pengojnë qe njerëzit të ndjekin medhhebet në të gjitha nivelet u kam thënë se ata nuk po bëjnë gjë tjetër

vetëm se po u shtojnë methhebeve të vjetër edhe një tjetër të ri.⁵

Që debati dhe dialogu të japin frytin e tyre në mënyrën më pozitive dhe që dialogu të mos jetë një bisedë e shurdhër, duhet që të respektohen kushtet dhe etika e mëposhtme. Disa prej tyre kanë të bëjnë me boshtet e dialogut dhe disa për të mbajtur nën kontroll polemikën. E para, boshti kryesor i polemikës duhet të jetë mbrojtja e fesë dhe e bazave të saj të përgjithshme përballë jomyslimanëve dhe jo futja nëpër degëzime e hollësira. Po ashtu, qëllimi përballë myslimanëve të devijuar duhet të jetë mbrojtja e udhës së Kuranit, Sunetit dhe metodologjisë së të parëve dhe jo mbrojtja e klaneve, partive të lindura dje apo sot, e sekteve dhe tarikateve të shpikura apo e çështjeve personale. Po ashtu myslimani nuk duhet të debatojë me jomyslimanët për çështje delikate e të paqarta, por vetëm për çka është e domosdoshme dhe e pashmangshme, madje edhe kjo kur provokohet, e prish imazhin e Islamit ose bëhet pengesë për futjen në të. Me grupet e humbura nuk debatohet për çështje dytësore të fesë apo për çështje opinionesh, por për çështje madhore, për bazat dhe themelet e fesë. Nuk debatohet me jomyslimanët për numrin e faljeve, të divorceve, të gurëve në haxh, mbulesën e gruas, etj.. Është një gafë e madhe të polemizosh me dikë që nuk beson tek Allahu për ligjet e Tij.

Po në këtë rrafsh, debati nuk duhet zhvillohet në prani të njerëzve të thjeshtë, që të mos u futen dyshime apo të dobësohet në sytë e tyre e vërteta. Debati përpara njerëzve të thjeshtë ka shumë anë negative, për shembull, ata mund të dëgjojnë gjëra të paqarta, dilema për ato që besojnë apo mund të sprovohen nga të pavërtetat dhe besimet e të tjerëve. Njerëzit e thjeshtë janë emocionalë dhe ndikohen nga fjalët e bukura. Ata nuk janë njerëz të meditimit, argumenteve dhe mund të rastisë që mbrojtësi i së vërtetës të jetë i dobët, nuk di të përgjigjet ose edhe i fortë, por nuk di të sqarojë gjërat dhe kështu njerëzit bien në dilema, u lëkundet besimi dhe i lënë terren të pavërtetës.

Po ashtu duhet të përcaktohet pika e diskutimit para se të fillojë debati, të përcaktohet referimi para se të fillojë debati si dhe koha. Kurse për debatuesin janë disa këshilla që duhet ndjekur dhe përmbajtur:

1. Sinqeriteti - Qëllimi duhet të jetë vetëm për hir të Zotit, mbërritja tek e vërteta dhe thirrja për tek ajo. Tregohet se imam Shafiu ka thënë: "Sa herë që kam debatuar me ndonjë, gjithmonë kam dëshiruar që Allahu ta shfaqë të vërtetën në duart e tij." Dhe urtësia e kësaj fjale, siç thotë El-Bejheki, është: "Të mos e përbuz pranimin e së vërtetës qoftë edhe nga kundërshtari..."

2. Të mos e shtyjë pozicionin në të cilin ndodhet, në refuzimin e së vërtetës apo në mospranimin e gabimit dhe në thënien e gënjeshtres.

3. Të zotëroj dije të mjaftueshme nga lëmi fetar dhe ai shkencor në përballje me debatet e ndryshme.

4. Për çdo mospajtim rreth ndonjë çështje, patjetër që duhet referuar Librit të Zotit si dhe Sunetit të Muhamedit a.s.. Në lidhje me këtë duhet t'i kujtoj fjalën e Krijuesit tonë që thotë: "Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit." (En-Nisa, 59).

5. T'iu japë përparësi teksteve dhe argumenteve fetare para atyre shkencore.



6. Të shfaqë sjellje dhe etikë të lartë islame gjatë debatit, duke respektuar të tjerët dhe mendimin ndryshe, si dhe duke mos akuzuar e ofenduar askënd duke përfshirë edhe talljen me të tjerët dhe nderin e tyre.

7. Objektivi yt duhet të jetë të shfaqsh të vërtetën dhe t'i bindësh të tjerët për të duke u larguar nga e kota (batili) dhe devijimi i njerëzve.

8. T'u jepet përparësi argumenteve më të rëndësishme në fillim përballë kundërshtarit.

9. Shmangu sa të mundesh nga stërzgjatja në të shprehur dhe përdorimi i zhargonit të panjohur fjalësh apo devijimit nga tema bosht.

10. Mos të kesh kundërthënie në fjalët tua apo argumentet që ofron si dëshmi.

11. Mos poshtërimi i palës kundërshtare në aspektin e ofrimit të argumenteve dhe gjithmonë duke respektuar kornizën e shëndosh në këtë fushë.

12. Të pranosh dhe të pajtohesh mbi çështjet që ka një ujdi për to dhe ta pranosh rezultatin e debatit, përndryshe fryma e debatit ka kaluar si e kotë dhe është humbur energji e kohë kotë, dhe fetarisht e kemi të ndaluar të humbin kohën. Siç i ka kërkuar edhe Ibrahim, mbretit Nemrud që ta sjell diellin nga

perëndimi, pasi që Zoti vetëm se e sjell atë nga lindja, edhe pse ai nuk mundte të bënte një gjë të tillë. Shembuj të shumtë ka regjistruar Kurani me histori të Pejgamberëve që ua sollën argumentet e qarta por popujt dhe paria i refuzonte ato.

13. Të ndalosh nga debati nëse ai shpien në sprovë, shkatërrim apo dëm që mund të prodhoj për thirrjen islame.

14. T'i kushtosh rëndësi kushteve që ndërlihen me debatin, duke patur parasysh personat, temën, kohën dhe vendin.⁶

15. Debatuesi të jetë psikikisht i qetë dhe stabil.

16. Mos ta neglizhojë kundërshtarin duke e konsideruar atë të dobët dhe të ulët e pa ndikim, përndryshe do t'i dalë situata jashtë kontrollit në debat dhe të mundet.

17. Mos të mendon se kundërshtari është më i fortë se ai, ku si pasojë do t'i lidhej gjuha e dobësohej.

Megjithatë duke u kthyer në perspektiv të karakteristikave të kulturës së dialogut në periudhën e pejgamberisë nga ajo që u cek më parë, mund t'i përcaktojmë këto karakteristika të kulturës së dialogut që zhvillohej në periudhën e pejgamberisë:

1. Sahabët bënin përpjekje me mish me shpirt që të mos përçahen dhe nuk krijonin shumë probleme e definicione, por zgjidhnin çdo gjë brenda suazave të udhëzimit të Pejgamberit a.s., dhe zgjidhja e kontekstit, si zakonisht, pengonte shkaktimin e konfliktit apo përçarjes.

2. Në rast të paraqitjes së ndonjë mosmarrëveshjeje, shpejt i ktheheshin Kuranit dhe Pejgamberit a.s. dhe kështu gjendja menjëherë qetësohej.

3. Të gjithë ata menjëherë i nënshtroheshin dhe e respektonin vendimin e Zotit e të Pejgamberit a.s..

4. Muhamedi a.s. i korrigjonte në shumë raste që mund të komentoheshin, por paraprakisht çdonjëri pranonte se mendimi i tjetrit mund të jetë i vërtetë ashtu siç mund të jetë edhe i veti dhe kjo tolerancë mendimesh garantonte respektin e njeri-tjetrit dhe anulonte fanatizmin e njëanshëm.

5. Ata mbështeteshin në devotshmëri dhe i shmangeshin pasionit. Qëllimi i tyre i vetëm ishte e vërteta dhe askush nuk prekej se nga cila gojë do të thuhet ajo.

6. Të frymëzuar nga morali islam, ata përdornin fjalë të bukura, largoheshin nga fjalori arrogant dhe me vëmendje dëgjonin njëri-tjetrin.

7. Ata orvateshin që me përqendrim të plotë ta shqyrtojnë çështjen dhe kështu, ndaj çdo mendimi tregonin kujdes dhe respekt të posaçëm, gjë që e obligonte tjetrin ta pranojë mendimin apo të pranohej ai që ishte më i logjikshëm. Këto ishin karakteristikat me të cilat karakterizohej periudha e zbritjes së Mesazhit hyjnor.

1. Ebu Davudi. 2. Hamed Rekij, Kadaja muasire fi mizani-l-islam, Dar ibn Hazm, Bejrut, 1997, f.99-100. 3. Sabaudin Jashari, Hartë e ligjërimit islam bashkëkohor tek shqiptarët, Ardhmëria, Tiranë, 2020, f. 7-58. 4. Adnan Alaaraur, Metodologjia e thirrjes islame në dritën e realitetit bashkëkohor, Tiranë, 2009, Tradita, f.273. 5. Jusuf Kardavi, Rizgimi islam nga adoleshenca drejt pjekurisë, Shkup, 2007, Furkan, 63. 6. Abdurahim El-Magdavi, El usul el ilmije li menhexhi edda' veti el ismailje, Daru-l hadare lin-neshr vet-tevzi, bot.3, Riad, 2018, f.732.

Bajram Zeqiri

Mirësjellja ndaj prindërve, portë e Xhenetit

“Prindërit janë një nga dyert më madhështore nga të cilat njeriu do të hyjë në Xhenet. Shfrytëzimi ose e humbja e mundësisë për të hyrë nga kjo derë varet nga vullneti yt.” (Muhamedi a.s.)

Bindja dhe dëgjueshmëria ndaj prindërve njihet si “Birrul Validejn”. Kuptimi i fjalës El-Birr është vërtetësi, bindje dhe përmirësim. E kundërta e saj është Akuk. Në ligjin islam, fjala El-Birr ka kuptime më të gjera dhe përfshin ndihmën ndaj prindërve, zbatimin e urdhrave hyjnore, respektimin dhe bindjen ndaj tyre, punën e vazhdueshme për t’i kënaqur, shërbimin ndaj tyre me përkushtim, trajtimin e tyre me butësi dhe largimin e ndonjë vështirësie që i shqetëson ata.¹

Prindërit nën dritën e mësimave kuranore dhe profetike

Allahu i Madhëruar në Kuranin fisnik, menjëherë pas urdhrit që ta adhurojmë vetëm Atë, na porositi me këshillë për respektim të prindërve. Ashtu siç na përmend në suren El-Bekare, kërkesën drejtuar popujve të mëparshëm që të sillen mirë me prindërit: “(kujtoni) Kur ne e morëm zotimin e bijve të Israilit; mos adhuroni askënd tjetër, përveç Allahut, të silleni mirë ndaj prindërve...” (El-Bekare, 83), ngjashëm me urdhër të njëjtë: “Adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asnjë send dhe silluni mirë me prindërit...” (En-Nisa, 36) na drejtohet edhe neve. Është tejet

Është tejet mbresëlënëse që Allahu, mirësjelljen ndaj prindërve e përmend bashkë me urdhrin “dhe mos adhuroni askënd tjetër përveç Tij”, ngase përmes prindërve te fëmijët shfaqen attribute hyjnore si krijimi nga hiçi, dhuntia e faljes, mbrojtja, përdëllimi e dhembshuria.

mbresëlënëse që mirësjelljen ndaj prindërve e përmend bashkë me urdhrin “dhe mos adhuroni askënd tjetër përveç Tij”, ngase përmes prindërve te fëmijët shfaqen attribute hyjnore si krijimi nga hiçi, dhuntia e faljes, mbrojtja, përdëllimi e dhembshuria.²

Në ajetin e sipërcituar, sjellja e mirë ndaj prindërve nënkupton bamirësinë, e cila duhet të tregohet me fjalë të ngrohta dhe të buta, me edukatë, me dhembshuri dhe me

vepra të mira. Të gjitha këto arrihen duke zbatuar urdhrat dhe duke respektuar porositi të tyre, duke shpenzuar për t’i kënaqur ata dhe këdo që ka lidhje me ata. Nuk është rasti i vetëm i sures En-Nisa, ku Zoti pas urdhrit për adhurim të vetëm Një Zoti, jep mesazhin për sjellje të mirë ndaj prindërve. Ngjashëm me këtë, Zoti xh.sh., në suren El-Enam, ka thënë: “Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit...” (El-Enam, 151).

Mirësia ndaj prindërve nuk njihet kufi, e kjo do të thotë se çdo mirësi është e pranueshme. Madje për këtë, Allahu i Lartësuar sikur na tërheq vërejtjen që prindërve mos t’u thuhet as “uh”: “Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” (El-Isra, 23). Allahu xh.sh. e lavdëroi një Pejgamber në Kuranin fisnik duke u nisur nga historia e raporteve të mira që kishte ai me prindërit: “Ai (Jahja), ishte njeri që i frikësohej Allahut, që sillej mirë me prindërit. Nuk ishte një kryengritës e tiran.” (Merjem, 14). Ngjashëm me këtë, përmendet edhe Pejgamberi Isa a.s., i cili ishte shumë i bindur ndaj nënës së tij. Në Kuranin fisnik, Zoti xh.sh. ka thënë: “... dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë

të ashpër dhe të padëgjueshëm.” (Merjem, 32).

Lidhja ndërmjet fëmijëve dhe prindërve duhet të shihet si një mundësi dhe një mjet për ta fituar kënaqësinë e Allahut. Në këtë kontekst ka ardhur edhe shprehja e Pejgamberi a.s., i cili ka thënë: “Kënaqësia e Allahut është te kënaqësia e prindërve. Edhe hidhërimi i Allahut është te i hidhërimi i prindërve.”³

Në të gjithë librat e hadithit gjejmë thënie të shumta pejgamberike të cilat flasin për raportet dhe mirësjelljen ndaj prindërve. Është më se i njohur tregimi i sahabiut, i cili kishte arritur në Medine që të takohej me të Dërguarin a.s.. Që në fillim, ai dëshironte që besimin e tij ta forconte edhe më tej duke i dhënë besën Pejgamberit a.s., e më pas, duke qenë një shpirt i entuziazmuar donte ta shijonte hixhretin me të Dërguarin a.s.. Pas vetes kishte lënë familjen që kishin nevojë për mbështetje, nënën dhe babanë me lot në sy, me zjarrmi në zemër e të mërzitur. Kur doli para Pejgamberit a.s., nuk mundi të mos e shpaloste qëllimin e vet: “O i Dërguari i Allahut! Erdha te ti për të bërë të pamundurën për fenë. E Pejgamberi a.s. i tha: “Kthehu tek ata dhe bëji të qeshin, siç i bëre të qajnë!”⁴

Aq shumë u kishte kushtuar rëndësi prindërve Pejgamberi a.s., aq sa nuk kishte pranuar që të shkonte dikush në xhihad pa lejen e tyre.

Transmetohet nga Abdullah bin Amri të ketë thënë: “Erdhi një njeri tek i Dërguari i Allahut a.s. dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, dëshiroj të luftoj”. Pejgamberi a.s. i tha: “A i ke prindërit gjallë?” “Po” – u përgjigj ai. Pejgamberi a.s. i tha: “Bëje xhihadin tënd tek ata (duke iu shërbyer atyre).”⁵

Shoku i Pejgamberit a.s., Abdullah ibën Mesudi r.a., shquhej për kryerjen e veprave të mira. një herë ai e pyeti të Dërguarin e Allahun a.s., për veprën më të dashur tek Allahu. Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Namazi në kohën e tij.” Pastaj, Ibën Mesudi vazhdoi: “Pastaj cila është vepra më e dashur tek Allahu?” Pejgamberi a.s. i tha: “Të jesh i mirë, i bindur dhe i dëgjueshëm ndaj prindërve.”⁶ Pejgamberi a.s. e radhiti bindjen dhe dëgjueshmërinë ndaj prindërve menjëherë pas namazit.

S’do mend se Kurani fisnik na porosit që të jemi të kujdesshëm dhe të respektueshëm ndaj prindërve, pa bërë dallimin ndërmjet tyre. Por Pejgamberi a.s., po i tregon Muavije ibën Hejdes r.a., se nëna është ajo që meriton më tepër respekt e shoqërim. Kjo ngase në shumicën e rasteve, toleranca, buzëqeshja e butësia i përshkruhen nënës. Ani pse në Kuran gjejmë edhe baballarë të cilët ushqyen dashuri e mall ndaj fëmijëve të vet, siç ishin Ibrahim a.s. e Jakubi a.s.⁷ Erdhi një njeri tek i Dërguari i

Allahut a.s. dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut, kush është më meritori prej njerëzve për shoqërimin tim?” Pejgamberi a.s. i tha: “Nëna jote.” “Pastaj kush?” “Nëna jote” – përsëri iu përgjigj i Dërguari. “Pastaj kush?” – pyeti prapë ai. “Nëna jote” – i tha përsëri Pejgamberi a.s.. “Pastaj kush?” – tha ai. “Babai yt” – i tha Pejgamberi a.s.⁸

Mirësia ndaj prindërve ishte bërë shkak edhe për shpëtim nga ngujimi i tre personave në shpellë. Na rrëfëhet nga Pejgamberi a.s. t’u ketë treguar shokëve të vet rrëfimin për tre të rinjtë, se si mirësia ndaj prindërve arriti që ta bëjë copë shkëmbin që kishte zënë hyrjen e shpellës. “Tre veta ishin duke ecur kur nisi të bjerë shi dhe u strehuan në një shpellë malore. Por një shkëmb që u shkëput nga mali u rrokullis dhe zuri hyrjen e shpellës, duke i lënë brenda. Pas kësaj, njëri u tha të tjerëve: “A keni ndonjë punë që i keni bërë vetëm për ta fituar kënaqësinë e Allahut? T’i lutemi Allahut duke i kujtuar ato. Ndoshta i Madhi Zot në saje të atyre veprimeve na e hap shpellën.” Pas këtij propozimi, njëri prej shokëve filloi të përgjërohej: “O Zoti im! Unë kam pasur prindërit pleq dhe fëmijët e vegjël. I rritja duke ruajtur bagëtinë. Në mbrëmje, kur kthehesha nga kullotat, i milja kafshët dhe së pari u jepja prindërve të pinin qumësht. Një ditë vajta në një kullotë të largët



Krahas sjelljes së mirë, respektit dhe dëgjueshmërisë së prindërve në të gjallë të tyre, obligimet dhe mirësjellja ndaj tyre nuk përfundojnë me vdekjen e tyre.

dhe mbeta deri vonë atje. Kur erdha në shtëpi, pashë se nëna dhe babai kishin rënë të flinin. Si çdoherë, mola bagëtinë dhe me një enë me qumësht qëndrova pranë tyre. S'më bëhej t'i zgjoja. Nga ana tjetër s'e shihja me vend që t'u jepja qumështin së pari fëmijëve, të cilët para këmbëve të mia qanin nga uria. Prindërit flinin gjumë, kurse unë derisa u zbardh, gjithë natën, qëndrova pranë tyre. Zoti im! S'ka dyshim se Ti e di që këtë veprim e kam bërë vetëm për ta fituar kënaqësinë Tënde, ndaj të lutem hape derën e shpellës që të shohim pak dritë." Dhe Zoti ua hapi një vrimë sa të shohin dritën. Pasi edhe i dyti tregoi mirësinë e vet të sinqertë, e çara e shpellës u zmadhua dhe drita kaploi shpellën. Dhe kur personi i tretë përfundoi tregimin për mirësinë e bërë, dera e shpellës u hap plotësisht.⁹

Rregulla të arta të mirësjelljes me prindërit

Respektimi dhe mirësjellja ndaj prindërve është detyrë dhe obligim i çdo besimtari, ndërkaq mosrespektimi i tyre është i ndaluar.

Mosrespektimi ndaj tyre lejohet vetëm në rastet kur ata kërkojnë t'i bëhet shok Allahut në adhurim, por edhe atëherë prej fëmijëve kërkohet sjellje e mirë dhe e butë: "Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në

adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijëni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë..." (Llukman, 15). Ndaj tyre kërkohet që të sillemi mirë e me butësi, e t'i lëshojmë krahët e përluljes, ashtu siç na ka mësuar Allahu: "Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet." (El-Ahkaf, 15). Ata kanë nevojë për sjellje të mira të fëmijëve të tyre sidomos kur e arrijnë pleqërinë e kur dobësohen. Pejgamberi a.s. e ka mallkuar dhe e ka përbuzur atë personi tek i cili kalojnë pleqërinë njëri ose të dy prindërit e tij, e që nuk bëhen shkaktar ata për hyrjen e atij personi në Xhenet. "I përbuzur është, i përbuzur është, i përbuzur është ai që e arrin pleqërinë e njërit ose të dy prindërve të tij dhe (për shkak të moskujdesjes ndaj tyre) nuk hyn në Xhenet."¹⁰

Respekti ndaj prindërve nuk ka të bëjë vetëm me prindërit besimtarë myslimanë, sepse mbi të gjitha ata dy janë prindër, që nga fëmijët meritojnë respekt dhe bamirësi. Dijetarët kanë thënë se nuk kushtëzohet që prindërit të jenë myslimanë për t'u respektuar.¹¹ Për këtë, Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: "Allahu nuk ju ndalon të shprehni mirësinë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre, të cilët nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë (suaj) dhe që nuk ju dëbojnë juve prej

shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtë." (El-Mumtehine, 8).

Besimtari mysliman është i kujdesshëm me sjellje ndaj prindërve të tij, nuk e ngre zërin mbi zërin e tyre, nuk i kundërshton me zë të lartë, "... mos u thuaj as "uh", mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti." (El-Isra, 23), nuk ecën para tyre, nuk hynë e as nuk del pa kërkuar lejen e tyre. Ai është modest para tyre dhe i lëshon krahët e përluljes në shenjë mëshire ndaj tyre.¹²

Në kapitullin e parë e përmendëm se besimtari mysliman duhet të kërkojë leje dhe miratim nga prindërit edhe kur kërkon që të shkojë në xhihad. Pejgamberi a.s. në disa raste i kishte kthyer personat me këshillën që të kujdeseshin për prindërit e tyre. Ndër këshillat e arta të mirësjelljes me prindërit është edhe ajo se njeriu nuk duhet të tregohet koprrac me prindërit e tij. Pejgamberi a.s. i kishte thënë një njeriu: "Ti dhe pasuria jote jeni e prindit tënd."¹³

Nuk lejohet sharja e tyre ose të bëhemi ne shkak për sharjen e tyre, ngase kjo llogaritet ndër gjynahet e mëdha dhe ndër gjërat më të shëmtuara. Kështu na ka mësuar Pejgamberi a.s., i cili ka thënë: "Ndër gjynahet e mëdha është që njeriu t'i shajë prindërit e tij." Një i pranishëm i tha: "Po a ndodh që njeriu t'i shajë



prindërit e vet?” Pejgamberi a.s. i tha: “Po! Ky e shanë babanë e ndonjë njeriu, e ai e shanë babanë e tij, e shanë nënën e ndonjë njeriu, e ai e shanë nënën e tij.”¹⁴

Krahas sjelljes së mirë, respektit dhe dëgjueshmërisë së prindërve në të gjallë të tyre, obligimet dhe mirësjellja ndaj tyre nuk përfundojnë me vdekjen e tyre. Ndër rregullat e mirësjelljes me prindërit e vdekur janë edhe lutja për ta. Besimtari mysliman duhet të lutet shumë pas vdekjes së tyre, madje-madje edhe më shumë se sa është lutur sa kanë qenë gjallë, ngase lutja për ta nënkupton shtimin e të mirave të tyre. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur vdes njeriu, puna e tij ndërpritet përveç tri rasteve: sadakasë së përhershme (hajratit), nga dituria prej së cilës kanë dobi të tjerët ose nga fëmija i vyeshëm i cili lutet për prindërit.”¹⁵

Përveç lutjes, besimtari mysliman duhet të kërkojë falje (istigfar) për prindërit, ashtu siç na ka mësuar Allahu në Kuranin fisnik: “O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën kur do të jepet llogari.” (Ibrahim, 41). Këto fjalë i kishte përmendur Pejgamberi Ibrahim a.s..

Pas vdekjes së prindërve, mbesin shumë njerëz me të cilët ne duhet t'i mbajmë lidhjet farefisnore. Ata janë xhaxhallarët, gratë e tyre, dajallarët, tezet, hallat, gjyshi, gjyshja, fëmijët e tyre etj., e për këta Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush dëshiron t'i mbajë lidhjet me prindin e tij në varr, le t'i mbajë lidhjet me vëllezërit e prindit të tij pas vdekjes së tij.”¹⁶

Përveç me familjarët, me të cilët kërkohet të mbahet e të vazhdohet lidhja, na besimtari mysliman kërkohet edhe respektimi i shokëve të prindërve. I biri i Omerit r.a. e kishte takuar një fshatar në rrugët e Medinës dhe e kishte përshëndetur, e kishte hipur në gomarin e tij, të cilin e kishte pasur me vete dhe ia kishte dhënë kapelën, të cilën e mbante në kokë për ta mbuluar kokën. Ibën Dinari ka thënë: “I thamë: “Të drejtoftë Allahu, a nuk e vërejte se

Bindja, dëgjueshmëria, sjellja e mirë dhe respektimi i prindërve ka bërë që në historinë islame, disa personave emri t'u njihet në qiej, duke qenë fare të panjohur në tokë.

ishte fshatar dhe se ata kënaqen me pak?!” I biri i Omerit tha: “Babai i këtij ka qenë shok i dashur (mik) i Omer ibën el-Hatabit. E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s., duke thënë: “Vërtet, bamirësi më e mirë është që njeriu t'i mbajë lidhjet me dashamirët e babait të vet pas vdekjes së tij.”¹⁷

Tregimi motivues i Uvejs el-Karnit

Bindja, dëgjueshmëria, sjellja e mirë dhe respektimi i prindërve ka bërë që në historinë islame, disa personave emri t'u njihet në qiej, duke qenë fare të panjohur në tokë. I tillë ishte edhe Uvejs el-Karni, për të cilin, njëherë i Dërguari i Allahut a.s. u tregoi shokëve të tij se në mesin e gjeneratës së dytë të myslimanëve ndodhej një person i quajtur Uvejs, i cili e trajtonte nënën e tij me mirësi dhe ishte i dëgjueshëm ndaj saj. Ai tha: “Nëse ai do t'i lutej Allahut, Ai do t'i përgjigjej. Ai (Uvejsi) ka një shenjë të lebrës, (nëse keni rastin ta takoni), kërkoni të lutet për falje për ju.”

Pasi Omer ibën Hatabi u bë kalif, ai shpesh i pyeste delegacionet e Jemenit: “A është Uvejs ibën Amiri në mesin tuaj?” Kur më në fund Omeri u takua me Uvejsin e pyeti nëse e kishte nënën gjallë. Ai i tha: “Po.” Pastaj Omeri tha: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s., duke thënë: “Do të vij te ju një

person i quajtur Uvejs ibën Amiri me një grup nga populli i Jemenit. Ai i takon fisit Karan, i cili është degë e Muradir. Ai ka pasur lebrë nga e cila është shëruar përveç një pjese sa madhësia e dërhemit, e cila i ka mbetur. Ai është shumë i mirë dhe i dëgjueshëm ndaj nënës. Nëse do të betohej në emrin e Allahut, Ai xh.sh. do ta nderonte atë. Nëse është e mundur, kërkoni të lutet për falje për ju.”¹⁸

Pas transmetimit të këtij hadithi, Omer ibën Hatabi r.a., i kërkoi Uvejsit që të lutet për falje (nga Allahu) për të. Kështu Uvejsi u lut për falje për kalifin e myslimanëve. Të ndalemi pak dhe të mendojmë statusin dhe superioritetin që kishte personi që ishte i dëgjueshëm dhe i respektueshëm ndaj nënës së tij. Kjo bëri që ai të përmendej nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ani pse nuk ishte sahabi, por i takonte gjeneratës së dytë të myslimanëve. Në të vërtetë, ai gëzonte një privilegj të madh për trajtimin dhe shërbimin e mirë që kishte ndaj nënës së tij.

Krejt në fund, gjithnjë duhet kujtuar lutjen kuranore, e cila duhet të jetë shoqëruesja jonë e përhershme: “Zoti ynë! Më fal mua, prindërit dhe besimtarët Ditën kur do të jepet llogaria!”

1. Abdul Malik Muxhahid, *Dashuria ndaj prindërve*, fq. 14, Prishtinë, 2005. 2. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, “Islami nëpërmjet haditheve IV”, fq. 188. 3. *Transmeton Tirmidhiu*, 1899. 4. *Suneni Ebu Davud III, Libri mbi xhihadin*, nr. 2528. 5. *Transmetojnë Buhariu*, 3004 dhe *Muslimi*, 2549. 6. *Transmeton Buhariu*. 7. *Saffat*, 102; *Jusuf*, 94. 8. *Transmetojnë Buhariu*, 5971 dhe *Muslimi*, 2548. 9. *Transmetojnë Buhariu*, 2215 dhe *Muslimi*, 6949. 10. *Transmeton Muslimi*, 2551. 11. *Muhamed Ratib Nabulsi, Respekti ndaj prindërve*, fq. 16, Prishtinë, 2022. 12. *Abdul Aziz en-Neda, Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave islame*, fq. 143, Shkup, 2010. 13. *Transmetojnë Ahmedi*, 2/204, *Ebu Davudi*, 3530 dhe *Ibën Maxhe*, 2292. 14. *Transmetojnë Buhariu*, 5973 dhe *Muslimi*, 90. 15. *Transmeton Muslimi*, 1631. 16. *Transmeton Ibën Hibani*, 433. 17. *Transmeton Ibën Hibani*, 433, marrë prej librit “Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave islame”, Abdul Aziz en-Neda, fq. 148, Shkup, 2010. 18. *Transmeton Muslimi*.

Msc. Abdullah Klinaku

Përplasja e qytetërimeve ndërmjet Lidhjes (1878) dhe Kongresit të Berlinit

Ballkani si pak vende në botë është vendi i prekjes së tri qytetërimeve. Qytetërimi perëndimor, ku shtrat të vetin fetar e ka krishterimin e ritit katolik, qytetërimi sllavo-ortodoks, ku shtrat të vetin fetar e ka krishterimin e ritit ortodoks dhe qytetërimi islam apo osman, ku shtrat të vetin fetar e ka Islam. Prekja e qytetërimeve nuk do të duhej të nënkuptonte edhe përplasjen e tyre. Në një botë të njerëzishme, vendi ku preken qytetërimet do të duhej të ishte vendi ku kultivohen vlerat e bashkëpunimit, harmonisë dhe mirëkuptimit në dallueshmërinë e parimeve dhe vlerave që përfaqësojnë qytetërimet përkatëse. Me gjithë synimin për një shtrat paqeje ndërmjet qytetërimeve, Ballkani gjatë historisë shpesh herë ka qenë vendi i përplasjes së tyre dhe i interesave strategjike të fuqive të kohës. Në këtë përplasje të madhe

dhe prishje të ekuilibrave më së shumti kanë vuajtur shqiptarët dhe boshnjakët. Rrjedhimisht historia i ka zbratur padrejtësitë e veta mbi popujt ballkanik që kanë qenë me shumicë myslimane. Ndër përplasjet e mëdha ndërmjet qytetërimeve dhe interesave strategjike të fuqive të kohës në Ballkan me ndikim të madh në fatin e shqiptarëve janë vitet 1876-1880, ku përshinë kohën e luftës osmano-ruse (1877), lidhjen e Traktatit të Shën Stefanit (1878), Kongresin e Berlinit (1878) dhe Lidhjen e Prizrenit (1878).

Sfondi historik

Në fillim të viteve 1870-të, Rusia cariste filloi të nxisë me shpejtësi ortodoksët e Ballkanit, serbët, malazezët dhe bullgarët për revoltë ndaj Perandorisë Osmane. Konflikti i parë filloi në prillin e vitit 1875 me krye-

ngritjen në Bosnjë dhe Hercegovinë, pas saj në muajin maj nisi kryengritja bullgare,¹ ndërsa më 2 korrik të vitit 1876, Serbia dhe Mali i Zi i shpallën luftë Perandorisë Osmane,² me qëllim të pavarësimin të tyre. Perandoria Osmane me lehtësi i shuante këto kryengritje derisa nisi presioni rus dhe kërkesa e tyre për ndarje në baza fetare të hapësirës së Ballkanit. Për këtë, Rusia kërkoi që Bosnja dhe Hercegovina t'i jepeshin Malit të Zi, ndërsa Bullgaria të shkonte drejt rritjes së saj dhe lidhjeve speciale me Rusi. Këtë tendencë ruse, pala osmane e kundërshtonte ashpër derisa dukej qartë një luftë e pashmangshme ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Ruisë.

Më 24 prill të vitit 1877, Rusia shpalli luftën me shtetin Osman në dy fronte, në atë të Ballkanit dhe atë të Kaukazit. Në këtë kohë Perandoria Osmane ishte në kohën e saj më të



dobët dhe me kapacitete tepër të kufizuara. Kriza e brendshme, luftërat e vazhdueshme, kriza ekonomike dhe borxhet e shtetit, përpjekjet për rrëzimin e sulltan Abdulhamidit, ku brenda dy viteve kanë dështuar tre grusht shtete dhe atentate,³ ardhja e tij si sulltan në moshë të re dhe vetëm një vit para shpërthimit të luftës, Kuvendi osman i përçarë e me agjenda të ndryshme i cili përbëhej nga 106 deputetët, prej tyre 59 myslimanë dhe 47 jo myslimanë,⁴ gjendja e rëndë e ushtrisë dhe shëndetësisë, bënë që Perandoria Osmane të kapitulloi në luftën ndaj Rusisë.

Përparimi i ushtrisë ruse rrezikonte edhe kryeqytetin osman. Perandoria Osmane vendosi të nis negociata për arritjen e një marrëveshje ndërmjet saj dhe Rusisë. Marrëveshja që pritej të nënshkruhej ishte në dëm të madh të Perandorisë Osmane, e sidomos në dëm të shqiptarëve. Arkitekti i traktatit të Shën Stefanit ishte ish-ambasadori rus në Stamboll (1864), Ignatievi, i cili kishte hartuar një traktat që përmbushte ambiciet më të liga ruse në Ballkan. Përmes këtij traktati, Rusia përveç zgjerimit të territorit të vet arriti të impononte edhe pavarësinë e Rumanisë, Serbisë e Malit të Zi, kryerjen e reformave në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe më në fund krijimin e një principate autonome bullgare.⁵

Pas nënshkrimit të Traktatit të Shën Stefanit, prishjes së ekuilibrave në Ballkan përmes fuqizimit absolut rus dhe shqetësimit të daljes së Rusisë deri në detet e ngrohta, Anglia dhe Austro-Hungaria nisën angazhimin për cilësimin e traktatit të Shën Stefanit si marrëveshje e cila e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Për të nisur këtë nismë, Anglia kishte hyrë në negociata me Perandorinë Osmane, për çka kërkonte prej saj dhurimin e Qipros nën administrimin e saj. Sulltan Abdulhamidi II ishte para një momenti të vështirë të vendimmarrjes, megjithatë, duke vlerësuar interesin për popujt e Ballkanit, vendosi që me datën 4 qershor 1878 të firmos marrëveshjen

me shtetin anglez për administrimin e Qipros nga Anglia.⁶ Në këmbim të Qipros dhe në synimin për ruajtjen e interesave strategjike në Ballkan, Anglia dhe Austro-Hungaria inician punimet e Kongresit të Berlinit, i cili do të ishte në dëm të shqiptarëve në veçanti dhe shtetit Osman në përgjithësi.

Raporti i Lidhjes së Prizrenit (1878) me Kongresin e Berlinit

Angazhimi britanik për Kongresin e Berlinit ishte interes strategjik i saj. Me këtë, Anglia fitoi sundimin e Qipros duke siguruar interesa të ngushta edhe në çështjet e Lindjes së Mesme, ndalimin e depërtimit direkt rus në tërë Ballkanin si dhe zotërimi rus në Mesdheun lindor shihej si kërcënim për sundimin britanik të Indisë nga Anglia. Po ashtu, përmes kësaj nisme, Anglia kishte manifestuar një fitore të qytetërimit perëndimor duke ringjallur idenë e një "marrëveshje të Evropës", me pak fjalë, të veprimt të koordinuar nga fuqitë e mëdha, të cilat në këtë rast i bënin presion qeverisë osmane për të përmbushur detyrimet e reja kontraktuale.⁷

Duke pasur parasysh qëllimet e organizimit të Kongresit të Berlinit, që ishin të ndërtuara mbi motive religjioze e strategjike e jo me qëllime

për vendosjen e drejtësisë dhe lirisë për popujt ballkanik në përgjithësi, nuk pritej asnjë dobi e madhe për shqiptarët. Prandaj, fati i shqiptarëve mbeti i lidhur me fatin e Perandorisë Osmane në Ballkan dhe me vetë organizimin e tyre, gjë që u organizua Lidhja e Prizrenit e vitit 1878, për arsytet dhe motivet e së cilës është shkruar shumë. Në këtë rast, do të përpiqemi të shpërfaqim qëndrimin e Kongresit të Berlinit ndaj Lidhjes bazuar në motivet e interesave strategjike për dominimin e qytetërimit perëndimor dhe injorimin e kombeve që i përkisnin besimit islam.

Interesimi i fuqive të kohës sipas studimit të Mehdi Frashërit bëhej në pikëpamje të fesë dhe racës.⁸ Shqiptarët dhe Lidhja e formuar në shtratin e qytetërimit osman me interesa të gërshtuara, në pajtim me rrethanat e kohës, injorohej në tërësi dhe shihej kryekëput si organizim fetar i myslimanëve. Në Kongresin e Berlinit qenë marrë parasysh interesat e të gjithë popujve ballkanik, me një përjashtim vetëm të shqiptarëve. Shqiptarët jo vetëm që nuk kishin gjetur mbrojtje, por dhe ekzistenca e një kombësie shqiptare në përgjithësi qe mohuar. Vendimtare për një qëndrim të tillë mund të ketë qenë fakti se shumica e shqiptarëve ishin konvertuar në fenë islame.⁹ Shumë observues, përfshirë konsullin Kirby Green, deklaruan se pas Lidhjes Shqiptare qëndronte Porta e Lartë.¹⁰



Shumë politikanë, historianë dhe opinionionistë në Britani e shikonin çështjen lindore nëpërmes prizmit të krishterëve që jetonin nën “shtetin barbar dhe të pafë të otomanëve”. Lindja e shteteve të reja konsiderohej si orvatje e kombeve të reja të krishtera kundër Perandorisë Osmane, e cila në esencë konsiderohej si myslimane. Shqiptarët nuk hynin lehtë në këtë kornizë, sepse shumica e tyre ishin myslimanë.¹¹

Shteteve evropiane të kohës, jo vetëm që nuk ju interesonte fare çështja e kërkesave të Lidhjes, por i injorin edhe krimet, dhunën dhe dëbimet që ngjanin te shqiptarët. Injorimi i gjendjes së rëndë të shqiptarëve nga qeveritë e shteteve evropiane përcillej edhe me injorimin që i bënte opinionistët publik dhe mediat e vendeve evropiane. Gjendja e rëndë e refugjatëve gjatë vitit 1878 e raportuar nga diplomatët të ndryshëm mezi bënte ndonjë lajm në shtypin britanik ose evropian, i cili përkrahte idetë liberale dhe vazhdon të raportonte vetëm për situatat që kishin të bëjnë me krishterët.¹²

Kongresi i Berlinit nuk ia hapi dyert Lidhjes së Prizrenit edhe pse Lidhja bëri përpjekje të dëshmojë aftësinë që kishte për ta përfaqësuar tërë kombin. Madje, Bismarcku, deklaroi se nuk e njihte ekzistimin e një kombi të veçantë shqiptar. Në kuadër të këtij refuzimi kategorik të kërkesave të Lidhjes, edhe pse brenda saj kishte myslimanë e të krishterë, shqiptarë, turq e boshnjak, shtete të caktuara, interesimin e vetëm e kishin për lëvizjet religjioze të krishtere siç ishte zona e Mirditës. Austro-Hungaria ishte e zëshme vetëm në kujdesin për shqiptarët katolik. Platforma gjithëpërfshirëse e Lidhjes sfidohej nga projekti religjioz që përfaqësohej nga grupimi i dytë që synonte krijimin e një principate autonome katolike shqiptare, të cilën e përkrahu edhe monsinjor Prenk Bibë Doda. Ai nuk do të zgjidhte mjete për ta sendërtuar këtë ide, madje për këtë qëllim do të bashkëpunonte edhe me Malin e Zi. Këtë ide e ndihmoi edhe Austro-

Lidhja Prizrenit u zhvillua në Medresenë e Mehmet Pashës dhe në xhaminë “Bajrakli”, pjesëmarrës të së cilës ishin nga të gjitha vilajetet përfshirë shqiptarë, turq e boshnjakë. Lidhja përfshinte myslimanë dhe katolikë.

Hungaria, por edhe arbëreshët, si politikisht ashtu edhe me armë.¹³

Madje Austria si mbrojtëse zyrtare e katolikëve shqiptarë, gjithashtu nuk e pëlqente idenë e një Shqipërie të bashkuar, sepse katolikët do të ishin një pakicë në të. Prandaj, politika e preferuar ishte të theksonte dallimet ndërmjet shqiptarëve myslimanë dhe katolikë, të punohej gradualisht drejt krijimit të veçantë të një njësie territoriale të katolikëve shqiptarë të veriut, në të njëjtën kohë për të shmangur mosmarrëveshjet e nevojshme me Malin e Zi, ose ndonjë forcim tjetër të panevojshëm të Malit të Zi.¹⁴

Qëndrimi i Konferencës së Berlinit ndaj shqiptarëve dhe Lidhjes mbi paradigmen e përplasjes së qytetërimeve përmbledhet më së miri në shprehjet e konsullit William Kirby Green, në Shkodër, i cili supozonte se të vetmit shqiptarë që kishin prirje autonomiste ishin katolikët romanë. Që Lidhja ishte në thelb një organizatë myslimane, që Lidhja ishte e paafte për të praktikuar një bashkëpunim real me katolikët dhe se Lidhja ishte pak më shumë se sa një mjet i qeverisë osmane, që u krijua për të penguar dorëzimin e territorit të kërkuar nga Traktati i Berlinit.¹⁵

Roli i sulltan Abdulhamidit II në raport me Lidhjen (1878)

Lidhja Prizrenit u mbledh më 10 qershor 1878 në Prizren, në të cilën u vendos krijimi i saj. Kjo mbledhje u zhvillua në Medresenë e Mehmet Pashës dhe në xhaminë “Bajrakli”, pjesëmarrës të së cilës ishin nga të gjitha vilajetet përfshirë shqiptarë, turq e boshnjakë. Lidhja përfshinte myslimanë dhe katolikë. Lidhja e ngriti konceptin e vet nga shtrati i qytetërimit islam, brenda së cilit përfshiu njerëz pa dallim feje, race apo etnie. Ajo u organizua nga intelektualë, kadij, ylema e imamë të kohës. Qëllimi i saj ishte i qartë, liria, mbrojtja dhe drejtësia për shqiptarët, boshnjakët dhe të gjithë popujt e shtypur në Ballkan. Lidhja me aktet e nxjerra që tanimë njihen publikisht kishte hartuar konceptin e qartë politik për të ardhmen e shqiptarëve dhe për mbrojtjen e tokave shqiptare. Debati se a ishte Lidhja fetare apo kombëtare tanimë duhet të jetë debat i tejkualuar. Lidhja ishte organizim në kuadër të një qytetërimi, i cili nuk njeh dallime racore e fetare. Lidhja ishte ngritur mbi vlerat e qytetërimit islam që obligim e detyrim e konsideron mbrojtjen e atdheut. Përderisa shtetet evropiane ia kishin mbyllur dyert, Rusia kishte synuar t'i ndante territorialisht nga Dvletit dhe t'i gllabëronin gradualisht fqinjët ballkanik, Sulltan Abdulahmidi II, me marrëveshjen me Britaninë për sundimin e Qipros në dobi të saj, krijoi kushte të reja për përpjekjen e shqiptarëve për mbrojtjen e tokave të tyre.

Më 2 nëntor të vitit 1878, konsulli Lippich raportonte se sheh Mustafa i Tetovës, në korrik të atij viti shkoi në Stamboll, i ngarkuar me një mision të veçantë prej anës së Lidhjes, ku kishte takuar ministrin dhe sulltanin. Me kthimin në Shqipëri kishte

Lidhja ishte organizim në kuadër të një qytetërimi, i cili nuk njih dallime racore e fetare. Lidhja ishte ngritur mbi vlerat e qytetërimit islam që obligim e detyrim e konsideron mbrojtjen e atdheut.



biseduar me valiun, Nazif Pashën, në Prishtinë e kërret e Lidhjes, ndërsa në Gjakovë e Pejë me kadiun Ahmet Koronicën, e me të tjerë “fanatikë”. Po ashtu edhe konsulli austro-hungarezë në Prizren, Jelinek, informonte kontin Andrash, se sheh Mustafa i Tetovës, ishte kthyer prej Stambolli në Prishtinë më 21 shtator, bashkë me Iliaz Pashën e Dibrës e haxhi Ymer Efendinë, të nesërmen mbrëma ishin takuar me valiun.¹⁶

Mund të pranojmë si gjë të sigurt se krijimi i Lidhjes së Prizrenit ishte një gjë shumë e volitshme për Portën e lartë dhe qe pritur duruar me dashamirësi nga autoritetet turke. Ka të ngjarë që në kohët e para, Lidhja ka qenë mbajtur me paratë e qeverisë, shkruan Peter Bartel. Ndërsa regjistrohët se Lidhja kërkoi nga Sulltani 18.000 lira flori. Nga kjo shumë, gjysma mbërriti menjëherë nga sulltani, dhe tjetra iu vu në dispozicion në Selanik. Ali Pashë Gucisë iu dërguan nga Meka 2000 lira flori, një flamur i bekuar, dekorata dhe armë. Mitrovicës iu dërguan 16.000 martina.¹⁷

Raporti i Lidhjes dhe shqiptarëve me sulltan Abdulhamidin II ishte i vazhdueshëm dhe problemet e mëdha trajtoheshin brenda llojit.

Edhe mosmarrëveshjet po ashtu trajtoheshin brenda llojit. Për këtë sulltan Abdulhamidi II, deklaroi se: Ndonëse midis tyre ka edhe familje kristiane, shqiptarët që si popull gjenden në Evropë, janë vëllezërit tanë myslimanë, te të cilët mund të kemi besim në çdo rast, si dhe janë ushtarët tanë besnikë. Nga ky popull kanë dalë ushtarë dhe drejtues të jashtëzakonshëm. A nuk janë prej tyre edhe ata që gjenden përreth sulltanatit tim?¹⁸

Përfundim

Lufta osmano-ruse, Traktati i Shën Stefanit dhe ai i Berlinit, ishin në dëm të madh të shqiptarëve. Dëmet e Traktatit të Shën Stefanit sikur të mbetej në fuqi do të ishin të riparueshme për popullin shqiptar. Rusia sipas kësaj marrëveshje grabiste 172 mijë kilometra katrorë, ndërsa pas Konferencës së Berlinit përfundoi me 64 mijë kilometra katrorë. Traktati i Shën Stefanit, myslimanët e Ballkanit, shqiptarët, turqit dhe boshnjakët i ndante në tërësi pothuajse nga Perandoria Osmane. Thjesht krijoheshin kushte për asimilimin e shqiptarëve. Megjithëse

dëmet që i solli Kongresi i Berlinit ishin po ashtu shumë të mëdha.

Zbatimi i Traktatit të dalë nga Kongresi i Berlinit u bë me forcë të jashtëzakonshme mbi Perandorinë Osmane dhe shqiptarët duke i kërcënuar në vazhdimësi për shfaqje totale të tyre në rast të moszbatimit. Presioni i Fuqive të Mëdha mbi Perandorinë Osmane u shtua çdoherë e më shumë. Sulltani lajmëroi kryetarin e Lidhjes së Prizrenit se fuqitë e krishtera i bënin presion të madh dhe se ka rrezik ta rrezonin nga fronti. Prandaj, nuk mund të merrej më me Lidhjen. Pas këtij informacioni, Lidhja vendosi të mbante një mbledhje pas Ramazanit.¹⁹

Lidhja vazhdoi aktivitetin dhe luftën e saj duke ndërtuar themelin e shtetit të ardhshëm shqiptar, i cili po ashtu u ngrit i copëzuar si rezultat i paragjykimëve të shteteve të kohës ndaj shqiptarëve myslimanë.

1. Engin, Vahdetin “Abdulhamidi II – sulltani i fundit i një epoke”, Sh. B. “Fan Noli” Tiranë, 2019, fq. 48.
2. Bartel, Peter, “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (187801912)”, Sh. B. “Dituria” 2006, fq. 141.
3. Engin, Vahdetin “Abdulhamidi II – sulltani i fundit i një epoke”, Sh. B. “Fan Noli” Tiranë, 2019, fq. 57.
4. Engin, Vahdetin “Abdulhamidi II – sulltani i fundit i një epoke”, Sh. B. “Fan Noli” Tiranë, 2019, fq. 44.
5. Kirmiz, Abdulhamid “Ferid Pashë Vlora”, Sh. B. “Logos-A” Shkup, 2018, fq. 48.
6. Engin, Vahdetin “Abdulhamidi II – sulltani i fundit i një epoke”, Sh. B. “Fan Noli” Tiranë, 2019, fq. 52.
7. Malcolm, Noel, “Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit” Sh. B. “Artini” Prishtinë, 2020, fq. 526.
8. Frashëri, Mehdi “Liga e Prizrenit edhe efektet diplomatike të saj”, SH.B. “ALSAR”, Tiranë, fq.3.
9. Bartel, Peter, “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (187801912)”, Sh. B. “Dituria” 2006, fq. 142.
10. Daut, Dauti, “Britani dhe çështja shqiptare”, Sh.B. “Logos-A”, 2020, fq. 78.
11. Daut, Dauti, “Britani dhe çështja shqiptare”, Sh.B. “Logos-A”, 2020, fq. 83.
12. Daut, Dauti, “Britani dhe çështja shqiptare”, Sh.B. “Logos-A”, 2020, fq. 73.
13. Malcolm, Noel, “Kosova- Një histori e shkurtër” Sh.B. “Koha” fq. 85.
14. Malcolm, Noel, “Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit” Sh. B. “Artini” Prishtinë, 2020, fq. 531.
15. Malcolm, Noel, “Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit” Sh. B. “Artini” Prishtinë, 2020, fq. 532.
16. Sadiku, Xhafer, “Midis perandorive dhe religjioneve”, Tiranë, 2021, fq. 326-327.
17. Sadiku, Xhafer, “Midis perandorive dhe religjioneve”, Tiranë, 2021, fq. 330.
18. Sulltan Abdulhamid II, “Kujtimet nga politika”, Sh. B. “Sira” Prishtinë, 2021, fq. 104.
19. Sadiku, Xhafer, “Midis perandorive dhe religjioneve”, Tiranë, 2021, fq. 330.

Dr. Nuridin Ahmeti

Hafëz Ibrahim Dalliu për çështjen çame

Qëndrimet e qeverive greke ndaj komunitetit shqiptar në Çamëri pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe pushtimit të kësaj krahine nga Greqia më 1913 e deri më sot kanë qenë në funksion të zhbërjes së çdo gjëje shqiptare dhe greqizmit të saj me emigrantë nga Azia e Vogël.

Hyrje

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e vitit 1913, e cila ishte mbledhur për t'i dhënë zgjidhje problemeve ballkanike, la jashtë shtetit të ri shqiptar gati gjysmën e territoreve shqiptare; Kosovën, pjesën shqiptare të Maqedonisë dhe Çamërinë, të cilat në mënyrë permanente iu nënshtruan përndjekjes dhe shkombëtarizimit.

Ashtu si fati i shqiptarëve të tjerë të mbetur jashtë trungut të shtetit amë, edhe fati i shqiptarëve të Çamërisë ishte tragjik dhe i dhimbshëm. Tragjedia çame kishte jo vetëm aspektin territorial, por edhe njerëzor.

Qëndrimet e qeverive greke ndaj komunitetit shqiptar në Çamëri pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe pushtimit të kësaj krahine nga Greqia më 1913 e deri më sot kanë qenë në funksion të zhbërjes së çdo gjëje shqiptare dhe greqizmit të saj me emigrantë nga Azia e Vogël. Athina zyrtare nuk u ka njohur asnjë të drejtë kombëtare shqiptarëve të Çamërisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka qenë i ndaluar si në shkollat ashtu edhe në përdorim publik.

Ky koncepti shovinist ishte përcaktuar në dy drejtime:

1. Ndaj shqiptarëve të besimit ortodoks, politikën e asimilimit, duke i privuar nga çdo e drejtë etnike, kulture, apo gjuhësore, duke i konsideruar grek, pra ngatërronin me

qëllim fenë dhe kombësinë, veprim që e bëjnë edhe sot ndaj shqiptarëve duke pretenduar se të gjithë ortodoksët janë grek.

2. Ndaj shqiptarëve të besimit islam aplikuan politikën e gjenocidit dhe shfarosjen duke mohuar gjithashtu etninë. Në shumë raste me qëllim i kanë konsideruar turko-çam dhe jo shqiptaro-çam.

Ajo që do t'i pllakosë çamët në shpirt edhe më shumë janë veprimet e shtetit grek në vitet 1923-1924, e që pa mëdyshje se për popullatën e kësaj ane do të jenë vdekjeprurëse. Marrëveshjes së Lozanës të janarit të vitit 1923 ndërmjet Turqisë dhe Greqisë, për shkëmbimin e turqve myslimanë me grekët e Anadollit, do t'i jepej konotacion tjetër nga qarqet zyrtare greke, sepse midis turqve myslimanë do të përfshihen edhe çamët myslimanë me origjinë shqiptare që banonin në Greqi, edhe pse përfaqësuesi i Qeverisë greke, më 19 janar 1923 në Lozanë deklaroi se qeveria e tij nuk kishte aspak ndërmend t'i fuste në shkëmbim, myslimanët me origjinë shqiptare.

Në kundërshtim me realitetin historik dhe marrëveshjet e arritura, shteti grek detyron forcërisht këmbimin e çamëve, që arrijnë disa dhjetëra mijëra vetë, duke realizuar në atë kohë një pjesë të planit të kahershëm për një spastrim etnik të minoritetit autokton.

Ashtu si fati i shqiptarëve të tjerë të mbetur jashtë trungut të shtetit amë, edhe fati i shqiptarëve të Çamërisë ishte tragjik dhe i dhimbshëm.

I gjendur i tmerruar përball kësaj politike represive dhe hegjemoniste të shtetit grek, njëri nga patriotet më në zë të kohës së tij, Hafëz Ibrahim Dalliu, si kryeredaktor i gazetës "Dajti", që asokohe botohej në Tiranë, do t'i kushtonte një vëmendje të veçantë në faqet e kësaj gazete këtyre tragjedive, duke u bërë zë i fuqishëm në sensibilizimin e opinionit vendor dhe ndërkombëtar për represionin dhe përndjekjen e popullit çamë nga autoritetet e shtetit grek.

Dy fjalë për gazetën "Dajti" të Hafëz Ibrahim Dalliu

Gazetë e përjavshme politike, ekonomike e letrare. Numri i parë doli më 5 janar 1924 në Tiranë; vijoi deri në nr. 125. Doajeni dhe studiuesi

i gazetarisë shqiptare Hamit Boriçi, kur flet për gazetën që dilnin në fillim të shek. XX, ndër të tjera, shkruan: “Xhoka” dhe “Dajti” ishin dy gazeta që u botuan në Tiranë, por jehona e tyre u dëgjua edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë..., “Dajti”, e drejtuar nga Hafëz Ibrahim Dalliu, një prej figurave përparimtare e demokratike të klerit muhamedan në Tiranë. Ajo filloi botimin më 5 janar 1924, i kushtoi vëmendje të veçantë luftës kundër opinionit patriarkal, feudal, të prapambetur. Kjo gazetë shquhej për rubrikën “Dajti në gaz”, e cila botohej në faqe të parë dhe kishte autor vetë kryeredaktorin e fletores, publicistin H. I. Dalliu. Përmes humorit e satirës, stigmatizohet e vjetro, kritikoheshin mbeturinat feudale në jetën qytetare; përcilleshin ide e mesazhe përparimtare e demokratike. Në 125 numrat e saj, “Dajti” e ruajti natyrën, përmbajtjen, përparimtare e demokratike.¹

Gazeta “Dajti” për tragjedinë çame

Në faqet e gaztës “Dajti” çështja çame zuri një vend meritore. Me këtë rast do të sjellin disa nga numrat e saja, ku lexuesi ka rastin të shohë se çfarë mënyre dhe çfarë dimension i jep kjo gazetë çështjes çame dhe raporteve shqiptaro-greke në përgjithësi. Edituesit e saj pothuajse në çdo numër ia kushtonin nga një shkrim fatit të popullsisë çame, duke u shndërruar në një organ që po denonconte para publikut vendor dhe ndërkombëtar politik shfarosëse të shtetit grek, i cili në intencë për të realizuar idenë nacionaliste të Megalit. Ideja synonte shkombëtarizimin, jo vetëm ndaj Çamërisë, por edhe pushtimin e Jugut të Shqipërisë. Në këtë shkrim do të trajtojmë artikullin e gazetës “Dajti” nr. 42, të dt. 6 gusht 1924, me titull: “Populli çam dhe kabineti Noli”², në të cilin është dhënë një tablo e përgjithshme e sjelljeve më çnjerëzore të autoriteteve të shtetit grek ndaj



komunitetit shqiptar në krahinën e Çamërisë; “Autoritetet greke, me sjelljet e tyre çnjerëzore për deparimin dhe për çrrënjosjen e popullit shqiptar të Çamërisë, kujtojnë që realizojnë qëllimet imperilaistike të megallo-idesë së tyre qesharake, në dam të popullit dhe të shtetit Shqiptar”, thekson shkrimi në fjalë, duke vënë në dukje qëllimet djallëzore të Athinës zyrtare ndaj shqiptarëve. Njëherazi, përmes këtij artikulli gazeta “Dajti” i bënë me dije kabinetit Noli që çështjen çame duhet marrë shumë seriozisht; “Jemi sigurt se Kabineti Noli do t’i marrë gjithë masat që i lyp nevoja, interesi dhe nderi i Shqipërisë; edhe shpresojmë se do të ketë nevojë t’ja kujtojmë herë tjetër Qeverisë detyrën e sajë,” vinte theksin në artikullin e saj kjo gazetë shqiptare.

Ndërsa më 7 nëntor 1924, gazeta “Dajti” në nr. 53, me titull: “Çamerija në vajtim bijt e saj në panik!”, i bënte të njohur opinionit mbarë shqiptar për përndjekjen dhe mizorit e shtetit grek ndaj kësaj popullate, respektivisht vinte theksin te mënyra çnjerëzore e dëbimit të çamëve nga vendbanimet e tyre. Artikulli në fjalë përfundonte me një apel, ku thuhej: “Në emër të njerëzimit e të interesave kombëtare, bëjmë apel, për të fundit herë, në ndërgjegjen e popullit e të Qeverisë Shqiptare që t’i ndejnë dorën e shpëtimit racës Shqiptare të Çamërisë e cila po s’u interesuar juve me shpirt, është e dënur të humbasijë

për jetë! Popull, Shyp, djalëri, është detyra e juaj njerëzore e atdhetare të detyroni Qeverinë Shqiptare të zbatojë dëshirën e juaj të vertetë- (Tiranë më, 19-IX- 24, Zëri i Çamërisë).³ Po në këtë numër kemi edhe një shkrim me titull: “Nji sy mbi Camëriën”, ku vë në spikamë qëndrimin e delegatit italian Montagna, gjatë nënshkrimit të Traktatit të Lozanës, i cili ka mbrojtur popullin çam duke u bërë më dije autoriteteve të nënshkrimit se kështu nuk duhet të konsiderohen si turq.

Kurse në nr. 58, të dt. 11 dhjetor 1924, kjo gazetë sjellë shkrimin: “Sjelljet e Greqisë kundrejt Shqipërisë”, të ideologut të çështjes shqiptare nga Kosova, Hasan Prishtina, i cili me një stil plot nerv diplomatik dhe patriotik ve në pah interesat, siç thotë ai, të përbashkëta të dy popujve fqinj për ekuilibrimin e çështjes në Ballkan. Duke qenë një diplomat me eksperiencë të gjatë, Hasan Prishtina ka edhe sugjerimet e tija në këtë artikull kur thotë se Qeveria Shqiptare është treguar tolerante kundrejt grekëve në territorin shqiptar, duke u dhënë të drejtat e tyre si në shkollim, gjuhë etj., andaj me plotë të drejtë, Hasan Prishtina konstaton se: “Pra edhe na kena të drejtë me lyp prej Greqisë sjellje reciproke për Shqypetarët që banojnë në Greqi edhe sidomos për çamërit. Duhet Greqia me dhënë edhe Shqypetarëve të drejtat e pakicave sikundër që ja u dha Bullgarëve që banojnë në Greqi.”⁴ Gjithashtu,

Hasan Prishtina thekson se zgjidhja e çështjes çame dhe dhënia e të drejtave të tyre do të ishte shkak për zhdukjen e mosmarrëveshjeve në mes të këtyre dy kombeve, që sipas tij, janë më të moçmit kombe në Ballkan, “qi kan pasë një lidhje historike ndermejt veti prej shumë shekujsh.”⁵

Vuejtjet e vllazënvet t'onë Camër,⁶ është shkrimi tjetër i gazetës “Dajti” nr. 98, të dt. 24 shtator 1925, ku publikohet një telegram nga Saranda të përfaqësuesit të përgjithshëm të popullit shqiptar të krahinës së Çamërisë, zotëri Adem Mehmet Klefit, të cilin telegram ia dërgon Ministrisë së P. të Jashtme të Shqipërisë, ku potencon ardhjen e komisionit ndërkombëtar në Çamëri, trysnitë e autoriteteve greke ndaj popullatës shqiptare për ta mohuar këmbësin para komisionit, konfiskimi i pasurisë nga ana e autoriteteve greke ndaj atyre që deklarorin se janë shqiptarë, dhe njëkohësisht me anë të këtij telegrami kërkohet nga qeveria shqiptare të marrë masa diplomatike, siç thuhej: “...për shpëtimin e një pjesës së kombit shqiptar me shpëtue nga këto mizori, këto mizori e pa drejtësira të jashtë njerëzishme.”⁷

Edhe në numrat e tjerë, gazeta “Dajti” publikoi shkrime dhe artikuj përmes të cilëve pasqyrohet qëndrimi antishqiptar i shtetit grek dhe intenca e tij për shkombëtarizimin e krahinës së Çamërisë, duke ndryshuar dhunshëm strukturën etnike në dobi të elementit grekë, respektivisht duke vendosur emigrantë grekë dhe vllëhtë në pronat dhe vendbanimet shqiptare pa asnjë kompensim.

Kush ishte Hafëz Ibrahim Dalliu (1878-1952)

Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare dhe demokratike, hoxhë (hafëz), publicist, lëvrues i letërsisë artistike. Lindi në Tiranë, ku kreu Medresenë. Vijoi studime e larta në Stamboll.



Shërbeu në vendlindje si hoxhë (hafëz) dhe mësues. Dha mësim në shkollën e parë shqipe në Tiranë (1898). Më 1908 hapi shkollën shqipe të vajzave në Tiranë. Mori pjesë në Kongresin e Elbasanit në vitin 1909 dhe së bashku me Luigj Gurakuqin dhe Aleksandër Xhuvanin, Hafëz Ibrahim Dalliu qe nga të parët që themeloi Normalen e Elbasanit, e cila u hap me vendim të Kongresit të lartpërmendur. Ishte njëri nga themeluesit dhe drejtuesit e klubit patriotik “Bashkimi” në Tiranë dhe e përfaqësoi atë në Kongresin e Manastirit në vitin 1908. U bashkua me Qeten e kryengritësve kundër xhonturqve të Sarisalltektut më 1911. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtarë të Vlorës me 1912, pas vitit 1921 zhvilloi veprimtari të gjerë politike e shoqërore.⁸ Gjatë viteve 1920-1924 mori pjesë në Lëvizjen Demokratike.

Pas vitit 1912, Hafëz Ibrahim Dalliu iu kushtua publicistikës dhe letërsisë, drejtoi gazetën politike “Dajti”. Duke nisur nga viti 1918 deri më 1924 botoi një varg veprash, islame, satirike, patriotike etj.⁹

Ndër veprat e tij janë: “Dokrat e hinit” (1920), “Patriotizma në Tiranë” (1930), “Tefsiri shqip i Kur’anit” në dy vëllime, përkthyer nga arabishtja. “Udha muhamedane”, Tira-në më, 1936, etj.¹⁰ U përndoq, u burgos, maltretua nga xhonturqit, gjatë pushtimit italian, gjatë

monarkisë së A. Zogut dhe diktaturës së Enver Hoxhës.

Përfundim

Nga materialet e lartshënuara të gazetës “Dajti” lidhur me çështjen çame, mund të përfundojmë se, për informacionet që vinin nga Çamëria dhe që kishin të bënin me represionin e shtetit grek ndaj popullatës shqiptare të kësaj ane, për dëbimet, vrasjet përdhunimet, shpronësimet e dhunshme, kjo gazetë u bë një dritare dhe një zë i fuqishëm për denoncimin e politikave antishqiptare të Athinës zyrtare. Natyrisht, një meritë të veçantë për këtë punë kaq të çmueshme e ka drejtori i saj përgjegjës, Hafëz Ibrahim Dalliu, i cili u kujdes përherë që në faqet e gazetës “Dajti” çështja çame të kishte një hapësirë të veçantë, respektivisht që informacionet nga Çamëria të jenë shumë herë kryelajm dhe për këtë, ato editoheshin në ballinat e saj.

Po kështu, nga kërkimet e bëra mund të themi se “Dajti” ishte ndër gazetatat e vetme të kohës që i kushtoj një rëndësi të veçantë fatit të popullit çam dhe vuajtjeve të tij nën okupimin e shtetit grek, i cili me të gjitha mjetet bëri që kjo krahinë të greqizohet tërësisht, të mbetet pas asnjë shqiptarë. Gjithashtu vlen të shtohet se kjo gazetë çështjen çame nuk e trajtoi si një çështje të rastit, por ajo ishte e interesuar që çështja çame gjithmonë të jetë lart në listën e shkrimeve të saj, si një çështje që duhet denoncuar fuqimisht dhe në vazhdimësi.

1. Hamit Boriçi, *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997)*, Tiranë, 1997, f. 84, 85. 2. “Dajti”, nr. 42, dt. 6 gusht, Tiranë, 1924, f. 1. 3. “Dajti”, nr. 53, dt. 7 nëntor, Tiranë, 1924, f. 3. 4. “Dajti”, nr. 58, dt. 11 dhjetor, Tiranë, 1924, f. 2. 5. “Dajti”, nr. 58, dt. 11 dhjetor, Tiranë, 1924, f. 2. 6. “Dajti”, nr. 98, dt. 24 shtator, Tiranë, 1925, f. 3. 7. “Dajti”, nr. 98, dt. 24 shtator, Tiranë, 1925, f. 3. 8. Ibrahim Hasnaj (Hima), *Hafiz Ibrahim Dalliu (jeta dhe vepra)*, në: “Ditura Islame”, nr. 64, *Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 1995*, f. 64. 9. Hafëz Ibrahim Dalliu, *Veprat letrare, Botime Enciklopedike, Tiranë, 2000*. 10. Ismail Bardhi, *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzagjia e tij kur'anore, Logos-A, Shkup, 1998*.

Mihana Goga – Bekteshi

Vlera e lutjes

Që të gjithë ne kemi nevojë të lutemi, të gjithë ne kemi nevojë që t'ia qajmë brengat e hallet tona Atij që ka në dorë gjithçka. Lutja është të kërkuarit mirësi e ndihmë nga Zoti xh.sh. me një përlësi, dashuri e madhëri, duke e shprehur kështu paaftësinë tonë përballë madhështisë së Zotit xh.sh..

Lutja duhet të burojë nga zemra e zemra duhet të dridhet me dëshirat e kuptimit që ka duaja. Zoti xh.sh. në shumë vende në Librin e Tij ka urdhëruar të bëjmë dua, ashtu siç na ka premtuar se i pranon lutjet tona dhe se është afër lutësit: “E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet.” (El-Bekare, 186).

Lutja është çelësi i të gjitha të mirave. Kur besimtari e fillon ditën me lutje, ajo konsiderohet arma më e fortë e tij. Ai i cili i njeh kufijtë e vet, e di vendin e vet, e njeh veten, e njeh edhe Zotin e tij. Besimtari që e di kufirin dhe e di vendin ku e ka, di edhe të bëjë lutje, ngase e di se është rob dhe se Allahu është Zoti i tij. Na ka treguar Ebu Jemani, të cilin e informoi Shuajbi, që transmeton nga Zuhriu, e ai nga Ebu Seleme bin Abdurrahmani, se Ebu Hurejra r.a. ka thënë: “Pasha Zotin, unë i lutem Allahut për falje dhe pendohem gjatë ditës më shumë se shtatëdhjetë herë.”¹

Ebu Hurejra r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Për çdo natë, i Lartmardhërishtmi zbret në qiellin e tokës, në pjesën e tretë të natës dhe thotë: A ka ndokush ndonjë lutje që Unë t'ia pranoj? A ka

njeri që kërkon ndonjë gjë nga Unë, e Unë t'ia japë? A ka kush më kërkon falje për gynahet, e Unë t'ia fali?”

Istigfari – kërkim falja më e denjë

Na ka treguar Ebu Mameri, e ai nga Abdulvarithi, e ai nga Hysejni, e ai nga Abdullah bin Burejde, i cili transmeton nga Bushejr bin Kaab Adevij, se i ka treguar Sheddad bin Evsi r.a., i cili transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Sejjidul-istigfar është të thuash: “All-llahume ente rabbi, la ilahe il-la Entel! Halekteni ve ene abduke, ve ene ala ahdiqe ve va'adike, mastata'atu! Eudhu bike min sherr-ri ma sana'atu, ebu'u leke bi ni'ametike alejje, ve ebu'u bi dhenbi, igfir li! Fe innehu la jeg-firudh-dhunube il-la Entel!”

Më pas, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që e këndon këtë lutje ditën, me besim të fortë e të sinqertë (se ka sevape) dhe ndërron jetë para se të terrohet është njëri nga banorët e Xhenetit. Nëse e këndon këtë lutje natën, me besim të fortë e të sinqertë dhe ndërron jetë para se të gdhinë dita, është njëri nga banorët e Xhenetit.”²

Çfarë thuhet para gjumi

Na ka treguar Kasibe, e atij Sufjani, i cili transmeton nga Abdulmeliku, e ai nga Ribij bin Hirashi, e ky nga Hudhejfe, i cili ka thënë: Kur binte për të fjetur, Pejgamberi a.s. thoshte: “Bismike emutu ve ahja”, ndërsa kur ngrihej thoshte: “Qoftë lavdëruar Allahu që na ngjalli, pasi që na bëri si të vdekur, Atij i takon rigjallërimi.”³

Këndimi i Tavidhit – sureve Felek dhe Nas

Na ka treguar Abdullah bin Jusufi, e atij Lejthi, i cili thotë se i ka treguar Ukajli, i cili transmeton nga Aisheja r.a., se Pejgamberi a.s. kur binte në shtrat, u frynte duarve dhe këndonte ajetet me të cilat kërkohet ndihma – mbrojtja (muavvedhat – dy kul-eudhat) dhe përshkonte trupin me duar.

Ebu Hurejra r.a. na tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur dikush prej jush dëshiron të bjerë me fjet, le ta shkundi dyshekun me skaj të çarçafit, sepse kush e di se çfarë ka prek aty pasi është ngritur ky, e mandej le të thotë: “O Zot, me emrin Tënd po e lëshoj trupin tim këtu dhe me emrin Tënd do të ngrihem. Nëse ma merr shpirtin, mëshiroje, po nëse nuk ma kthen përsëri, ruaje ashtu siç i ruan njerëzit e mirë.”⁴



1. Sahihu-l-Buhari në gjuhën shqipe nga F. Mehdiu 12. Hadithet: 6227-7563, Prishtinë 2015, fq.51. 2. Po aty. 3. Po aty. 4. Po aty.

Dr. Muhamed Kamal Isma'eel (1908-2008)

Historia e njeriut i cili e projektoi Qabenë e sotme në Mekë dhe Xhaminë e Pejgamberit a.s. në Medine

Ai ishte një inxhinier dhe arkitekt egjiptian që preferoi të ishte larg vëmendjes së publikut, i panjohur për shumë njerëz.

- Ai ishte personi më i ri në historinë e Egjiptit, që ka marrë certifikatë të shkollës së mesme, më i riu që u regjistrua në shkollën e parë Mbretërore të Inxhinierisë dhe më i riu që u diplomua prej saj, më i riu që u dërgua në Evropë për të marrë tri diploma doktoratash në Arkitekturën Islame. Ai ishte gjithashtu më i riu që mori shallin “Nili” dhe gradën “Hekuri” nga mbreti.
- Ai ishte inxhinieri i parë që ndërmori planifikimin dhe zbatimin e projektit të zgjerimit të xhamive (Haremajn) në Meke dhe Medine.
- Ai nuk pranoi të merrte asnjë pagesë për projektin e tij inxhinierik dhe mbikëqyrjen arkitek-



tonike, me gjithë përpjekjet e mbretit Fahad dhe Bin Laden Company. Kur ai ua ktheu një çek prej milionash, ai i tha Bakar bin Ladanit: “Pse duhet të pranohet para (për punën time) në dy xhamitë e shenjta, si do të përballim me Allahun (në Ditën e Gjykimit)?”

- Ai u martua në moshën 44-vjeçare, gruaja e tij lindi një djalë dhe vdiq. Dhe më pas ai nuk u martua dhe ia kushtoi kohën e tij të plotë adhurimit të Allahut derisa vdiq. Ai jetoi njëqind vjet, dhe ato i kaloi në shërbim

të dy xhamive të shenjta, larg vëmendjes, famës dhe parave të medias.

Ky gjeni ka një histori të mah-nitshme në lidhje me mermerin (punën) e haremit (xhamisë së shenjtit), pasi ka dashur të mbulojë haremin, dyshemenë e xhamisë për ata që bëjnë tavaf me mermer të veçant për ta thithur nxehtësinë. Ky mermer ishte i disponueshëm vetëm në një mal të vogël në Greqi. Udhëtoi në Greqi dhe nënshkroi një kontratë për blerjen e sasive të



mjaftueshme për harem (mermer); pothuajse gjysmën e malit.

Ai nënshkroi marrëveshjen dhe u kthye (në Mekë) dhe mermeri i bardhë erdhi (në magazinë). Dhe vërtet vendosja e mermerit në dyshemenë e xhamisë së shenjtë në Mekë përfundoi.

Pas 15 vjetësh, qeveria saudite i kërkoi atij që të vendoste një lloj mermeri të ngjashëm në xhaminë e shenjtë në Medine.

Inxhinieri Muhamed Kamal tha, kur mbreti i kërkoi të mbulonte xhaminë e Profetit me të njëjtin mermer, unë u hutova shumë, sepse kishte vetëm një vend në tokë për të marrë këtë lloj mermeri, ajo ishte Greqia, dhe unë tashmë kisha blerë gjysmën e tyre që kishin në dispozicion.

Kamal tha se ka shkuar në të njëjtën kompani në Greqi dhe ka takuar CEO-n dhe e ka pyetur për sasinë që ka mbetur. CEO tha se ishte shitur menjëherë pasi ishte larguar ai, 15 vjet më parë. Kamal u trishtua shumë. Kamal u largua nga takimi dhe duke u larguar nga zyra e tyre, takoi sekretaren e zyrës dhe i kërkoi asaj të tregonte vendndodhjen

e personit që bleu pjesën tjetër të sasisë së mermerit?

Ajo u përgjigj se do të ishte e vështirë të dihej nga një regjistrim kaq i vjetër. Me kërkesën e Kamal, ajo premtoi se do të kërkonte në regjistrimin e vjetër. Kamal i dha asaj adresën dhe numrin e hotelit dhe i premtoi se do ta vizitonte sërish ditën tjetër. Kamal tha se gjatë largimit nga zyra, ai mendoi: “Pse dua të di se kush e bleu (atë)? Duke u shprehur me veten time, Allahu do të bëjë të ndodhë diçka e mrekullueshme.”

Të nesërmen, pak orë para se të nisej për në aeroport, Kamal mori një telefonatë nga sekretarja që i thoshte se kishte gjetur adresën e blerësit. Kamal shkoi në zyrën e tyre me një ritëm të ngadaltë duke menduar se çfarë do të bëja me adresën e blerësit, pasi kishin kaluar shumë vite?

Kamal arriti te zyra dhe sekretarja i dha adresën e kompanisë që bleu pjesën tjetër të mermerit. Kamal tha se zemra e tij pulsoi dhe rrahu thellë në momentin kur zbuloi se kompania që bleu mermerin ishte një kompani saudite.

Kamal fluturoi për në Arabinë Saudite të njëjtën ditë dhe me të mbërritur, ai shkoi direkt në zyrën e kompanisë që bleu mermerin dhe takoi drejtorin dhe e pyeti se çfarë kishte bërë me mermerin që kishte blerë shumë vite më parë nga Greqia. Ai tha se nuk më kujtohet. Ai kontaktoi dhomën e depos (së kompanisë) dhe i pyeti për mermerin e bardhë nga Greqia dhe ata i thanë se e gjithë sasia është në dispozicion; nuk është përdorur kurrë.

Kamal filloi të qante si një foshnjë dhe më tej ia rrëfeu historinë e plotë pronarit të kompanisë. Kamal i dha pronarit një çek bosh dhe i kërkoi të shkruante shumën që dëshiron. Kur pronari e kuptoi se mermeri është për xhaminë e Pejgamberit a.s., ai tha se nuk do të pranojë as edhe një rial. Allahu më bëri ta blej këtë mermer dhe ta harrojë atë, sepse ai ishte menduar të përdorej për xhaminë e Pejgamberit a.s.¹

Përktheu dhe përshtati nga gjuha angleze:

Ma. Muzaqete Kosumi

1. <https://www.linkedin.com/pulse/man-who-designed-makkah-madina-masjids-akram-wasim>.

Dr. Mustafa Mahmud

Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve

Deti i politikës është i rrezikshëm. Protestuesi, i cili udhëheq turmën dhe bërtet, nuk e di se çfarë po bën dhe kujt i shërben.

Në pjesën më të madhe zbulohet se ai ka qenë i përdorur prej të tjerëve pa e ditur, dhe se ai ka qenë vegël shkatërruese duke menduar se po ndërtonte. Ka qenë ndihmës për shejtanin duke imagjinuar se ishte propagandues i së vërtetës.

Madje, fjalët që i shqiptonte me entuziazëm dhe pafajësi, në pjesën më të madhe zbulohet se ato nuk kishin qenë fjalët e tij, por mashtrim i dikujt tjetër, që i kanë vendosur në gojën e tij.

Gjendja e shteteve të vogla është bërë si shembulli i këtij protestuesi, ku ato në detin e politikës janë lodra të shteteve të mëdha. Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve dhe oktapodë interesash pas teatrove të parimeve.

Diplomacia është manipulim rrenash të bukura dhe aleancat janë interesa të përkohshme, pastaj ato këputen prej palëve sa herë që interesat ndryshojnë drejtim.

Tani zbulimi i së vërtetës është bërë më i vështirë se sa gjetja e gjilpërës në kashtë.

Shtetasit e thjeshtë dhe lexuesit e zakonshëm të gazetave janë njerëzit më të largët në të kuptuarit e asaj që ndodh poshtë këmbëve të tyre.

Mjetet e informacionit ia shpërlajnë trurin çdo ditë, lajmet e lajthisin në humbje, reklamat e shfrytëzojnë, kinemaja e tërheq në epshe dhe teatri ia mbyl kohën.

Punët janë përzier në çdo gjë, deri edhe te mjekrat. Kështu që shohim pyje me mjekra dhe nuk dihet se çfarë fshihet poshtë tyre...

Shtetasit e thjeshtë dhe lexuesit e zakonshëm të gazetave janë njerëzit më të largët në të kuptuarit e asaj që ndodh poshtë këmbëve të tyre.

Hoxhallarët kanë mjekra, këngëtarët e diskove kanë mjekra, filozofët kanë mjekra, komunistët kanë mjekra, drogaxhinjtë kanë mjekra...

Dhe me fjalët e Islamit bëjnë pazar besimtarët dhe jobesimtarët, të gjithë i lëshojnë në treg këto fjalë.

Përktheu: Lavdrim Hamja



PhD (C) Melihate Zeqiri

Filozofia e edukimit parashkollor

Njeriu si qenie njerëzore, nuk mund të jetojë i vetëm, ai mund ta vazhdojë jetesën vetëm brenda një grupi.

Studimet më të avancuara psikologjike e pedagogjike vërtetojnë se gjashtë vitet e para të jetës së fëmijës kanë ndikim të madh në formësimin e personalitetit të njeriut. Në synim që zhvillimi i fëmijës deri në gjashtë vjeç të jetë sa më i suksesshëm, njerëzit e profesionit e të shkencës bëjnë përpjekje ta ndërjegjësojnë shoqërinë për edukimi cilësor të fëmijëve parashkollor. Mirëpo, shkencat e ndryshme që studiojnë zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve nuk ofrojnë një të vetmen përgjigje universale në pyetjen: “çfarë duhet të jetë edukimi parashkollor cilësor?”.

Me qëllim që filozofia e edukimit parashkollor në Kosovë të jetë në hap me të arriturat shkencore, praktikat e përparuara dhe konform rrethanave specifike dhe synimeve të vendit, duhet t'i ngërthejë në një sistem të integruar, në një anë, këto të arritura dhe, në anën tjetër, përvojat pozitive vendore e të vendeve më të përparuara. Taban i filozofisë së edukimit parashkollor është qëndrimi se edukimi është proces që nisë me jetën e fëmijës dhe vazhdon gjatë gjithë moshës parashkollore, duke vazhduar në periodat pasuese jetësore.

Edukimi i fëmijëve të grupmoshës deri në tri vjeç dhe i grupmoshës deri në gjashtë vjeç, konsiston në zhvillimin e aspektit shëndetësor e fizik, emocional-ndjenjorë, mendor e social të tij. Nga se aspektet e personalitetit fillojnë të zhvillohen që në fëmijëri të hershme e vazhdojnë të zhvillohen në periodat pasuese

jetësore, mu për këtë nuk arsyetohet tendenca e anashkalimit të procesit edukativ në grupmoshën deri në tri vjeç dhe identifikimit të këtij procesi me kujdesin shëndetësor dhe mirëritjen e fëmijës. Kjo tendencë, nuk ka mbështetje shkencore andaj, si e dëmshme për fëmijën parashkollor, nuk bënë të jetësohet në praktikën edukative në Kosovë.

Një tjetër ide e filozofisë së edukimit parashkollor është respektimi i karakteristikave të përgjithshme të moshës së fëmijës parashkollor. Njëkohësisht afirmohet respektimi i dallimeve individuale midis fëmijëve me potencialin gjenetik të tyre, cilësinë dhe tempon e zhvillimit,

specifikave në të nxënit, nivelit dhe cilësisë së paranjohurive, shkathëtesive shprehive etj. Këto karakteristika janë fare individuale edhe nga arsyeja se i nxisin mikromjediset sociale të ndryshme në të cilat jeton dhe vepron fëmija, specifikat sociale dhe fizike në familje, ato në institucionet parashkollore shumë të ndryshme, mjedisi shoqërorë specifik i fëmijës, etj.

Filozofia e edukimit parashkollor afirmon idenë “Me fëmijën në qendër”, e cila bazohet në disa parime më themelore: Fëmijët përfitojnë njohuri, zotërojnë shkathtësi dhe shprehi të ndryshme, fitojnë përjetime nga ndërveprimet me botën që



i rrethon; Të rriturit (prindërit, edukatorët dhe të tjerët) nxisin rritjen dhe zhvillimin e gjithmbarshëm dhe aktiv të fëmijëve, duke vënë në bazë të punës mundësitë, interesat, nevojat dhe aftësitë e fëmijëve. Filozofia “Me fëmijën në qendër” mundëson pra, krijimin e kushteve për zgjimin e mundësive dhe për zhvillimin e potencialeve individual të fëmijëve në mënyrë aktive dhe manifestimin kreativ e maksimal të tyre. Nga kjo rezulton se edukimi parashkollor duhet t’u mundësojë fëmijëve shprehjen dhe zhvillimin aktiv të nevojave, interesave njohëse dhe të tjera, botës emocionale, aftësive të tyre, shkathhtësive të ndryshme dhe shprehive të shëndosha.

Loja aktive është veprimtaria më qenësore e fëmijëve të moshës parashkollore. Loja duhet t’u mundësojë fëmijëve t’i zhvillojnë aftësitë motorike e njohëse, pastaj duke bashkëvepruar me moshatarët, t’i kultivojnë shprehitë shoqërore dhe aftësitë sociale dhe, duke i zotëruar sfidat individuale e shoqërore, zhvillohen edhe në aspektin mendor, emocional dhe moral. Loja aktive dhe atraktive për fëmijën dhe grupin luan rol edhe në krijimin e atmosferës së përshtatshme për jetë të shëndoshë të fëmijëve parashkollorë, bashkëveprimin social.

Filozofia e edukimit parashkollor përshkohet me frymë demokratike dhe humane. Afirmon zhvillimin e lirë dhe emancipimin socio-kulturor të secilit fëmijë në çdo mjedis social në të cilin jeton fëmija. Kjo filozofi është e hapur për analizën, zgjedhjen dhe jetësimin e strategjive alternative të edukimit parashkollor dhe mundëson fleksibilitet të veprimeve edukative të të rriturve (prindërve, edukatorëve dhe të tjerëve).

Filozofia e edukimit parashkollor afirmon domosdoshmërinë e bashkëveprimit reciprok e të ngushtë të përbërësve brenda faktorëve edukativ (faktorëve brendapërbrenda familjes apo faktorëve brendapërbrenda institucionit parashkollor) dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm, por

Familja është institucioni themelor i përgatitjes së fëmijëve, i transmetimit të vlerave kulturore e morale, i traditave dhe zakoneve familjare, shoqërore dhe kombëtare.

(Şengün, 2003: 217).

gjithnjë duke i respektuar specifikat e edukatës familjare.

Fëmija dhe të rriturit duhet të kuptojnë se të nxënit është proces shumë kahor, gjatë të cilit fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri, mësojnë nga të rriturit, por edhe të rriturit mësojnë nga fëmijët. Ka, pra rrugë të ndryshme për t’u arritur një qëllim, dhe pikërisht për këtë duhet, jo të ju imponohen fëmijëve idetë apo zgjidhjet, por të inkurajohen të provojnë, të bëjnë diçka të re, dhe idetë e përvojën e tyre t’i këmbëjnë me të tjerët.

Një segment i pashmangshëm i filozofisë së edukimit parashkollor është mbështetja, përforcimi pozitiv i fëmijës, që nënkupton të qendëruarit në sjelljet e mira dhe tiparet pozitive të fëmijës, që si rrjedhojë ka dëshirën dhe angazhimin e fëmijës të bëhet i mirë.

Filozofia e edukimit parashkollor synon inkurajimin e zhvillimit tërësor të personalitetit të fëmijës, të nevojshëm për fëmijën që të sfidohet dhe t’i sfidojë ndryshimet të cilat sot zhvillohen me shpejtësi.¹

Qëllimet e edukimit parashkollor Zhvillimi tërësor i personalitetit të fëmijës, potencialit dhe shfaqjes maksimale të aftësive të tij.

• Zhvillimi dhe formësimi i individit të lirë, të përgjegjshëm, aktiv e ndërveprues.

• Zotërimi i aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese e ndërvepruese.

• Zhvillimi dhe përvetësimi i aftësive njohëse, afektive – emocionale, shoqërore, morale dhe psikomotorë.

• Respektimi i barazisë së shanseve edukative për të gjithë fëmijë.

• Fëmija i lumtur, i aftë për t’u përballur me sfidat e jetës.

Njeriu si qenie njerëzore, nuk mund të jetojë i vetëm, ai mund ta vazhdojë jetesën vetëm brenda një grupi. Me bashkimin e njerëzve formohen grupe, ndërsa me bashkimin e grupeve formohen shoqëritë. Në një situatë të tillë, shoqëria, për të përballuar nevojat e saj, bashkohet duke ndarë mes vetes një kulturë të përbashkët. Në rastet kur shumë njerëz bashkohen në një grupim marrëdhënia e tyre formon një rrjet. (Hunt, 1972: 20).

Në një kohë kur shkenca dhe teknologjia botërore përparojnë me shpejtësi, edhe shoqëria njerëzore po përjeton ndryshime të mëdha. Bashkë me një ndryshim të tillë, kombet e ndryshëm duhet t’u bëjnë ballë dhe zgjidhin probleme të shumta politike dhe morale. Nga këto probleme mund të përmendim: luftërat, urinë, armët kimike, shkeljet e të drejtave të njeriut, terrorizmin ndërkombëtar, gjenocidin, racizmin ekstrem, si dhe problemin gjithnjë në rritje të korrupsionit. (Sandin, 1992: 1).

Çdo fëmijë, sikurse fara, kur t’i vijë koha, do të çelë profilin e vetes në shërbim të familjes dhe shoqërisë. Për formimin e personalitetit dhe individualitetit të fëmijëve, roli dhe rëndësia e prindërve është e madhe. Edukimi i fëmijës nga prindërit është përgjegjësi e dorës së parë. Sipas Şengün, struktura e parë e mbrojtjes dhe kujdesjes për fëmijët, është familja. Ajo nuk është vetëm vendi i lindjes së tij, por edhe i rritjes, formimit dhe pjekurisë.

Ndër qëllimet e përgjithshme të edukimit moral është arritja e pjekurisë morale e individit.

(Güngör)

Familja është institucioni themelor i përgatitjes së fëmijëve, i transmetimit të vlerave kulturore e morale, i traditave dhe zakoneve familjare, shoqërore dhe kombëtare. (Şengün, 2003: 217).

Sipas *Kaya*, familja është autoriteti i parë dhe i vetëm në procesin e zhvillimit të mirë të fëmijëve, sidomos gjatë viteve të para të fëmijërisë, ku atij i transmetohen vlera morale. Fëmijës duhet t'i jepet shembull model, me anë të cilit të dallojë sjelljen e kulturuar e të saktë. Babai duke u bërë disiplinori e vendimmarrësi, ndërsa nëna individi që luan rolin pajtues e përfshirës në marrëdhëniet midis individëve. Kështu që fëmija me anë të shembullit prindëror miraton dhe përvetëson vlerat e shëndosha morale që i përkasin familjes së tij e i demonstroi ato në shoqëri. (Kaya, 1993: 24).

Sipas *Gündüz*, fëmija shpërfaq në mënyrë të plotë ndikimin e familjes së tij në të gjitha rolet e saj, përgjatë zhvillimit të personalitetit në shkollë, sidomos në vitet e para të edukimit, për shkak të formimit të individualitetit dhe personalitetit, brezat e kësaj periudhe janë shumë delikatë. Prandaj duhet kujdes, durim dhe përkushtim, me qëllim plotësimin e vlerave të larta morale familjare, shoqërore dhe kombëtare. (Gündüz, 2003: 195).

Sipas *Kaya*, edukimi formal që jepet nëpër shkollë, për përgatitjen e individit për shoqërinë, vepron në

përputhje me objektivat e caktuara. Njerëzit, thekson ai, duhen rritur me vlerat kombëtare, morale, njerëzore dhe kulturore. Qëllimi është të mirërriten si njerëz të ekuilibruar nga ana emocionale, morale, mendore dhe trupore. Kështu që roli i edukimit në shkollë dhe qëllimi i përgjithshëm i edukimit moral zë një vend të rëndësishëm. (Kaya, 1993: 24).

Ndërkohë që sipas *Güngör*, ndër qëllimet e përgjithshme të edukimit moral është arritja e pjekurisë morale e individit. Qëllimi i edukimit moral në shkollë është të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë për shëkullin e zhvillimit, duke u fshirë atyre të gjitha ndikimet negative jashtë shkolle, t'i përgatitë ata të bëhen anëtarë të mirë dhe të denjë të shoqërisë. (Güngör, 1998: 46).

Sipas *Aydın*, morali nuk duhet të mbetet vetëm teorik, praktika e tij është e rëndësishme për jetën, ajo mund të përforcohet me aktivitete humane. Ashtu si njeriu, nëse nuk ndjek një vizatim sipas ngjyrave që beson, edhe morali mbetet thjesht një sistem e jo bindje. Në këtë situatë, kur morali individual, shoqëria dhe familja nuk ndikon, roli i një moralizuesi teorik gjithashtu nuk kryen punë. Edukimi moral është procesi i rritjes së individit gjatë të cilit nuk duhet të hiqet kurrsesi dorë nga sjelljet e drejta pasi i përfiton ato. Një komb që dëshiron të garantojë gjeneratën e ardhshme, duhet të luftojë të rrisë një brez të respektueshëm ndaj vlerave morale. Edukimi moral i brezit të ri duhet të jetë një nga qëllimet më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore. (Aydın, 2003: 50).

Bashkëjetesa e nënës dhe babait (familja e shëndoshë)

Çdo fëmijë vjen në këtë botë i pajisur me aftësi të caktuara dhe familja luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tij. Koha më e mirë për të edukuar fëmijën janë vitet e fëmijërisë, kur formohet pjesa më e madhe e karakterit. Vendi më i mirë është familja dhe edukuesit më të mirë janë nëna dhe babai. Familja është vendi ku fillon komunikimi dhe zhvillimi social. Bashkë me zhvillimin social mësohet gjuha dhe transmetimi te brezi tjetër i rregullave morale dhe vlerave tradicionale. Këto realizohen vetëm në një familje të shëndoshë. Fëmijët e rritur e të edukuar në një ambient ku prindërit jetojnë së bashku dhe i përshtaten njëri-tjetrit zënë vend në shoqëri si individë të pavarur. Në një studim të realizuar mbi të rinj të burgosur është vënë re se 70% prej tyre vijnë nga familje të ndara, të cilët janë rritur të ndarë për arsye të ndryshme. Bazuar në këtë përfundim mund të themi, se bashkëjetesa harmonike e prindërve dhe mbështetja e familjes në themele të shëndosha, mundëson rritjen e fëmijës në mënyrën më ideale dhe fitimin e sjelljeve të dëshiruara. (Menderes, 2005: 135).

Niveli arsimor i nënës dhe i babait

Sigurisht që edhe ambienti përreth luan një rol shumë të rëndësishëm në pasqyrimin e vlerave morale të fëmijës. Fëmija ka nevojë për një model të një nëne dhe babai të arsimuar dhe të informuar për të realizuar një zhvillim sa më të shëndetshëm. Para se fëmija të arrijë periudhën e përcaktimit të vlerave në mënyrë të vetëdijshme, pranon sjelljet dhe shpjegimet e prindërve. Këtu duhet të nënvizojmë rëndësinë e nivelit arsimor të prindërve në zhvillimin e paragjykimëve morale të fëmijës dhe në shndërrimin e tyre në gjykim. Niveli arsimor i prindërve është i rëndësishëm në përcaktimin e vlerave morale të fëmijës që do të



zhvillojë më pas. Prandaj niveli i tyre arsimor duhet të jetë i mjaftueshëm për ta realizuar këtë. (Acuner, 2004: 110).

Vendi ku jeton dhe qyteti nga vjen - Veçoritë shoqërore, ekonomike, kulturore të familjes janë faktorë shumë të rëndësishëm të cilët ndikojnë në zhvillimin fizik dhe social të fëmijës. Faktorë si feja e nënës dhe babait, moshja, zgjuarsia, të ardhurat, vendi ku jeton, qëndrimi i familjes dhe pritshmëritë, veçoritë e shtëpisë ku jeton, largësia e shtëpisë nga shkolla, librat në shtëpi etj., pra, secili prej tyre janë faktorë efektivë në suksesin dhe edukimin e fëmijës. Veçoritë etnike të vendit ku jeton fëmija, veçoritë shoqërore e ekonomike të ambientit, përjashtimi shoqëror i lagjes ku jeton, ndikojnë në vlerat morale dhe qëndrimet e fëmijës. (Richards, 1986: 128).

Qëndrimi i prindërve ndaj fëmijës

Qëndrimi i nënës dhe babait ndaj fëmijës ndikon në formimin e

personalitetit të fëmijës duke krijuar efekte pozitive ose negative në mësimin e ndjenjave dhe sjelljeve. Në të njëjtën kohë qëndrimet e nënës dhe babait ndikojnë edhe te sukcesi akademik i fëmijës. Studimet e realizuara flasin për lidhjen e fortë mes qëndrimit të prindërve dhe përshtatshmërisë sociale dhe individuale të fëmijës. Ndërkohë që marrëdhënia e krijuar me prindërit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, për fat të keq prindërit nuk kanë një politikë të matur dhe të shëndetshme në sjelljen ndaj fëmijës. Nëse prindërit njohin cilësitë e sjelljes dhe informohen rreth tyre mund të luajnë një rol më efektiv në fitimin e vlerave pozitive nga ana e fëmijës. Megjithatë klasifikimi i këtyre qëndrimeve mund të pasqyrojë qëndrimet kryesore, të cilët janë: qëndrimi autoritar, qëndrimi i pavendosur, qëndrimi demokratik, qëndrimi mbrojtës, qëndrimi i pa interesuar dhe qëndrimi indiferent. (Ersanlı, 1986: 57).

Gjendja ekonomike e familjes - Profesionin e nënës dhe babait, të ardhurat dhe niveli ekonomik janë faktorë që përcaktojnë nivelin socio-ekonomik. Veçanërisht gjendja social-ekonomike brenda të cilit gjendet individin ndikon në zhvillimin dhe sjelljet e fëmijës. Niveli i lartë ekonomik i familjes ndikon në ndryshimin e formës së shikimit të ngjarjeve dhe te disa familje sjell lehtësira dhe efekte pozitive në edukimin e fëmijës duke krijuar një atmosferë më pozitive. Fëmijët të cilët janë pjesë e familjeve me një nivel të lartë ekonomik zotërojnë më shumë mundësi dhe si rrjedhojë mund të ngrihen më lart në edukimin dhe zhvillimin moral. Fëmijët e familjeve të tilla nuk arrijnë të shpalesin aftësitë e tyre për shkak të mungesës së kushteve. (Tural, 2002: 35).

1. kurrikula-e-edukimit-parashkollor-ne-kosove-3-6-vjec_1.pdf; f. 6.

Vizita e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë në Kuvajt

Me ftesë të Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Islame të Kuvajtit, nga data 18 deri më 23 qershor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti, qëndruan për vizitë punë disaditore në shtetin e Kuvajtit. Gjatë vizitës, Myftiu Tërnavë zhvilloi disa takime në institucione të ndryshme në shtetin e Kuvajtit.

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga zëvendësministri i Kuvajtit, z. Ferid Imadi

Më 22 qershor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë u prit në takim në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Kuvajtit nga zëvendësministri Ferid Imadi, të cilin Myftiu e njohu me veprimtarinë, sfidat, aktivitetet dhe projektet e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnavë e falënderoi Qeverinë e Kuvajtit, si dhe popullin e tij për ndihmat dhe përkrahjen e ofruar për shtetin e Kosovës në fusha të ndryshme. Ai gjithashtu e njohu zëvendësministrin edhe me arritjet që janë bërë në fushën e vakëfeve që nga përfundimi i luftës e tutje.

Zëvendësministri Imadi dhe Myftiu Tërnavë u pajtuan që në të ardhmen të thellohet bashkëpunimi në fusha të ndryshme në interes të përbashkët të të dyja vendeve.

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga z. Muhamed Al-Mutairi

Gjatë qëndrimit në Kuvajt, Myftiu Tërnavë, më 22 qershor, zhvilloi një takim me ndihmës zëvendësministrin për sektorin e mediave dhe marrëdhënieve të jashtme në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Islame të Kuvajtit z. Muhamed Al-Mutairi.

Nikoqiri falënderoi Myftiun për vizitën, duke theksuar gatishmërinë e Ministrisë për të mbështetur organe të ndryshme islame, bazuar në



Myftiu në takimi me zëvendësministrin e Kuvajtit, z. Ferid Imadi

strategjinë dhe vizionin e Ministrisë për udhëheqje dhe përsosmëri në punën islame. Ai gjithashtu falënderoi Myftiun Tërnavë për punën dhe aktivitetin e BIK-ut në kultivimin e tolerancës dhe bashkëjetesës në Kosovë.

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga z. Rumi Matar Ar-Rumi

Më 22 qershor, Myftiu Tërnavë zhvilloi një takim zyrtar me z. Rumi Matar Ar-Rumi, drejtor i Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë pranë Ministrisë së Vakëfeve. Gjatë



Myftiu në takimi me z. Muhamed Al-Mutairi



Myftiu në takimi me z.Rumi Matar Ar-Rumi

takimit u bisedua për bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe për mundësitë e thellimit të këtij bashkëpunimi në fushat e edukimit fetar dhe kulturor.

Nikoqiri e njohu Myftiun për veprimtarinë dhe përgjegjësitë e De-partamentit që ai drejton, i cili është kyç në mbarëvajtjen e marrëdhënieve me institucionet fetare jashtë Kuvajtit.

Vizita në Sekretariatin e

Myftiu Tërnavë falënderoi nikoqirin për mikpritjen dhe gjithashtu për financimin e disa projekteve të BIK-ut në të kaluarën. Gjithashtu Myftiu Tërnavë paraqiti disa projekte vakëfnore vitale për BIK-un, duke kërkuar mundësinë e financimit dhe përkrahjes së tyre nga Sekretariati i Përgjithshëm i Vakëfeve.

Nikoqiri falënderoi Myftiun për këtë vizitë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Gjatë takimit me

u diskutua për mënyrat e zhvillimit dhe mbështetjes së marrëdhënieve dypalëshe në fushën e vakëfeve, në fushën e studimeve, hulumtimeve dhe kërkimeve në lidhje me çështjet e dhurimit të vakëfeve. Të dyja palët u pajtuan për thellim të bashkëpunimit në rritjen e infrastrukturës vakëfnore të BIK-ut.

Vizita në Shoqatën “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”

Kryetari i Shoqatës së Rilindjes së Trashëgimisë Islame, dr. Tarik Al-Issa, më 19 qershor, priti në takim Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavën dhe delegacionin e tij shoqëruar.

Myftiu falënderoi Kuvajtin dhe popullin e tij, si dhe Shoqatën për Ringjalljen e Trashëgimisë Islame në veçanti, për përpjekjet e saj në fushën e punës humanitare dhe kulturore. Ai gjithashtu kërkoi përkrahje në zgjerimin e infrastrukturës së BIK-ut.

Nga ana e tij, nikoqiri dr. Tarik Al-Isa, falënderoi Myftiun për vizitën dhe çmoi lart angazhimin e BIK-ut për mbarëvajtjen e jetës fetare të myslimanëve në Kosovë. Gjithashtu ai vlerësoi lart kontributin e popullatës së Kosovës në ruajtjen e bashkëjetesës dhe tolerancës fetare.

Vizita në IICO

Më 23 qershor, Myftiu Tërnavë vizitoi Organizatën Humanitare Botërore IICO. Organizata Ndërkombëtare e Bamirësisë Islame (IICO) është një nga organizatat më të mëdha humanitare në botën myslimane. Është një organizatë bamirëse e pavarur, shumëpalëshe që ofron shërbimet e saj humanitare për ata që kanë nevojë në botë, pa diskriminim dhe larg ndërhyrjeve në politikë apo konflikte etnike.

Aty Myftiu u prit nga UD drejtori i Përgjithshëm z. Abdurahman Al-Mutava. Në këtë takim u bisedua për thellim të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve si dhe përkrahje të projekteve të BIK-ut.

Vlen të theksohet se kjo organizatë në të kaluarën ka ndihmuar popullin e Kosovës në fusha të ndryshme.



Myftiu në takimi me UD sekretarin e Përgjithshëm të Vakëfe z. Mensur As-Sakaabi

Përgjithshëm të Vakëfeve

Gjatë qëndrimit në Kuvajt, Myftiu Tërnavë, më 20 qershor, vizitoi Sekretariatin e Përgjithshëm të Vakëfeve të shtetit të Kuvajtit, institucioni ky i cili kujdeset për menaxhimin e Vakëfeve në Kuvajt. Aty Myftiu u prit nga UD sekretari i Përgjithshëm z. Mensur As-Sakaabi.

delegacionin kosovar, z. As-Sakabi pohoi gatishmërinë e Sekretariatit të Përgjithshëm të Vakëfeve - si përfaqësues i shtetit që koordinon përpjekjet e vendeve islame në fushën e vakëfeve - për të ndërtuar një partneritet me institucionet ndërkombëtare dhe me institucionet e bamirësisë për arritjen e qëllimeve të dëshiruara. Gjithashtu gjatë takimit

Vizita në Shoqatën “Rahma International”

Më 19 qershor, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë dhe delegacioni që e shoqëroi atë, në margjinat e vizitës së tij në Kuvajt, vizitoi shoqatën “Rahma International”. Aty delegacioni kosovar u prit nga drejtori gjeneral dr. Isa Al-Dhufejri, ku u diskutua mbi aktivitetet bamirëse nga “Rahma International” në Kosovë.

Myftiu falënderoi udhëheqësit e Shoqatës për kontributin e tyre dhe për ndihmat e ofruara popullit të Kosovës në të kaluarën, si dhe kërkoi angazhim dhe përkrahje edhe me të madhe në të ardhmen.

Vlen të theksohet se kjo shoqatë ka ndërtuar lagjen e banimit në



Myftiu në takim me drejtorin gjeneral dr. Isa Al-Dhufejri

qytetin e Podujevës për popullatën në nevojë. Gjithashtu ka ndihmuar

në shumë projekte sociale dhe shëndetësore. *(Besim Mehmeti)*

Myftiu Tërnavë priti në takim një delegacion nga shoqata UMAD e Turqisë



Më 9 qershor, një delegacioni i Shoqatës Ndërkombëtare të Ulemave Mysliman (UMAD) nga Turqia, i kryesuar nga prof. dr. Abdulvehab Ekinxhi, vizituan selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, ku u pritën nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë.

Pasi i dëshiroi mirëseardhje dhe i falënderoi për vizitën, Myftiu u shpreh se është kënaqësi për ne si BIK që kemi një delegacion kaq të lartë nga shoqata UMAD. Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me historikun dhe organizimin e institucionit të BIK-ut, jetës fetare, sfidat me të cilat po ballafaqohet BIK-u, si dhe shprehu konsideratën e tij ndaj përkrahjes së

Turqisë, ambasadës turke në Prishtinë, Dijanetit, TIKÀ-së dhe shoqatave turke që veprojnë në Kosovë, si dhe shprehu falënderim të veçantë për qeverinë dhe popullin turk, të cilët vazhdimisht kanë mbështetur Kosovën në situatat më të vështira, e po ashtu vazhdojnë edhe më tej ta ndihmojnë për integritet në mekanizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë. Një falënderim të veçantë ia adresoi edhe për Dijanetin që po mundëson ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë dhe gjithë përkrahjen deri tani në të gjitha etapat.

Nga ana e tij, kryetari i i shoqatës “UMAD”, prof. dr. Abdulvehab Ekinxhi, falënderoi Myftiun Tërnavë

për pritjen dhe tha se ndjehet i kënaqur që sot gjendet për vizitë në Kosovë. Ai më pas e njohu Myftiun Tërnavë mbi misionin dhe vizionin Shoqatës Ndërkombëtare të Ulemave Mysliman “UMAD”. Ai u shpreh i impresionuar me të arriturat e BIK-ut, jetën fetare dhe kulturore në Kosovës. Ai tha se ne nuk kemi ndarje të kufijve shpirtëror edhe pse kemi ndarje gjeografike, të ndihmohemi në devotshmëri e bamirësi dhe në të mirë të dy popujve.

Më pas u bisedua për bashkëpunimin e ndërsjellë në të mirë dy popujve. Në fund në shenjë mirënjohje u shkëmbyen dhuratat. *(R.S.)*

Myftiu Tërnavë nderohet me mirënjohje për kontributin e tij arsimor në Kosovë në vitet 90-ta



Më 12 qershor, për nder të Ditës së Çlirimit të Prishtinës, kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka ndarë mirënjohje për kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë për kontributin dhe rolin e tij në arsim dhënë në vitet 90-ta. Kjo mirënjohje u dha me rastin e shënimit të 30 vjetorit që nga fillimi i operimit të ashtuquajturave “Shtëpi Shkolla”, të cilat luajtën rol jashtëzakonisht të madh, për ta mbajtur gjallë arsimin shqip, e për ta përforuar rezistencën kundër okupimit, duke shërbyer kështu si vatra të dijes dhe si një dritare e shpresës për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë.

Gjatë kohës sa Myftiu Tërnavë ishte drejtor i Medresesë së Mesme

“Alauddin” në Prishtinë, në ambientet e kësaj shkolle u mbajt Kongresi i Dytë i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Kuvendi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kur ishte kriza më e madhe e sigurimit të lokaleve nga ndjekjet e regjimit okupues serb. Amfiteatri i Medresesë ishte arenë e ngjarjeve tona fetare, kulturore e shkencore. Medreseja përkrahu minatorët kosovarë më 1989 dhe u ofroi ndihmat e para materiale, mori pjesë në grevën e organizuar nga studentët e Universitetit të Prishtinës më 1989. Në Medrese u themelua Shoqata e Arsimitarëve të Shkollave të Mesme të Kosovës - LASH “Naim Frashër”. Vetëm brenda vitit 1996, në ambientet e Medresesë “Alaudin” u mbajtën

mbi 25 manifestime kulturore, shkencore e politike, si: tubimi i arsimtarëve veteranë, tubime me karakter etik, sikur ishte ai për ndalimin e narkomanisë, shënime përvjetorësh si ai për 80-vjetorin e rënies së Isa Boletinit, takime të forumeve partiake, si të LDK-së e të partive të tjera, programe kulturore etj.

Dihet se 30 vjet më parë, Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” e organizuar në degë dhe nëndegë mori përgjegjësinë historike për kryerjen e detyrave arsimore dhe të organizimit të procesit mësimor në të gjitha nivelet e shkollimit, në rrethanat e pushtimit të egër serb, në periudhën 1990-1999. (R.S.)

U hap muzeu i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve në Bubavec



Më 15 qershor, me vendim të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, është hapur Muzeu i

Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve në Bubavec - 32 vjet pas organizimit të asaj që njihet si “Kuvendi i Buba-

vecit”, ku shërbeu për pajtimin më shumë se 40 gjaqeve.

Imamë të shumtë dhe veprimtarë të tjerë kontribuuan në pajtimin e ngatërresave të asaj kohe, me ç’rast në ditën e Bajramit të vitit 1990 ishte shtrirë dora e pajtimit, ku në krye të kësaj ngjarje ishte imami i fshatit, Xhevat Kryeziu.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se hapja e këtij muzeut është e rëndësishë së veçantë, si asaj kombëtare ashtu edhe asaj historike, teksa veçoi rolin e imamit të fshatit. “Kjo ngjarje e sotshme është e veçante

edhe për arsyen se po ndodh në një përvjetor të veçantë. Ai përkon me 32-vjetorin e fillimit të aksionit të madh për pajtimin e familjeve shqiptare në hasmëri, i cili aksion shumë shpejtë u shndërrua në një Lëvizje gjithëkombëtare, në dinamikën e së cilës u përfshinë të gjithë shqiptarët, duke u besuar dhe duke i falur hasmëritë e ngatërresat dhe duke u pajtuar e duke u bashkuar gjithandëj ku jetonin, brenda trojeve etnike dhe në mërkatë. Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve pati sukses edhe për faktin se asaj i prinë njerëz të ndershëm e veprimtarë të shquar e të dëshmuar,

duke filluar nga studentët, bota akademike dhe prijësit tonë fetarë, përmendja e të cilëve do të shkonte shumë gjatë dhe mundësia për të harruar ndonjë është shumë e madhe. Por më lejoni të konstatoj se kontributi i gjithë këtyre veprimtarëve e aktivistëve është i pamohueshëm, është historik. Kësaj Lëvizjeje iu bashkuan dhe i prinë edhe shumë hoxhallarë e ulema. Në mesin e tyre ndër të parët dhe më aktivët në këtë Lëvizje ishte padyshim edhe bashkëfshatari dhe imami juaj e kolegu ynë, Mulla Xhevat efendi Kryeziu” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, tha se me anë të këtij muzeu do të vendosën vlerat tona kombëtare dhe të pajtimin të gjaqeve.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe dom Lush Gjergji, i cili tha se me Kuvendin e Bubavecit u kuptua që urrejtja është armiku më i madh i popullit shqiptar.

Më 26 prill të vitit 1990 në ditën e Bajramit në prezencë të mbi 20 mijë personave, në xhaminë e fshatit Bubavec u falën mbi 40 gjaqe dhe shumë ngatërresa të tjera.

Kryesia e Bashkësisë Islame mbajti mbledhjen e radhës

Më 16 qershor, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës, të cilën e kryesoi kryetari, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Fillimisht Myftiu Tërnavë shprehu falënderimin e tij për gjithë anëtarët e Kryesisë, si dhe për të gjithë punëtorët e BIK-ut për kontributin dhe mundin që janë duke dhënë në shërbim të ngritjes së fjalës së Allahut xh.sh.. Ai tha se kjo është një përgjegjësi që e kemi marrë mbi supet tona, andaj duhet të tregohemi të matur për këtë amanet, por edhe të guximshëm bazuar në përgjegjësinë tonë që kemi si para Zotit ashtu edhe para besimtarëve tanë.



Kryesia në këtë mbledhje, në rend të ditës pati shqyrtimin e raportit mbi aktivitetin gjatë muajit Ramazan 2022, shqyrtimin e raportit mbi zekatin dhe Sadekatul-

fitrin për këtë vit, parapërgatitjet për Haxhin 2022, si dhe shqyrtoi lëndë të ndryshme dhe mori vendime nga kompetencat e Kryesisë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim ambasadorin e Arabisë Saudite, Feisal Ghazi Ismail

Më 27 qershor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Arabisë Saudite, Feisal Ghazi Ismail.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e njohu atë me punët, angazhimet dhe sfidat me të cilat përballet institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai edhe njëherë shprehu falënderimet e tij për përkrahjen dhe ndihmat e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Arabisë Saudite për



popullin e Kosovës. Myftiu shprehu gatishmërinë e institucionit të BIK-ut që të vazhdojë edhe më tej bashkëpunimin e mirë ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës së Arabisë Saudite.

Nga ana e tij, ambasadori Feisal Ghazi Ismail, shprehu falënderimet e tij për mikpritjen dhe për gatishmërinë e BIK-ut që të vazhdojë bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës së Arabisë

Saudite. Ai edhe njëherë çmoi lart kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës për promovimin e vlerave qytetare në vend dhe për harmoninë fetare e cila ekziston në Kosovë.

Myftiu Tërnavë vizitoi banorët e shtëpisë së të moshuarve në Suharekë

Më 29 qershor, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar shtëpinë e të moshuarve në Gjinoc të Suharekës, ku u mirëprit nga kryetari i Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, Halil Kastrati, si dhe nga banorët e kësaj shtëpie.

Të lumtur dhe të gëzuar për këtë vizitë të Myftiut Tërnavë, u panë banorët e kësaj shtëpie.

“Faleminderit shumë që ke ardhur me na pa e me na vizituar, po edhe për fjalët e mira që i the. Zoti të shpërbleftë e të ruajt se këtu shumë mirë e kalojmë se kujdesën për neve.”

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë u shpreh i gëzuar që po i viziton banorët e kësaj shtëpie në kushte kaq të volitshme. Ai u shpreh i kënaqur me ndihmën që po u ofrohet këtyre banorëve që kanë mbetur pa përkujdesje.

“Përkujdesja ndaj atyre që janë të shtyrë në moshë dhe pa një përkujdesje të bollshme është diçka



e veçantë. Mua më gëzon fakti që është bërë një punë shumë e madhe dhe kanë gjetur strehim një numër i konsiderueshëm i atyre të cilët janë në nevojë. Kushtet vërtet janë të mira, ideale për të jetuar këtu me të gjitha ato çfarë i nevojitet një njeriu.”

Kryetari i kësaj shoqate, Halil Kastrati, u shpreh falënderues ndaj Myftiut Tërnavë për këshillat si për vizitën, që i bëri të ndihem mirë jo vetëm banorët e shtëpisë, por edhe stafin.

“Nder për neve me e pas në vizitë Myftiun e Kosovës së bashku me stafin e tij. Në emrin tim, të staftit, por edhe të banorëve falënderoj jashtëzakonisht shumë dhe besoj që këshillat e tij ishin shumë të dobishme për neve, por edhe për banorët”, tha Kastrati.

Myftiu Tërnavë gjatë kësaj vizite pa për së afërmi kushtet e mira që jetojnë banorët e kësaj shtëpie, por njëkohësisht i përgëzoi për punën që kanë bërë, duke u ofruar mbështetje kësaj shoqate.

U mbajt Tryeza shkencore “Sali ef. Myftija, personalitet i shquar fetar dhe kombëtar”

Më 30 qershor, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, ka organizuar Tryezën shkencore kushtuar personalitetit fetar dhe kombëtar, Sali ef. Myftisë.

Në këtë tryezë u shtjelluan disa prej veprave të Salih Myftisë në çështjet fetare dhe kombëtare, si dhe kontributi i tij i pashoqë dedikuar dijes fetare dhe unitetit shqiptar.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Sabri ef. Bajgora, duke çmuar lart veprën e Sali Myftiut, përmendi dorëshkrimet e tij që lidhen me librat e

tefsirit, fikut, historisë islame, akaidit, fraksioneve islame dhe ngjarjeve të rëndësishme pas luftës së dytë botërore.

“S’ka dyshim se Sali ef. Myftija meriton edhe më shumë se një tryezë shkencore, le të jetë kjo e nismë e mbarë që figurën e këtij fetari dhe atdhetari të devotshëm ta trajtojmë gjerësisht në ndonjë eveniment edhe më të madh në Kosovë apo Shqipëri”, tha ai.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, veçoi Sali Myftiun si personalitet i cili nuk rreshti së punuari asnjëherë

për idealin fetar dhe kombëtar në të mirë të popullit.

“E përgëzoj Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame që ka ndërmarrë këtë hap për ta kujtuar dhe për në e risjellë në vëmendje personalitetin e Sali ef. Myftisë, i cili është shembull i një prijësi të dalluar si në rrafshin kombëtar ashtu edhe atë në fetar. Shembulli i një njeriu i cili tërë qenien e tij e vuri në shërbim të besimtarëve mysliman, të popullit dhe atdheut të tij. Ai u dëshmuar si arsimdashës i paepur, si udhëheqës e myfti i shquar, e mbi të gjitha si



atdhetar me veti të larta shtetformuese”, tha Myftiu Tërnavë.

Muhamed ef. Syrtari, Myftiu i Shkodrës, në këtë tryezë tha se sfidat dhe jeta e Sali Myftisë, ngjasojnë me burrat e parë të fesë islame, i cili angazhimin fetar e rriti në vazhdimësi.

“Largimet e shpeshta të tij, pra edhe furtunat e jetës së tij, sprovat e jetës së tij, herë në një vend herë në një tjetër, nxjerrin në pah personalitetin e burrit të shquar që më ngjan me ata burrat e parë të Islamit të cilët emigruan në drejtim të Etiopisë, për të përparë edhe dëshmuar në veprën e tij, atë që thonë, që të mëdhenjtë nuk përku-fizohen me tokën dhe kohën.”

Në ndërkohë edhe mbesa e Myftisë, u shpreh falënderuese për vlerësimin e lartë që po i bëhet gjyshit të saj.

“Ne jemi shumë krenarë që së pari kemi mbiemrin Myftija, jemi krenar që jemi trashëgimtarë të një figure me vlera të larta njerëzore, të

një figure që kishte një besim të devotshëm dhe të fortë në Allahun një dhe në dashurinë për atdheun e tij,”- tha ajo.

Në nder të kësaj tryeze shkencore, telegram urimi përcolli Princi Leka i Dytë, i cili falënderoi Institutin dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për këtë vlerësim dhe organizim në nderim të veprës së Salih Myftisë.

Sali Myftija në vitin 1931 ishte emëruar kryemyfti i Shkodrës, ndërsa më pas edhe i Kosovës.

Përgjatë okupimit fashist, ai kishte organizuar rezistencën nacionaliste shqiptare në kërkim të lirisë, për ta bërë kështu të lëvizte nga një vend në një vend tjetër, deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ai kishte qenë iniciatori i ngritjes së xhamisë dhe shkollës arsimore e fetare në SHBA për shqiptarët, duke bërë kështu që të dekorohet edhe me Dekoraten “Kordoni i Madh i Skënderbeut”.



Myftiu Tërnavë priti në takim udhëheqësen e Zyrës ndërlidhëse të Greqisë, ambasadoren znj. Heleni Vakali

Më 5 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim udhëheqësen e Zyrës ndërlidhëse të Greqisë, ambasadoren znj. Heleni Vakali. Myftiu Tërnavë e njohu mysafiren me historikun, punët dhe aktivitetet që i zhvillon institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai tha se BIK-u vazhdimisht ka luajtur një rol kyç në mbarëvajtjen e tolerancës dhe



harmonisë ndërfitare në vend. Myftiu Tërnavë kërkoj nga ambasadorja Vakali një angazhim më permanent për njohjen sa më parë të pavarësisë së Kosovës nga shteti i Greqisë.

Nga ana e saj, ambasadorja znj. Vakali, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për angazhimin e tij dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës që në Kosovë të mbretërojë një frymë paqeje e harmonie ndërmjet

qytetarëve të vendit pa dallim feje a kombësie. Meqë jemi në prag të festës së Kurban-Bajramit, ambasadorja Vakali uroi Myftiun Tërnavë dhe gjithë besimtarët myslimanë për këtë festë.

Myftiu Tërnavë priti në takim znj. Ilirjana Zymberaj

Më 5 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtoreshën e Drejtorisë së Inspektoratit në AVUK, znj. Ilirjana Zymberajn. Myftiu Tërnavë shprehu falënderimet e tij për mbështetjen e vazhdueshme të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AVUK) për menaxhimin e procesit të therjes së kurbaneve. Edhe znj. Zymberaj u shpreh e kënaqur me bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet AVUK-ut dhe BIK-ut, si dhe shprehu gatishmërinë që ky bashkëpunim i mirë të vazhdojë edhe më tej. Bashkësia Islame e



Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës bëjnë apel te të gjithë qytetarët e Kosovës të cilën duan të

therin kurban, që këtë ta bëjnë sipas kushteve dhe rregullave të parapara nga AVUK.

Myftiu Tërnavë mori pjesë në hapjen e ekspozitës me fotografi nga konkursi “Xhamitë e Kosovës”

Më 7 korrik, në oborrin e xhamisë “Jashar Pasha” në Prishtinë është hapur ekspozita me fotografi nga konkursi i quajtur “Xhamitë e Kosovës” i organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës për gjatë gjithë vitit të kaluar. Mbi 200 persona u bënë pjesë e këtij konkursi për të shpalosur vlerat kulturore e fetare nga arkitektura Islame e Kosovës. Në hapjen e kësaj ekspozite mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cilit tha se xhamitë janë qendra shpirtërore e besimtarëve myslimanë e që përgjatë historisë është shfrytëzuar si objekt fetare, për arsimim dhe për zgjidhjen e problemeve shoqërore. Iniciatori i këtij konkursit me “Xhamitë e Kosovës”, Bashkim Mehani tha se kjo iniciativë është pritë jashtë-zakonisht mirë nga të gjithë dhe se ka kërkesa të përfshihen edhe xhamitë jashtë Kosovës në kon-



kursin e ardhshëm. Ardian Gashi njëri prej tre fituesve të vendit të parë thotë se një iniciativë e tillë ka qenë e duhura dhe e domosdoshme për të paraqitur vlerat fetare nga arkitektura islame e Kosovës. Në fund tre fituesve të parë, Myftiu Tërnavë iu shpërndau edhe mirë-

njohje në shenjë falënderimi për pasqyrimin e xhamive të Kosovës. Ky konkurs për fotografi pritet të organizohet edhe në vitet në vazhdim, ku do të përfshihen edhe xhamitë dhe monumentet tjera islame nga mbarë trojet shqiptare dhe diaspora.

Myftiu Tërnavë priti në takim këshilltarin për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bunyamin Albayrak



Më 7 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim këshilltarin për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bunyamin Albayrak. Myftiu Tërnavë i dëshiroi mirëseardhje, duke i uruar sukses dhe shëndet në detyrën re. Ai më pas shprehu falënderime për bashkëpunimin e sinqertë që kanë pasur deri më tani me këshilltarët e

kaluar, duke specifikuar dhe vlerësuar se bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës Turke, Dijanetit turk është në nivel të shkëlqyer dhe se këto marrëdhënie do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke shprehur dëshirën që edhe më tej të vazhdojë ky koordinim me qëllim që t'i kontribuojmë zhvillimit të jetës fetare e kulturore

në Kosovë përmes projekteve të përbashkëta.

Nga ana e tij, këshilltari për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bunyamin Albayrak, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke shprehur bindjen dhe gatishmërinë që ky bashkëpunim do të intensifikohet, në mënyrë që Kosova të jetë një oazë paqeje dhe harmonie ndërfaqetare. (R.S.)

Përfaqësues nga Diaspora vizituan Bashkësinë Islame të Kosovës



Më 25 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga drejtori i Diasporës së BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim kryetarin e Unionit Shqiptar Mysliman në Austri, Vahidin Behlulin.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Behluli për vizitën dhe për angazhimin e tij dhe të Unionit Shqiptar për mbarrëvajtjen e jetës fetare në Austri. Ai edhe njëherë i premtoi përkrahjen e pa rezervë të

Bashkësisë Islame të Kosovës, duke potencuar kështu përkushtimin e BIK-ut për të bërë atë që është më e mira për besimtarët tanë në Diasporë.

Më 26 korrik, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Diasporës Ekrem ef. Simnica, pritën në takim imamin e Qendrës Shqiptare Fetare dhe Kulturore në Oslo të Norvegjisë, Sabri ef. Jonuzin.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë shprehu falënderime për Sabri ef. Jonuzin dhe për Qendrën Shqiptare Fetare dhe Kulturore në Norvegji në Oslo, por edhe tërë diasporën që pa kursyer asnjëherë kanë ofruar dhe ende po ofrojnë ndihmë për Kosovën.

Në shenjë mirënjohje për kontributin e tyre për kurbane, drejtori i Diasporës së BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, ndau një fletëfalënderim për imamin Sabri ef. Jonuzi.

Drejtori Simnica priti në takim Mentor Janovën dhe Artan ef. Osmanin

Më 25 korrik, drejtori Simnica, në takime të ndara ka pritur Mentor Janovën, anëtar në Kryesinë e xhamisë “El-Furkan” në Duisburg të Gjermanisë dhe Artan Osmanin, imam, njëherësh edhe kryetar i Qendrës në Turku të Finlandës.

Drejtori Simnica i falënderoi mysafirët për vizitën dhe i njohu ata me angazhimin e Drejtorisë së Diasporës. Ai edhe njëherë shprehu gatishmërinë e tij që të vazhdohet bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe qendrave fetare në diasporë. Ai për ta ndau nga një falënderim për kurbanet e dhuruara për Bashkësinë Islame të Kosovës.

Edhe mysafirët, z. Janova dhe z. Osmani, shprehën falënderimet e tyre për pritjen dhe për angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë për besimtarët myslimanë shqiptarë në diasporë.



Redaksia e revistës “Dituria islame” mbajti mbledhjen e radhës



Më 27 korrik, redaksia e revistës “Dituria islame” mbajti mbledhjen e radhës, në të cilën u diskutuan dhe u analizuan numrat nga 371 deri më 378. Këtë mbledhje e nderoi edhe prezenca e Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Hapjen e mbledhjes e bëri kryeredaktori dr. Ajni Sinani, i cili prezantoi rendin e ditës, duke vlerësuar punën dhe angazhimin e anëtarëve të redaksisë, punën e kritikës konstruktive të anëtarëve të redaksisë që kanë dhënë deri më tani dhe njëherësh shfaqti bindjen

dhe vlerësimin e përgjithshëm të artikujve të publikuar, me theksin e veçantë çmoi prurjet cilësore në numrat e fundit të revistës.

Më pas, në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë, vlerësoi lart punën dhe angazhimin e gjithë redaksisë, kryeredaktorit dhe të gjithë atyre që kanë kontribuar deri më tani që kjo revistë të dalë rregullisht dhe t'i shërbejë lexuesve tanë. Ai më tej edhe njëherë u zotua se revista dhe kryeredaktori i ri do të kenë përkrahjen e institucionit ashtu siç e kanë pasur deri më sot.

Më pas anëtarët e redaksisë paraqitën mendimet e tyre përkitazi mbi artikujt e publikuar në revistë në numrat e fundit. Ata edhe njëherë theksuan vlerën dhe peshën e lartë që përçojnë këto shkrime të lexuesi dhe mbarë opinionin i gjerë.

Kjo ishte mbledhja e fundit e kësaj redaksie në këtë përbërje, andaj në shenjë mirënjohje për kontributin dhe mundin e dhënë në emër të Kryesisë së BIK-ut, Myftiu Tërnavë ndau mirënjohje për kryeredaktorin e deritashëm, dr. Ajni Sinanin. (R.S.)

Kryesia e BIK-ut organizoi takim me mërgimtarët tanë

Më 28 korrik, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, gjegjësisht drejtorja për Diasporë ka hapur dyert e Medresesë “Alauddin” për mërgimtarët në një takim që tashmë është bërë tradicional.

Për të nderuar dhe respektuar mërgimtarët, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë me drejtorin për Diasporë, Ekrem Simnica si dhe përfaqësuesit më të lartë të Kryesisë, kanë takuar mërgimtarët të cilëve u uruan mirëseardhje, qëndrim të këndshëm në atdhe, si dhe falënderuan për bashkëpunimin e vazhdueshëm.

Ekrem Simnica, drejtor për Diasporë, çmoi rolin dhe rëndësinë që mërgimtarët kanë për vendin tonë. Ai shtoi se takime të tilla fuqizojnë frymën vëllazërore.



Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, veçoi punën dhe angazhimin e dalluar që imamët në diasporë po bëjnë për ruajtjen e identitetit fetar dhe atij kombëtar.

Imamë dhe besimtarë nga Zvicra, Austria, Gjermania, Norvegjia dhe vende të tjera, në këtë takim folën për gjendjen e besimtarëve atje dhe

rolin që e madh që Bashkësia Islame e Kosovës po luan në këto vende.

Në fund të këtij takimi, Myftiu Tërnavë dhe drejtori i Diasporës Ekrem Simnica ndanë mirënjohje dhe dhurata simbolike në shenjë falënderimi për kontributin e mërgimtarëve.

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e Vitit të Ri Hixhri 1444

Të dashur vëllezër e motra,

Myslimanët anekënd botës sonte kujtojnë Hixhretin e të Dërguarit të Allahut, nga Meka në Medinë, datë që shënoi një pikë kthese në historinë e Islamit dhe fillimin e kalendarit mysliman.

Duke u nisur nga Fjala e të Madhit Zot, në Kuranin e Tij fisnik, ku na drejtohet e thotë: “...dhe kujtoju atyre ditët e mëdha të Zotit...” (Ibrahim, 5), mësojmë se ne si myslimanë nuk guxojmë të harrojmë ditët e mëdha e me vlerë dhe ngjarjet e rëndësishme të historisë islame, e në veçanti ato që kanë të bëjnë me vetë jetën e Resulullahut a.s.

Padyshim se nga këto ngjarje të rëndësishme, është edhe Hixhreti i Resulullahut a.s., i cili ka qenë dhe do mbetet gjithmonë në kujtesën e myslimanëve.

Hixhreti (shpërngulja) na mëson se vetëm besimtarët e drejtë e të devotshëm janë të gatshëm që për hir të së vërtetës dhe besimit të sakrifkohen, e të bëjnë hixhret për hir të Allahut.

Në ditët e sotme, secili individ dhe secila shoqëri ka edhe hixhretin e vet, në kuptimin që secili njeri nëse largohet nga të këqijat dhe të ligat, ai vetëm se ka bërë hixhret dhe është afruar tek Allahu Fuqipotë, e për këtë Muhamed Mustafaja a.s. na ka porositur: “Muhaxhir është ai i cili largohet nga të ndaluarat e Zotit.”

Dita e Hixhretit nuk duhet kaluar pa reflektim, duke përllogaritur se sa ishim të mirë dhe të dobishëm për veten, familjen dhe për shoqërinë ku jetojmë, kjo në funksion që në vitin e ri që po hyjmë të jemi më të ndërgjegjshëm, më social, më human, bujar e fisnik, më të dashur me njëri-tjetrin dhe më afër Zotit.

Hixhreti është dhe mbetet një frymëzim i fuqishëm në jetën e çdo myslimani, dhe mbart me vete mesazhin për sigurinë, lirinë dhe vlerën e atdheut.

Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi, paqja qoftë mbi të, na mësoi me shembullin e tij praktik se liria nuk i jepet askujt pa sakrificë dhe na mësoi se këto synime mund të arrihen vetëm përmes sakrificës dhe forcës së besimit.

Lus Allahun e Lartësuar që ky vit i ri të sjellë paqe e mirësi mbi mbarë njerëzimin, si dhe të sjellë harmoni në mesin tonë, duke na i bashkuar zemrat tona dhe duke na forcuar në idealet për prosperitet e paqe.

Zoti na bekoftë të gjithëve!

Prishtinë, më 29 korrik 2022

Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë

Jepet leja për ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë



Më 14 qershor, Drejtorja e Urbanizimit të Komunës së Prishtinës ka marrë vendimin për leje ndërtimitin e kompleksit “Xhamia Qendrore” në lagjen Dardania në Prishtinë. Në vendimin e Komunës së Prishtinës thuhet se i lejohet kërkuarit, Bashkësisë Islame të Kosovës ndërtimi i Xhamisë në lagjen Dardania në Prishtinë, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës.

Edhe autoritetet e BIK-ut janë shprehur të kënaqur që më në fund po jepet leje ndërtimi i Xhamisë Qendrore. Ahmet ef. Sadriu, sekretar gjeneral i BIK-ut tha se tashmë BIK mund të fillojë me hapa të rinj

drejt finalizimit të projektit të xhamisë. “Po tashmë është e vërtetë se Komuna e Prishtinës na ka dhënë leje për ndërtim dhe tashmë nuk ka asnjë pengesë që të fillojmë me punën që të përfundohet në afatin e përcaktuar, në mënyrë që besimtarët tanë të mund t’i kryejnë obligimet fetare”, tha sekretari Sadriu.

Edhe kryetari i Prishtinës, Përpam Rama, tha se ky proces u shoqërua me procedura të stërzgatura, që BIK-u të pajiset me kushtet ndërtimore në vitin 2017, të cilat u plotësuan me ndryshime më vonë në vitin 2020, kur edhe u

pajisën me lejen për sigurimin e gropës së gërmimit. Ai më tej ka theksuar se banorët e lagjeve që ndërlidhen me xhaminë e re duhet ta gëzojnë të drejtën të praktikojnë fenë e tyre në mënyrë të dinjitetshme. “Qytetarët e lagjeve Dardania e Ulpiana duhet ta gëzojnë të drejtën të praktikojnë fenë e tyre në mënyrë të dinjitetshme. Andaj, jemi të lumtur që më në fund, këtë proces sot e përmbyllëm me lëshimin e lejes ndërtimore për ndërtimin e këtij objekti fetar” ka thënë ai.

Hartimin e dokumentacionit ndërtimore për projektin kryesor të Xhamisë Qendrore në Prishtinë me 2B+2s+P+2G e ka bërë kompania projektuese “Kavisyapi” nga Turqia me konsulent të kompanisë projektuese “InTECH” nga Prishtina. Duhet theksuar se gurthemeli i xhamisë ishte vendosur para dhjetë vjetësh dhe Bashkësia Islame i është drejtuar në vazhdimësi Komunës së Prishtinës me kërkesën që të pajiset me leje ndërtimore për ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. (R.S)

Studentët nga Kosova realizuan një vizitë kulturore në Stamboll dhe Bursa të Turqisë

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, nga data 13 deri më 19 qershor u realizua projekti për të rinj me titull “Ëndërro, zbulo, dhuro vakëf”. Studentë kosovarë nga profile të ndryshme të udhëhequr nga zyrtarët e BIK-ut, Besir Neziri dhe Isra Hyseni, qëndruan në Turqi me qëllim të njohjes nga afër me historikun e kulturën e vakëfeve, si dhe monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore islame në Turqi.

Në këtë vizitë një javore, studentët kosovarë vizituan objekte të rëndësishme vakëfnore të ndryshme



në Stamboll, siç janë kuzhina publike (Imaretin) Mihrishah Valide Sulltan, nga e cila çdo ditë ushqehen 3000 familje, ku edhe morën pjesë në shpërndarjen e ushqimit për familjet në nevojë, si

dhe vizituan spitalin Bezmialem, ku janë trajtuar mbi 300 pacientë nga Kosova në kuadër të bashkëpunimit në mes Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë.

Më pas vizituan edhe shumë monumente të tjera historike, kulturore dhe vakëfnore në Stamboll, të cilat janë restauruar dhe mbrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë, si Xhaminë Blu (Sulltan Ahmet), Xhaminë Ajasofja, Xhaminë Sylejmanije, Kullën e Gallatës, shtëpitë e shpendëve në lagjen Üsküdar (Xhamia Ajazma), Xhaminë Mihrimah Sulltan dhe Mevlevihanen në Jenikapi të Stambollit.

Studentët kosovarë gjatë vizitës së tyre në Stamboll janë pritur në takim edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Vakëfeve të Turqisë, Burhan Ersoj, i cili i njohu ata për misionin si dhe për projektet dhe aktivitetet që realizon Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve, si brenda Turqisë po ashtu dhe jashtë saj. Studentët kosovarë falënderuan drejtorin Ersoj për mundësinë e kësaj vizite si dhe për të gjitha projektet që ka realizuar dhe po realizon Drejtoria

e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë në Kosovë.

Studentët nga Kosova udhëtuan edhe në Bursa, ku vizituan monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore islame, si Kompleksin e Ullu Xhamisë, xhaminë Jeshile, xhaminë Emir Sulltan, muzeun Panorama të çlirimit të Bursës në vitin 1326, Kompleksin Muradije, ku u njohën nga afër me qytetërimin, historinë dhe kulturën e vakëfeve.

Kryeimami Sahiti priti në takim një grup studentësh

Më 21 qershor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim studentët kosovarë që morën pjesë në programin rinor "Ëndërro, zbullo, dhuro vakëf", të mbajtur në Stamboll dhe Bursa nga 13-19 qershor 2022, i cili u organizua nga Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve në Turqi.

Kryeimami Sahiti i njohu studentët për bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, si në fushën kulturore ashtu edhe në humanitare e shëndetësore, e gjithashtu edhe kjo vizitë studimore për të rinjtë tanë erdhi në kuadër të këtij bashkëpunimi disavjeçar theksoi mes tjerash Kryeimami Sahiti.



Studentët falënderuan kryeimamin Sahiti dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për mundësinë e krijuar për të qenë pjesë e kësaj vizite studimore dhe u shprehën shumë të kënaqur me mirëpritjen dhe organizimin e programit nga zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve.

Gjatë takimit studentët treguan përvojat e tyre përgjatë kësaj vizite

dhe shpalosën idetë për projekte të ardhshme. Në këtë vizitë studimore morën pjesë gjithsej 18 studentë kosovarë të profileve të ndryshme.

Pas takimit kryeimami Sahiti bashkë me studentët vizituan punimet e restaurimeve në xhaminë "Alauddin" dhe xhaminë "Pirinaz" në Prishtinë, të cilat po realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë.

BIK dhuroi botimet e saj për Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës

Më 21 qershor, drejtori i Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ramadan Shkodra, i shoqëruar nga përgjegjësi për literaturë, Agim Gashi, kanë vizituar Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës, në të cilën u pritën nga u.d. drejtori Selatin Novosella.

Ata vizituan bibliotekën e sapo themeluar të Shoqatës dhe arkivin e saj.



Me këtë rast, Drejtoria për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në BIK, i dhuroi Shoqatës së të Burgosurve Politik, 73 tituj, botime nga Kryesia e Bashkësisë Islame të

Kosovës, më konkretisht nga shtëpia botuese "Dituria Islame". Titujt janë të fushave të ndryshme, ndër to nga kultura, historia, gjuhësia, letërsia etj.

U.d. drejtori Novosella falënderoi drejtorin Shkodra, por edhe institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës për këtë dhuratë, duke e cilësuar atë si një ndihmesë të madhe për këtë shoqatë.

Kryeimami Sahiti takoi mualimet e Departamentit të Gruas së BIK-ut

Më 22 qershor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me koordinatorin e zyrës së Dijanetit në Prishtinë, z. Bilal Coşkun, ka zhvilluar një takim pune me mualimet e Departamentit të Gruas së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Fillimisht, kryeimami Sahiti i përgëzoi dhe i uroi mualimet për punën dhe kontributin e tyre në fushën e mësim-besimit me grupmosha të ndryshme në xhamitë ku veprojnë.

"Misioni ynë fisnik kërkon nga ne që të angazhohemi edhe më shumë në mbarëvajtjen dhe ecurinë sa më të mirë të mësim-besimit", theksoi mes tjerash kryeimami Sahiti.



Ky takim në fokus kishte vlerësimin e punës dhe raporteve të mualimeve për gjashtëmujorin e parë të këtij viti dhe për të diskutuar mbi mundësitë e avancimit të

mësim-besimit në nivel vendi. Projekti i angazhimit të mualimeve në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës edhe këtë vit po mbështetet nga zyra e Dijanetit.

Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame ka mbajtur mbledhjen e rregullt

Më 23 qershor, Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi drejtori i saj, prof. Sabri ef. Bajgora. Këshilli Drejtues në rend dite kishte parapërgatitjen e Tryezës shkencore kushtuar Sali ef. Myftisë. Po ashtu, në këtë mbledhje u diskutua edhe për përgatitjet rreth Konferencës së sivjetme rreth shkatërrimit të xhamive në trojet shqiptare nga viti 1878-2001, e cila planifikohet të mbahet kah fundi i vitit. Gjithashtu në këtë mbledhje u vendos të botohet libri "Selim ef. Drejta dhe komentimi i tij i sures Jasin", që do të botohet gjatë këtij viti. Instituti do të bëjë



botimin anestetik të dorëshkrimit të vitit 1179h/1766 të Sahihul-Buhariut, komentuar nga dijetari Abdullah el-Junini. Në këtë mble-

dhje u diskutua si projekt afatgjatë dhe u propozua tubimi i opusit të bejtexhinjve që në fillet e para të kësaj trashëgimie kulturore.

Kryeimami Sahiti takoi udhëheqësit e grupeve të haxhive

Më 23 qershor, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka mbajtur mbledhjen parapërgatitore me udhëheqësit e grupeve të haxhive që udhëtojnë për të kryer haxhin këtë vit.

Në fokus të takimit të tij me udhëheqësit e haxhive ishte koordinimi i punëve, bashkërendimi i detyrave, obligimeve dhe përgjegjësisve të udhëheqësve në raport me haxhitë, me qëllim të mbarë-



vajtjes së kryerjes së haxhit në nga Kosova në haxh do të shkojnë formën më të mirë. Gjatë këtij viti 741 haxhi.

Kryeimami Sahiti vizitoi Këshillin e Bl-së së Rahovecit

Më 28 korrik, këshilltari për Çështje Fetare pranë Ambasadës turke në Prishtinë, z. Bunyamin Albayrak, së bashku me kryeimamin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti dhe zv.kryeimamin Fatmir ef. Iljazi, kanë vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame në Rahovec, ku u pritën nga kryetari Shani ef. Sylka me bashkëpunëtorë.

Pas takimit zyrtar, kryeimami me mysafirët vizituan edhe ambientet e Xhamisë Qendrore në Rahovec, ku po mbahet shkolla verore e mësimbesimit nga mualimet e Departamentit të Gruas.

Kryeimami Sahiti e përgëzoi Këshillin e Bashkësisë Islame në



Rahovec për organizimin e shkollës verore dhe i uroi mualimet për punën e kontributin e tyre në mbarëvajtjen e mësim-besimit me grupmosha të ndryshme.

Projekti i angazhimit të mualimeve në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, edhe këtë vit po mbështetet nga zyra e Dijanetit.

U mbajt duaja e hatmes për nxënëset e xhamisë së Bardhoshit

Më 27 korrik, tetë nxënëse të xhamisë së Bardhoshit, bënë duan e hatmes, pasi që me sukses të plotë kanë përfunduar leximin e Kuranit.

Nxënëset së bashku me mësuesen e tyre përgjatë dy viteve kanë mësuar fillimisht leximin e shkronjave e më pas edhe kanë lexuar Kuranin në gjuhën origjinale.

Nxënëset shprehën të lumtura me rastin e duasë së hatmes, ato thonë se vështirë e kanë të përkruajnë ndjenjat e tyre këtë ditë.

Mësuesja që udhëhoqi këto nxënëse deri tek hatmeja e Kuranit,



thotë se rëndësia e madhe që ka mësimi i leximit të Kuranit po e bën që të vazhdojë të jetë pranë këtyre nxënësve.

Vaxhide Bunjaku nga Departamenti i Gruas u bëri thirrje që të mos ndalen vetëm me leximin e Kuranit, por të vazhdojnë edhe më tej.

Në xhaminë e Bardhoshit ku u zhvillua ky aktivitet, janë përmbi 100 nxënës të cilët janë të angazhuar me mësim-besim, lexim Kuranit dhe memorizimin e tij përmendësh. Aktivitete të tilla të ngjashme zhvillohen edhe në xhamitë e tjera në Kosovë.

Reagim

Dënojmë me ashpërsinë më të madhe sulmin mbi imamin e xhamisë së fshatit Lupç, të komunës së Podujevës, Zeqir ef. Berishës.

Sulmi i mbrëmshëm mbi imamin në hapësirat e xhamisë, në vendin e tij të punës, është akt i papranueshëm, madje përveçse sulm mbi imamin është edhe atak mbi xhaminë dhe xhematin e respektuar.

Imami është autoriteti më i lartë fetarë në xhematë, andaj atakimi i tij është atakim i vlerave dhe misionit që përfaqëson ai, e në këtë rast është edhe atak mbi Bashkësinë Islame të Kosovës.

Mbështesim dhe i qëndrojmë afër imamit të respektuar, e nga xhemati kërkojmë që të distancohen nga autorët e sulmit, ndërsa nga organet e drejtësisë kërkojmë që të japin vendimet e duhura, sepse është sulmuar imami – autoriteti zyrtar fetar në vendin e tij të punës, si dhe është atakuar hapësira e xhamisë, e cila është e dedikuar për lutje e ibadete.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës

Prishtinë, më 22 korrik 2022

Besimtarët myslimanë festuan festën e Kurban-Bajramit

Më 9 korrik, besimtarët myslimanë festuan festën e Kurban-Bajramit, festë kjo e cila simbolizon sakrificën e besimtarëve ndaj Zotit dhe humanitetin ndërmjet njerëzve. Ceremonia kryesore e faljes se namazit të Bajramit u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, me mesazhe për paqe, solidaritet, harmoni dhe dashuri ndaj njerëzve. Ligjëratën kushtuar festës së Kurban-Bajramit e mbajti kryeimami i Këshillit të BI-së së Prizrenit, Orhan Bismilaj, e namazit të Kurbanit-Bajramit i priu kryeimami i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Burhan Hashani, ndërsa hytben e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në këtë hytbe potencoi rëndësinë e kryerjes së haxhit si shtyllë e Islamit dhe solidaritetin e besimtarëve me therjen e kurbanit. “Festa e Kurban Bajramit na vjen si një rikthim i vlerave burimore që posedon feja jonë, na rikujton sakrificën, humanitetin, ndihmën ndaj njerëzve që kanë nevojë. Atëherë pse të mos ndihmojmë njerëzve edhe



përmes therjes së kurbaneve dhe të gëzojmë fëmijët jetim dhe familjet që kanë nevojë që tryeza e tyre të paktën për këtë festë të jetë e begatë. Myftiu Tërnavë nga kjo hytbe përçoi mesazhet e tij për paqe në gjithë botën, duke potencuar se feja islame thërret për paqe dhe në asnjë mënyrë në dhunë. “Islame fe hyjnore nuk thërret për luftë, por për paqe. Islami është kundër gjakderdhjeve, vrasjeve, dhunimeve, shkatërrimeve të infrastrukturës që njerëzit me mund e kanë ngritur

për të bërë një jetë sa më të qetë dhe të lumtur. Është e padrejtë që shteteve dhe popujve të ndryshme t’u imponohet lufta e cila shkakton vrasje dhe shkatërrime.” Festa e Kurban-Bajramit për besimtarët myslimanë vjen pas kryerjes së obligimit të haxhit, ku nga Kosova 741 besimtarë kanë kryen haxhin këtë vit. Ndërsa që nga falja e namazit të Bajramit besimtarët myslimanë therin kurban për të dëshmuar sakrificën ndaj Krijuesit dhe solidaritetin ndaj njerëzve.

Pritje për urime, me rastin e festës së Kurban-Bajramit

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës edhe këtë herë, sikurse viteve të tjera organizoi pritje për urime me rastin e festës së Kurban-Bajramit. Për të uruar, në vizitë erdhën krerët më të lartë shtetëror, përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuesit e misioneve të ndryshme në Kosovë, përfaqësues të jetës fetare, kulturore etj.

Në pritje të tyre ishte Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavi me bashkëpunëtorë.

Nga përfaqësuesit e institucioneve erdhën:

- Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilia Rexhepi;
- Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca;
- Shefja e UNMIK-ut, Caroline Ziadeh;
- Ambasadori i OSBE-së, Michael Davenport;
- Ambasadori i Republikës së Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar.

- Këshilltari për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bunyamin Albayrak;
- Nga Ipeshkvi i Kishës Katolike, Dom Lush Gjergji.
- Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, Behar Ejupi;
- Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli;

Nga partitë politike:

- Kryetari i PDK-së Memli Krasniqi;
- Në emër të LDK-së sekretari, Imri Ahmeti;
- Në emër të AAK-së, nënkryetari Muharrem Nitaj;
- Kryetar i PD-së, Ferid Agani.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca u shpreh: “Kjo është festë e rëndësishme. Miliona besimtarë festojnë këtë ditë. Ne na frymëzojnë për këtë




besim. Në emër të institucioneve ju falënderoj ju Bashkësinë Islame. Jam këtu në selinë e Bashkësisë Islame për të urrear këtë festë të rëndësishme të Kurban-Bajramit. Kjo festë është e rëndësishme sepse na kujton lidhjen e ngritjen shpirtërore të njeriut dhe sakrificën. Populli ynë ka kaluar në vështirësi, por gjithmonë ka qenë në gjendje ta ruajë besimin.”

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi tha: “Është një nga ditët e mëdha dhe ditët e veçanta kur ne mendojmë edhe më shumë se sa në ditët e zakonshme për bamirësinë, solidaritetin, por edhe për sakrificën sepse janë këto simbolika të kësaj feste. Në këtë ditë padyshim që mendojmë për ata që kanë nevojë për t’ju gjetur pranë, mendojmë për njerëzit të mirë të vendit të cilët nuk i kanë të afërmit e atyre afër vetes, i urojmë në mënyrë të veçantë familjet e dëshmorëve dhe të martirëve. Në këtë ditë padyshim mendjen e kemi edhe tek udhëheqësit e UÇK-së që po mbahen në Gjykatën Speciale, duke shpresuar që shpejt do t’i kemi në mesin tonë. Por po ashtu thërrasim dhe ftojme që të marrim

nga shembulli i Kurban-Bajramit dhe t’i gjendemi më afër njëri-tjetrit, të kemi më shumë mirëkuptim për njëri-tjetrin, më shumë dashuri për njëri-tjetrin dhe të frymëzohemi për të bërë më shumë punë të mira për vendin e kombin tonë.”

Dom Lush Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës, u shpreh: “Dashtë Zoti të kemi më shumë festime. Jemi këtu për festën e Bajramit të Vogël për të shprehur urimet e përbashkëta, që të përforcohet bashkimi, afrimi dhe kërkimi i vlerave dhe virtyeteve që kemi më shumë nevojë se kurrë.”

Kryetari i Lipjanit, njëherësh sekretari i LDK-së, Imri Ahmeti në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, tha: “Tu përcjellë urimet nga kryetari Lumir Abdixhiku. Sot në këtë ditë jemi për të urrear Myftiun Tërnavë për festën e Kurban-Bajramit. Po ashtu i urojmë gjithë besimtarëve myslimanë festën e Kurban-Bajramit.”



Përfundoi me sukses organizimi i Haxhit 2022

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës edhe këtë vit, ashtu sikurse edhe viteve të tjera ka organizuar me sukses shkuarjen në vendet e shenjta për ta kryer haxhin. Në mëngjesin e hershëm të datës 28 qershor, besimtarët e parë nga tetë vende të Kosovës, morën rrugën për në Meke, për ta kryer njërin ndër obligimet e besimit islam, atë të haxhit. Ata u shprehën tejet të emocionuar për këtë “plotësim dëshire” siç e quajtën ata, të cilët disa prej tyre e kishin ëndërruar që nga fëmijëria.

Pasditen e së martës, së 28 qershorit, grupi i parë i besimtarëve myslimanë nga Kosova arritën shëndosh e mirë në Meke. Në pritje të tyre kishin dalë përfaqësuesit nga Drejtoria e Haxhit në Bashkësinë Islame të Kosovës, të cilët menjëherë i akomoduan në hotelin “Nasmat Al-Khair” në Meke.

Më 30 qershor, grupi i dytë i besimtarëve myslimanë nga Kosova u nis dhe arriti në aeroportin e Xhedes, ndërsa më 1 korrik, drejt vendeve të shenjta udhëtoi edhe grupi i tretë dhe ai i fundit. Ata menjëherë filluan me kryerjen e umres, e cila i paraprinë ceremonisë së haxhit.

Në mesin e 741 kosovarëve që morën rrugën drejt vendeve të shenjta, ishte edhe dymbëdhjetë vjeçari, Zylfi Krasniqi nga Dragashi, i cili këtë vit ishte edhe haxhiu më i ri nga Kosova. Ai së bashku me familjen e tij iu bashkuan besimtarëve nga e mbarë bota për pelegrinazhin e haxhit.

Gjatë qëndrimit në Meke, besimtarët tanë falnin kohët e namazit në Qabënë e bekuar, duke përfunduar kështu të gjithë ritualin e umres, dhe përgatitjet e fundit për fillimin e kryerjes së haxhit, i cili do të fillonte në mbrëmjen e 7 korrikut, me nisjen e besimtarëve drejt rrafshnaltës së Arafatit.

Paraprakisht, përgjegjësit nga Drejtoria e Haxhit në Bashkësinë Islame të Kosovës, të shoqëruar edhe nga sekretari gjeneral i



Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, panë nga afër përgatitjet e fundit në tendat, në të cilat do të akomodoheshin besimtarët tanë nga Kosova.

Të enjten më 7 korrik, besimtarët tanë, në mënyrë të organizuar, grupe-grupe, kanë lënë hotelin për t'u nisur për në rrafshnaltën e Arafatit, ku do ta kryenin edhe njërin ndër kushtet themelore të haxhit, atë të qëndrimit në Arafat.

Të premten e 8 korrikut, miliona besimtarë nga e gjithë bota, përfshirë edhe besimtarët tanë nga Kosova qëndruan në Arafat, duke lutur Allahun për falje e mëshirë. Ndjenja e të qenit në haxh dhe në Arafat për të gjithë besimtarët ishte vështirë e përshkuar. Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili ishte pjesë e shoqërimit të haxhive, u shpreh se haxhi i sivjetmë është unik, për faktin se dita e Arafatit, ka qëlluar të jetë edhe dita e xhuma. Gjatë qëndrimit në Arafat, përveç lutjeve dhe adhurimeve të ndryshme, para haxhive, një ligjëratë rreth vlerës dhe rëndësisë së haxhit e mbajti sekretari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu.

Në mbrëmje, haxhit tanë lanë Arafatin për të vazhduar rrugëtimin e tyre drejt Muzdelifes, ndërsa në mëngjesin e 9 korrikut, që përkonte të ishte edhe dita e parë e Kurban-Bajramit, ata vazhduan rrugën drejt Minas për ritualin e gjuajtjes së gurëve. Më pas ata janë liruar nga ihrami dhe janë kthyer në hotel, ku kanë uruar njëri-tjetrin për festën e Kurban-Bajramit, me lutjet tek i

Madhi Zot për pranim të haxhit dhe ibadeteve të tyre.

Gjatë ditëve të teshrikut, haxhitë tanë rrugës për në xhemarat, zhvilluan edhe një takim vëllazëror me haxhitë nga Shqipëria.

Ceremonia e haxhit përfundoi më 11 korrik, me hedhjen e gurëve të fundit në xhemarat, e i cili shënonte edhe ritualin e fundit për sa i përket haxhit. Ndërkaq, të nesërmen, më 12 korrik, haxhitë tanë kryen edhe tavafin lamtumirës, për t'u përshëndetur kështu me mallëngjim me Qabenë e bekuar, e për të vazhduar të nesërmen rrugën për në Medine.

Pasditen e së mërkurës, së datës 13 korrik 2022, haxhitë tanë, të ndarë në grupe, arritën në Medine dhe menjëherë u akomoduan në hotelin Waqf al Safi Bosphorus.

Që nga ajo ditë e deri në ditën kur do të niseshin për Kosovë, ata patën mundësinë që t'i vizitojnë vendet e shenjta dhe historike të qytetit të Medinës.

Në kuadër të këtyre vizitave, më 16 korrik, haxhitë nga Kosova vizituan Kopshtin e Xhenetit (Reuda esh-Sherifeh), që është një zonë e caktuar në pjesën e parme të Xhamisë së Pejgamberit a.s. dhe që shtrihet midis shtëpisë dhe minberit të Pejgamberit a.s.. Për këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: "(Pjesa) midis shtëpisë sime dhe minberit tim është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit." Falja e namazit në këtë pjesë ka shpërblime shumë të mëdha.

Më pas, haxhitë kanë kaluar pranë varrit të Pejgamberit a.s., Ebu Bekrit r.a. dhe Omerit r.a., ku

dërguan selamet dhe përshëndetjet e tyre për ta, për të vazhduar më pas edhe me vizitën dhe përshëndetjen e mijëra sahabëve të varrosur në Bekia.

Haxhitë tanë vazhduan vizitat e tyre në mënyrë të organizuar, duke u njoftuar kështu me vlerën dhe rëndësinë historike që kanë vendet e Medinës. Ata më 17 korrik, vizituan kodrën e Uhudit, xhaminë me dy Kible, vendin e betejës së Hendekut, Xhaminë e Kubasë etj.. Nga udhëheqësit e tyre, ata dëgjuan rrëfimet për ngjarjet që kanë ndodhur në këto vende në kohën e Pejgamberit a.s.

Po atë ditë, për të dëgjuar dhe mësuar më shumë për jetën e bekuar të Pejgamberit a.s., haxhitë vizituan ekspozitën dhe Muzeun Internacional të Jetëshkrimit të Pejgamberit a.s. dhe Civilizimit Islam.

Edhe ditëve të qëndrimit në Medine u erdhi fundi. Mëngjesi i 19 korrikut, do t'i gjente haxhitë tanë në aeroportin e Medinës, të gatshëm për t'u kthyer në atdheun e tyre. Të përmalluar për vendet e shenjta, por edhe të gëzuar për kryerjen e obligimit të haxhit, ata lanë Medinën dhe u nisën drejt Kosovës. Grupi i parë i haxhive tanë arritën në Aeroportin Ndërkombehtar "Adem Jashari" në orën 10:50h, të martën më 19 korrik.

Në pritje të tyre, përveç numrit të madh të familjarëve, kishte dalë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili uroi haxhitë për kryerjen e haxhit, duke lutur Zotin që t'ua ketë pranuar këtë ibadet.

Po atë ditë, në mbrëmje arriti në Kosovë edhe grupi i dytë i haxhive. Ndërsa të nesërmen, më 20 korrik, në orën 10:40, arriti edhe grupi i fundit i haxhive, të cilët këtë vit kryen haxhin në vendet e shenjta.

Lusim Zotin e Madhëruar që haxhive tanë t'ua ketë pranuar haxhin dhe të gjitha ibadetet dhe lutjet që i kanë kryer në vendet e shenjta, në Meke dhe në Medine!

Përgatiti: Bajram Zeqiri



Dr. sc. Hatixhe Ahmedi, doktorantja e parë shqiptare në fushën e filologjisë orientale

Më 23.06.2022, në Universitetin e Tetovës, kandidatja mr. sc. Hatixhe Ahmedi, punonjëse shumëvjeçare në Arkivin e Kosovës dhe njohëse e mirë arkivistikës dhe dokumenteve në gjuhën osmane, me sukses mbrojti temën e doktoratës me titull: “Paleografia dhe gjuha diplomatike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës”.

Tema u mbrojt para komisionit në përbërje: prof. dr. Abdulla Hamiti (kryetar), prof. dr. Adnan Ismaili, prof. dr. Qani Nesimi, prof. dr. Fehari Ramadani, prof. dr. Zeqirja Idrizi (anëtarë) dhe prof. dr. Sulejman Baki (mentor).

Komisioni e vlerësoi lart punën e kandidatës duke e konsideruar si një punim me shumë interes për studimet filologjike - historike ndër të parat në hapësirat shqiptare.

Përndryshe, dr. sc. Hatixhe Ahmedi është doktorantja e parë në programin studimor Filologji orientale në këtë universitet, e para doktorante shqiptare dhe ndër të paktat kuadro me këtë arritje shkencore në këtë fushë.



Dr. sc. Hatixhe Ahmedi, po ashtu, është ndër studentet e para të diplomuara në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës, bashkëpunëtore dhe pjesëmarrëse me kontribute në organizimet shkencore të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe në periodikun islam shqiptarë që botohet në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe jo vetëm.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore dhe ka botuar dhjetëra kontribute edhe jashtë vendit.

Është bashkautore e monografisë me karakter enciklopedik: “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880 - 1912) - sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, të cilën e botoi Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2021 (f. 735) dhe përkthyesë dhe përgatitëse e veprës po ashtu me karakter enciklopedik: Tahir Sezen, Ndarja administrative e Vilajeteve Shqiptare (Emrat e vendeve dhe statusi i tyre), botoi: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë 2021 (f. 416). (B. Zeqiri)

Ndërroi jetë mulla Nazmi ef. Sylejmani

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”


Më 25 korrik 2022, ka ndërruar jetë mulla Nazmi ef. Sylejmani. Varrimi i rahmetliut u bë më 25 korrik 2022, në kohën e namazit të ikindisë, në varrezat e fshatit Topanicë të komunës së Kamenicës.

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!

Biografi e shkurtër


Nazmi ef. Sylejmani lindi më 25.08.1936 në Topanicë. Mësimet e para fetare i mori nga ish – imami i xhamisë së Topanicës, mulla Selimi për dy vite. Mësimet e fesë islame i vazhdoi te mulla Hysen

Hyseni në Tërnoc prej vitit 1957 deri në vitin 1961. Më pas e kreu me korrespondencë Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë. Prej vitit 1984 deri në vitin 1987, ai punoi imam në xhaminë e Kamenicës. Në janarin e vitit 1987, filloi detyrën e imamet të xhamisë në vendlindjen e vet në Topanicë, ku edhe pas daljes në pension ka punuar në detyrën e imamet deri në fund të vitit 2009. Ai ishte njëri ndër imamet shumë aktiv. Tek ai i përfunduan mësimet në mejtepin e xhamisë dhjetëra gjenerata të fëmijëve të fshatit. Mulla Nazmiu ishte edhe anëtar i shoqatës “Ilmije”, referent fetaro-arsimor në Këshillin



e BI-së së Kamenicës, si dhe për disa vite ishte anëtar i këtij Këshilli.

Ndërroi jetë doktori Ali Iljazi



"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi"

Më 6 korrik 2022, ka ndërruar jetë doktori Ali Iljazi. Rahmetliu ka qenë bashkëpunëtor i vyer i periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës, ku ka të botuar një numër të konsiderueshëm të temave e artikujve autorial, si dhe përkthime nga fusha e disiplina të ndryshme.

Me kalimin në Ahiret të doktorit, Bashkësia Islame e Kosovës, e posaçërisht periodiku i saj ka humbur një ndër bashkëpunëtorët e çmuar.

Zoti e mëshiroftë doktorin, ndërsa familjes i dhëntë sabër e gajret!

Varrimi i rahmetliut u bë më 7 korrik 2022, në orën 17:00, në varrezat e Xhamisë së Hadumit. Në varrimin e tij përveç shumë qytetarëve mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili në fjalën e tij vlerësoi lart punën dhe kontributin fetar dhe kombëtar të dr. Ali Iljazit. Ai fillimisht citoi ajetin kuranor ku Allahu xh.sh na thotë: "Allahu është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën për t'ju sprovuar, se cili prej jush është më vepërmirë". Me këtë ajet kuranor, na bëhet me dije se jeta dhe vdekja janë të krijuara nga Zoti i Madhërishtëm, dhe njashthu sikurse janë të krijuara ato janë edhe të paracaktuara nga Ai, dhe po të mos ishte njëra nuk do të ekzistonte tjetra, nuk ka vdekje pa jetë dhe nuk ka amshueshmëri pa kalim në botën tjetër. Sot, prandaj, jemi

tubuar në këtë vend për ta përcjellë në përjetësi, dr. Ali Iljazin. "Ai ishte mjek që nuk shëronte vetëm trupat, por shëronte, shpirtin, mendjen dhe zemrat e njerëzve-pacientëve të tij dhe ishte një njeri që kemi për obligim ta ndjekim rrugën e tij" – tha Myftiu Tërnavë.

Biografi e shkurtër

Prim.dr.sc.med. Ali F. Iljazi, lindi në Gjakovë në vitin 1949. Rrjedh nga një familje me ndjenja të thella fetare e kombëtare. Nga kjo familje pati 20 hoxxhallarë dhe shtatë myderriza eminent që shërbyen në Medresenë e Madhe të Gjakovës afro 280 vjet me radhë.

Prim.dr.sc.med. Ali F. Iljazi, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje me sukses të shkëlqyeshëm.

Fakultetin e mjekësisë e kreu në Sarajevë në vitin 1973 me sukses të shkëlqyeshëm. Për suksesin e arritur gjatë studimeve u dekorua me "Shenjen e artë të Universitetit të Sarajevës", si studenti më i suksesshmi dhe më i dalluari në këtë Universitet.

Specializimin nga lëmi i mjekësisë interne e kreu në Sarajevë në vitin 1979 po ashtu me sukses të shkëlqyeshëm dhe falënderim të veçantë.

Në vitin 1987, mori titullin e primariusit. Ndërsa në vitin 1988 në Universitetin e Novi Sadit mbrojti titullin e doktorit të shkencave të mjekësisë.

Deri më sot ka botuar mbi 80 punime shkencore nga lëmi i mjekësisë, të botuara këto nëpër revista të ndryshme dhe të referuara në kongrese e seminare të ndryshme, si dhe monografinë "Testet bronkoprovokuese në diagnostikën e hiperaktivitetit bronkial".

Krahas veprimtarisë mjekësore, dr. Ali Iljazi u mor me studimin e Kuranit fisnik nga këndvështrimi shkencor dhe shquhej si pionier i kësaj lëmie në trevat shqiptare.

Nga kjo lëmi ka publikuar mbi 1000 punime shkencore të botuara në revistat: "Dituria Islame", "Takvimi", "Zgjimi Islam", "Frymëzimi", "Fjala e bukur", "Hëna e re", "Paqja", "Gazeta Besa", "Vepra", "Drita Islame", "Etika", "Zaman", "Emocioni", "AlbIslam", etj.

Dr. Ali Iljazi ka qenë kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës dy mandate prej vitit 1988-1992 dhe 1992-1996.

Po ashtu ka kryer edhe detyrën e imamit dhe hatibit në Mejtepin e Halil Efendisë dhe në Xhaminë e Qylit.



Për ty o i Dërguari i Allahut

Më të mirë se ty nuk kanë parë sytë,
më të mirë se ty nuk ka lindur nëna,
rrezet e diellit nuk ngrohin si ti,
ti bëje dritë në errësirë, ngjashëm sikurse hëna.

Të deshën shumë ata që me ty jetuan,
fëmijët kënaqeshin kur të takonin,
për pleqtë ishte ngushëllimi i jetës,
të varfrit të patën më të shtrenjtën pasuri,
e të ngratët e të dobët it shpresat i kishin në ty.

Kundërshtarët ishin të bindur në brendësi,
se ti nuk ishte gënjeshtar, ngase kurrë nuk i pate gënjy,
e ditën mirë se ti ishte më i drejti njeri,
Kuranin e dëgjonin fshehur,
e nga magjepsja e tij ishin të bindur se nuk ishte poezi.

Eh sa mall i madh për mua,
kur mendoj kohën kur ti ke jetuar,
sa më prek një emocion, nuk di si ta tregoj,
zemra më dridhet vetëm kur e kujtoj.

Ti i dhe kuptim jetës dhe njerëzisë,
ndale padrejtësinë, e i dhe fund robërisë,
hoqe dallimin e të bardhit nga i ziu,
i dhe vlerë diturisë dhe lirisë.

Paqja nuk kishte alternativë dhe ishte qëllimi i jetës,
për të sakrifickove edhe mbi interesat e vetes,
na mësove se jeta nuk ka çmim që e paguan,
andaj kush e privon dikë nga jeta, xhehenemin
do ta vuaj.

Ti asnjëherë nuk u hakmore ndaj atyre
që të bënë padrejtësi,
i fale të gjithë, edhe ata që deshën të të mbysin ty,
i fale edhe banorët e Taifit, që me gurë të përzunë,
i fale në çlirimin e Mekës të gjithë ata që të luftuan
e nga vendi yt të dëbuan.

Sa ka nevojë bota për mësimet tua,
disa të shajnë e të tjerët të ofendojnë,
e disa duke të mbrojtur gabojnë,
ata që s'të njohën, nga padituria vepruan,
por edhe nga inati, disa, mësimet t'i shtrembëruan.

Shembullin tënd kurrë askush nuk e rrezon dot,
sepse të zgjodhi Zoti për jetë e mot,
sa të është njeriu dhe sa të jetë gjithësia,
ti je modeli më i mirë me të cilin edukohet shoqëria.

Unë nga tash e sa të kem jetë,
nuk i them të gjitha që ti ishte në të vërtetë,
është një ndjenjë malli për ty dhe një keqardhje
për ata që nuk të njohën dot,
unë me mësimet dhe kujtimet për ty e kaloj
jetën në këtë botë,
shpresa më e madhe për mua mbetet Ahireti,
takimi me ty është vetë Xheneti,
Xheneti me të mirat, që s'ka mundësi me i përshkrua,
harrohet në momentin kur ty kemi me të takua.
PËR TY O I DËRGUARI I ALLAHUT!

Blerim Musliu